

1 E mërkurë, 1 tetor 2025

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 09.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, thërrisni lëndën.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjesi, të nderuar
8 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
9 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
10 Selimit dhe Jakup Krasniqit. Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E di që
12 kishit një pikë që doni të korrigjoni, do ta bëjmë këtë gjë.
13 Po më lejoni fillimisht të trajtoj disa çështje paraprake,
14 pastaj do t'ju jap fjalën.

15 Së pari, të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
16 sallë të gjyqit.

17 Përpara se të fillojmë, siç e thamë dje, Trupi Gjykses
18 dëshiron të dëgjojë qëndrimin e Mbrojtjes së Thaçit lidhur me
19 përditësimet sa u takon dëshmitarëve të ardhshëm. Po ashtu
20 edhe nga Ekipet e Mbrojtjes të tjera, ZPS-ja dhe Mbrojtja e
21 Viktimave sa u takon kohës që do t'u duhet atyre, vlerësimet
22 që bëjnë për kohën që do t'u duhet për marrjen në pyetje.

23 Fillojmë me Mbrojtjen e Thaçit.

24 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar. Më
25 lejoni, më jepni një çast, ju lutem.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sigurisht.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Duhet të kontrolloj pak, duhet të
3 kontrolloj kodet e dëshmitarëve.

4 Po. Mund t'ju themi që kemi marrë autorizimin për
5 dëshmitarin 1DW-008 dhe 1DW-010. Pra, ata kanë autorizim
6 tanimë. Presim që të nxjerrim deklaratat e tyre këtë javë,
7 ndoshta nesër.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po
9 dëshmitarët e tjerët?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Na ngelet një dëshmitar për të
11 cilin presim autorizimin që është 1DW-0007 dhe më thuhet që ky
12 autorizim do të na vijë shumë shpejt.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pyetja ime
14 është: Synoni që t'i thërrisni të gjithë këta që të paraqiten
15 në Gjykatë?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mendoni që
18 keni akoma kohë, pra, koha ju mjafton që të mbaroni nga fundi
19 i tetorit?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Besojmë që po, por, natyrisht, ka
21 disa faktorë që ndërhyjnë. Kemi parashtruar një mocion mbi të
22 cilin nuk është vendosur akoma lidhur me një dëshmitar, pra,
23 nëse ai pranon dhe është, pra, mënyra nëse pranohet apo jo,
24 kjo do të ketë ndikim tek planifikimi i gjërave. Tani kemi një
25 dëshmitar të dytë për të cilin diskutuam dje. Varet se si

1 zgjidhet kjo çështje dhe mund të na lirojë kohë shtesë neve.

2 Pra, do t'ju njoftojmë për të gjithë dëshmitarët që mbeten dhe
3 që ne synojmë t'i mbarojmë ato brenda planit të paraparë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Po pyes ekipet e tjera të Mbrojtjes lidhur me pyetjet që mund
6 të kenë.

7 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit. Ne mund të themi që
8 lidhur me dëshmitarët për të cilët ne jemi të informuar, me
9 fjalë të tjera, për ata që kemi marrë materialet që janë
10 nxjerrë, vlerësimet që kemi bërë paraprakisht ngelin të
11 njëjta. Por natyrisht, siç e dini ju, shënimet përgatitore kur
12 të vijjnë mund të kërkojnë që të bëhet një rivlerësim i këtyre
13 dhe do ta bëjmë sa më shpejt që të jetë e mundur që t'ju japim
14 një përditësim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të gjithë
16 juve, po ju drejtohem të gjithëve juve, ju lutem veproni sa
17 më shpejt që është e mundur sepse kjo ka ndikim tejet të madh
18 në Mbrojtjen e Thaçit e cila po paraqet dëshmitarët e saj në
19 këtë kohë dhe do merremi me këtë pas pak.

20 Z. DIXON: [Përkthim] Në rregull.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem të
22 jeni sa më efikasë që është e mundur në ndryshimet apo
23 rivlerësimet që bëni të parashikimeve tua për kohën që do
24 t'ju duhet.

25 Z. DIXON: [Përkthim] Natyrisht, do ta bëjmë këtë gjë. Dhe

1 siç e dini ju, kjo varet gjithashtu dhe në leximin
2 përfundimtar të dokumenteve që na vijnë, që paraqiten si prova
3 dhe që do të përdoren si të tilla, po do të jemi sa më efikasë
4 që është e mundur.

5 Sa i takon tre dëshmitarëve që kanë ngelur, dua të presim
6 të shohim provat, por do të rishikojmë vlerësimet që kemi bërë
7 dhe do t'ju informojmë sa më shpejt që të jetë e mundur në
8 momentin që dalin këto dokumente.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

10 Z. DIXON: [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Tully.

12 Z. TULLY: [Përkthim] Faleminderit. Ne kemi të njëjtin
13 qëndrim dhe sa po të kemi deklaratat e dëshmitarëve të rinj do
14 t'ju japim një përditësim Trupit Gjykses. Faleminderit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

16 Z. Ellis.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Mendoj që kemi të njëjtin vlerësim
18 që kishim më parë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe ju
20 vazhdoni që të keni synimin që të thërrisni dëshmitarë të
21 njëjtë të cilët i kemi shënuar më herët?

22 Z. ELLIS: [Përkthim] Jemi duke shqyrtuar këtë, ndërkohë
23 që vijnë edhe provat, nxirren provat e tjera, dëshmitë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Në këtë moment që po flasim po.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
2 ZPS-ja.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. Vetëm një qartësim.
4 Kemi Dëshmitarin W01474 për të cilin pritët autorizimi. A ka
5 ndonjë përditësim për këtë?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Jemi duke pritur autorizimin për
7 këtë që është ekipi ynë po merret me këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 Dy pika tjera shtesë, njërën e keni sqaruar tashmë.
10 Faleminderit për përgjigjet tuaja të gjithëve. Siç e thashë,
11 përpiquni të na jepni përditësime sa më shpejt të jetë e
12 mundur sepse dhe ne kemi afate që po afrohen shumë shpejt dhe
13 do të donim t'i respektonim ato me qëllim që të përfundojmë me
14 paraqitjen e provave më datën 14 nëntor siç është parashikuar.

15 E di që është sfidë, por duhet të që gjithë të
16 bashkëpunojnë që të arrihet kjo.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni një çast.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përfundoj unë
19 një herë.

20 I kujtoj gjithashtu Mbrojtjes se nuk duhet të ketë, se
21 mund të ndodhë që të ketë boshllëqe, pra, orë të papërdorura
22 për javët që vijnë për në sallë të gjyqit. Mbrojtja e
23 Krasniqit, siç e thashë, duhet të jetë gati në qoftë se ka
24 momente që nuk i përdorim dot ditët e parashikuara, Mbrojtja e
25 Krasniqit duhet të jetë gati që të paraqesë dëshmitarët e saj,

1 në momentin që Mbrojtja e Thaçit përfundon, dhe besoj që është
2 relativisht e thjeshtë për t'u parashikuar.

3 Tani e keni fjalën ju, Misetic.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju ngritët pikën për planifikimin
5 siç është komunikuar edhe nga Trupi Gjykses, mendoj të paktën
6 se si çështje paraprake mendoj se katër Ekipet e Mbrojtjes
7 kanë dëshirë të shprehen, të shprehin qëndrimin e tyre në një
8 moment të caktuar kur të keni kohë gjatë kësaj jave.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

12 Sekretare, sillni dëshmitarin -- kërkoj ndjesë. Kishit një
13 korrigjim për të bërë, por harrova.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] S'ka problem. Faleminderit, z.
15 Kryetar. Thjesht çështje e vogël, kemi dërguar një email
16 palëve dhe pjesëmarrësve dhe Trupit Gjykses lidhur me provën
17 materiale tashmë të pranuar 1D003398, për shkak të një harrese
18 në mocionin tonë sipas rregullës 154, pra, F014310, prova
19 materiale shoqëruese 14 është renditur gabimisht që përfshihej
20 në numrat DHT05110 deri në DHT05110 në vend të DHT05110 deri
21 në DHT05112. Do të donim të shtonim dy faqe që mungojnë të
22 asaj pjese dhe e kuptojmë, sa e kuptojmë ne Prokuroria nuk ka
23 kundërshtime.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është e
25 saktë?

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E saktë.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Këto dy faze do të shtohen.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

6 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

7 [Dëshmitari vijon dëshminë]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjesi,

9 Z. Covey.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjesi.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të

12 vazhdojmë marrjen e dëshmisë suaj. Kishim arritur në pikën ku

13 do të fillojë tani Prokuroria t'ju bëjë pyetjet e saj.

14 Ju kujtoj se duhet t'u përgjigjeni pyetjeve në mënyrë të

15 qartë me fjali të shkurtra. Në qoftë se nuk e kuptoni ndonjë

16 pyetje të caktuar i kërkoni avokatit që të përsërisë pyetjen

17 apo i thoni atyre që nuk e kuptoni dhe keni nevojë që të

18 qartësohet. Gjithashtu, ju lutem kujtoni mos harroni të

19 tregoni bazën për njohurinë e fakteve, rrethanave mbi të cilat

20 po pyeteni.

21 Ju kujtoj që jeni akoma nën detyrimin për të thënë të

22 vërtetën siç thuhet në deklaratën solemne, betimin solemn që

23 keni bërë.

24 Gjithashtu, flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë minuta

25 përpara se t'i përgjigjeni pyetjes me qëllim që përkthyesit të

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 8

1 kenë kohë të përkthejnë.

2 Në qoftë se keni nevojë të bëni ndonjë pushim, na thoni
3 dhe do të bëjmë të mundur këtë gjë.

4 Fillojmë tani me pyetjet që do t'ju parashtrojë ZPS-ja.
5 Ju lutem përqendrohuni tek pyetjet e tyre.

6 Znj. Iodice.

7 DËSHMITARI: James Covey [Vijon]

8 Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice:

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

10 PY. Mirëmëngjes, Z. Covey.

11 PË. Mirëmëngjesi.

12 PY. Unë quhem Vega Iodice dhe do t'ju bëj disa pyetje në emër
13 të ZPS-së. Dua t'ju bëj pyetje për të cilat kërkohet përgjigje
14 po dhe jo kryesisht dhe do t'ju kërkoja që përqendroni
15 përgjigjet tuaja.

16 Së pari, do të fillojmë me disa pyetje paraprake lidhur
17 me rolin tuaj si zëvendës i parë i PSSP-së. A ju kujtohet, ju
18 jeni caktuar, emëruar në qershor të 1999-s? Ju kujtohet data e
19 saktë?

20 PË. Jo.

21 PY. Natyrisht në qoftë se nuk ju kujtohet diçka, mund të
22 thoni kështu sepse është në rregull.

23 Keni arritur në Kosovë më 15 qershor 1999?

24 PË. Po, kjo më kujtohet.

25 PY. Dhe si zëvendës i parë i PSSP-së a keni marrë informime

1 nga persona të lartë të shtyllave të Misionit?

2 PË. Në atë moment policia nuk ekzistonte në të vërtetë.

3 PY. Gjatë gjithë kohës që keni ushtruar funksionet si

4 zëvendës i parë i PSSP-së?

5 PË. Po.

6 PY. Normalisht keni rishikuar shqyrtuar raportet që janë

7 nxjerrë nga organizatat e tjera ndërkombëtare që punojnë aty

8 si, për shembull, OSBE-ja?

9 PË. OSBE-ja ishte menduar të ishte një prej shtyllave të
10 UNMIK-ut, pra, nuk do ta shihnim këtë si organizatë të ndarë.

11 PY. Dhe kur PSSP-ja nuk ishte e pranishme a e zëvendësonit
12 ju?

13 PË. Po.

14 PY. Siç u shënua dje, ju keni shqyrtuar, parë rregullisht
15 korrespondencën që ka dalë nga zyra e PSSP-së?

16 PË. E kam parë rregullisht këtë korrespondencë, po.

17 PY. Dhe ju keni miratuar kabllogramet që janë nxjerrë,
18 lëshuar nga PSSP-ja, nga zyra e tij kur ai nuk ishte vetë i
19 pranishëm e keni bërë ju?

20 PË. Po.

21 PY. Dhe këto kabllograme që i keni miratuar keni vënë mbi to
22 inicialet tuaj?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe në procesverbalet dhe kabllogramet juve përmendni atë
25 gjithmonë si zëvendësi i parë i PSSP-së?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 10

1 PË. Në përgjithësi, po

2 PY. Ndërsa akronimi, pra, zëvendësi, PSSP-së iu referohet
3 personave të tjerë që ishin zëvendës?

4 PË. Po.

5 PY. Në deklaratën tuaj ju përmendët se PSSP-ja kishte
6 marrëdhënie shumë të mirë, të shkëlqyer, pra, kishit ju me
7 PSSP-në një marrëdhënie të shkëlqyer dhe ju e keni informuar
8 njëri-tjetrin në kohë të shkurtër shumë shpejt kur njëri prej
9 jush nuk ishte i pranishëm. A është e saktë?

10 PË. E saktë.

11 PY. Dhe në paragrafin 11 të deklaratës tuaj, përmendet një
12 libër për të cilin ju jeni bashkautor që ju tregua dhe dje
13 gjatë -- që ju është treguar juve dhe gjatë seancës
14 përgatitore.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do kërkoja të shfaqim në
16 ekran dokumentin ERN SPOE00397775 deri në 00397846.

17 PY. Ky është libri për të cilin jini bashkautor?

18 PË. Po.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen PDF 3.

20 PY. Ky është botuar në 2005-n, siç thuhet këtu, e saktë?

21 PË. Saktë.

22 PY. Dhe ju jeni autori i dy kapitujve, por keni qenë edhe
23 editor i tij?

24 PË. Këtë punë e kam bërë shumë më pak, në një shkallë më të
25 kufizuar.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 11

1 PY. Në rregull.

2 PË. Dhe varej cili kapitull, për cilin kapitull po flasim.

3 PY. Faleminderit. Dhe ju e keni përdorur këtë libër si
4 referencë për 15 vitet e kaluara kur keni dhënë mësim?

5 PË. E saktë.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të përdor
7 disa faqe të këtij libri gjatë pyetjeve të mia. Synoj që ta
8 paraqes secilën, pra, në qoftë se më lejohet që të paraqes, që
9 të dorëzoj secilën faqe për t'u pranuar si dëshmitar -- se
10 cilën faqe do i tregoj dëshmitarit dhe po mendoj që ndoshta
11 është më mirë që libra si ky t'i dorëzoj në fund të pyetjeve
12 të mia në vend që ta bëj këtë faqe për faqe, pra, për secilën
13 faqe.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kur të
15 mbaroni me faqen do të prisja më mirë që ju ta dorëzonit atë
16 në atë kohë, ta paraqisni si për t'u pranuar në provë.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Meqenëse ashtu do të paraqes
18 faqen e parë për t'u pranuar si provë. Kopertina dhe tre faqet
19 e para të librit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
21 kundërshtim?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asnjë
24 kundërshtim. Tre faqet e para?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 12

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tre faqet e
2 para, SPOE00397775 deri në 397846, pranohen.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dhe këto do të marrin
4 numrin e provës materiale P04496, aktualisht janë të
5 klasifikuara si konfidenciale.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë publike.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
8 Riklasifikohet si publike.

9 Dhe do të sugjeroja që faqet e tjera që do të përdorni 1,
10 2, 3 mund të mbajnë të njëjtin titull.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull. Faleminderit. Mund ta
12 lëmë librin për një çast.

13 PY. Keni përshkruar komandantin e KFOR-it Jackson,
14 komandantin e KFOR-it që ka arritur në atë kohë, si një person
15 me "përvojë të gjerë" dhe dje thatë që të dy, juve dhe
16 Kouchner, kishit takime të rregullta me Jackson, e saktë?

17 PË. Po. Dhe do të shtoja se unë e njihja më parë Jackson, e
18 njihja që nga përvoja të mia të mëparshme në Bosnjë kur ishte
19 në selinë qendrore në Banja Luka ai.

20 PY. Në rregull.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të kërkoj të shfaqin në ekran
22 dokumentin, faqet PDF 26, 27 të librit në fjalë. Këto janë ERN
23 SPOE00397800 dhe 7801.

24 PY. Këtu keni përshkruar mënyrën se si Kouchner dhe Gjenerali
25 Jackson kuptoheshin mirë me njëri-tjetrin, kalonin mirë dhe

1 kjo ishte një avantazh shtesë.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në qoftë se mund të përqendrohemi
3 tek paragrafi i fundit i librit në faqen 81 që është faqja e
4 dytë në ekran. Faleminderit.

5 PY. Këtu ju keni thënë:

6 "Marrëdhënia e mirë e natyrshme mes PSSP-së, Bernard
7 Kouchner, dhe Gjeneralit Mike Jackson ishte avantazh tejet i
8 rëndësishëm. Por ishte edhe më e rëndësishme që të dy kishin
9 një qasje të punës së tyre me vizion të ngjashëm dhe për këtë
10 *partnership*, pra, për këtë bashkëpunim që ishte, kjo ishte
11 tejet i rëndësishëm. Të dy u pajtuan dhe ishin dakord se puna
12 kryesore në fillim duhej të ishte misioni ushtarak."

13 Pastaj më poshtë keni thënë që:

14 "Ata gjithashtu kuptuan, megjithatë, se KFOR-i nuk mund
15 të kishte sukses në misionin e tij të përgjithshëm pa një
16 proces politik që ishte i suksesshëm në terma afatgjatë.
17 Komandanti ushtarak duhej të kontribuonte në këtë përpjekje të
18 përpjekjeve politike."

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk është në ekran më duket, z.
20 Kryetar.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Jo, nuk është.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund t'i tregohet
23 dëshmitarit në ekran.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër. Kërkoj

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 14

1 ndjesë. Është në krye të faqes.

2 PY. "Klasifikimi gjendej në mandat dhe në qasjen që kishin
3 për misionin civil dhe udhëheqjen ushtarake."

4 Ky ishte përshkrimi i marrëdhënies së tyre, apo jo?

5 PË. Po, dhe në qoftë se mund të shtjelloj pak më tej?

6 PY. Po. Mund t'ju bëj pyetje të tjera lidhur me këto më vonë,
7 ndoshta do t'i kthehem më vonë kur të -- ato që s'i kemi
8 trajtuar.

9 PË. Dua të theksoj se nuk ishte e rastësishme që marrëdhënia
10 midis krahut ushtarak dhe civil të Misionit ishte shumë
11 ndryshe në Kosovë nga çka kishte qenë në Bosnjë. Dhe kjo, do
12 të më duhet vetëm pak kohë. Pra, Gjenerali Jackson pas
13 arritjes së tij atje tha që "KFOR mund të marrë rolin e tij që
14 i vjen, që buron nga ligji, rolin e tij të duhur në këtë
15 mision në mbështetje të procesit politik".

16 PY. Faleminderit.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të doja që të paraqes
18 këto faqe SPOE00397800 dhe 7801 për pranim në prova.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këto dy faqe
20 pranohen dhe do të shënohen si prova materiale me shtojcën 1.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në
22 këtë rast kjo do të marrë numrin e provës materiale P04496.1,
23 klasifikuar si publik dhe mbahet si e tillë, besoj, apo jo?

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

25 PY. Jackson u largua nga funksioni i tij si komandant i KFOR-

1 it në tetor të 1999-s dhe u zëvendësua nga Gjenerali Claus

2 Reinhardt, është e saktë?

3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe Gjenerali --

5 PË. Dhe po konsideroj që këto data janë të sakta sepse nuk i
6 kam unë datat.

7 PY. Në rregull. A ju kujtohet nëse Gjenerali Reinhardt
8 qëndroi si komandant përafërsisht rreth gjashtë muaj deri në
9 mes të prillit të vitit 2000?

10 PË. Përafërsisht kështu duhet të jetë.

11 PY. Faleminderit. Dhe marrëdhënia e shkëlqyer e punës që ju
12 dhe Kouchner kishit me Jackson vazhdoi me Gjeneralin
13 Reinhardt, a është kështu?

14 PË. Po.

15 PY. Faleminderit.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kërkoj të shfaqim në
17 ekran SPOE40015904 deri në 40016230 dhe përkthimi në anglisht
18 që përfundon me E Rishikuar Pjesërisht Kombinuar. A mund të
19 kalojmë tek faqja 2 PDF në dokumentin origjinal? Dhe mbajmë të
20 njëjtin dokument.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Iodice,
22 a është i njëjti libër?

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo. Është libër tjetër.

24 PY. Ky është libër i publikua, i botuar nga Gjenerali
25 Reinhardt, "Trupat e KFOR-it për paqe, Shënime ditari të një

1 komandanti gjerman në Kosovë". E njihni këtë libër?

2 PË. Jo.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen 5 PDF dhe është
4 SPOE40015929 dhe në origjinal është PDF faqe 26. Do t'ju
5 kërkoja të përqendroheshit në fund të faqes në versionin
6 anglisht.

7 PY. Këtu Gjenerali Reinhardt përshkruan vizitën e parë që ka
8 patur me juve. Ai shkruan:

9 "Ne bëmë vizitën e parë zyrtare tek Bernard Kouchner dhe
10 zëvendësi i tij --

11 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të na jepni referencën e
12 saktë, ju lutem?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Pjesa në anglisht
14 është në faqen tjetër në fund të faqes. Po.

15 PY. "Ne bëmë vizitën e parë zyrtare tek Bernard Kouchner dhe
16 tek zëvendësi i tij Jock Covey. Covey kishte një ndikim
17 qetësues në të gjitha situatat e vështira dhe ishte ekspert me
18 përvojën në negociata me Kombet e Bashkuara në Nju Jork dhe
19 gjithashtu me politikanët në Prishtinë. Ai kishte fituar,
20 grumbulluar këtë përvojë në Sarajevë si i dërguari i Shtetet e
21 Bashkuara në Sarajevë dhe si i dërguari i Shtetet e Bashkuara
22 në Berlin. Pra, asgjë nuk mund ta destabilizonte atë."

23 Tani zbresim më poshtë, paragrafi i fundit, ku ai shënon
24 se si ai vuri KFOR-in nën autoritetin e Kouchner, dëshirave të
25 Kouchner dhe sa e rëndësishme ishte që të kishin një qëndrim

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 17

1 të përbashkët për të arritur objektivat e bashkësisë
2 ndërkombëtare dhe se si nuk e kanë lejuar që të krijohen
3 përçarje apo ndarje mes tyre.

4 Mendoj që ju pajtoheni me këtë, apo jo?

5 PË. Po.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen PDF 101 të
8 origjinalit dhe 27 PDF në versionin anglisht. Dokumenti është
9 SPOE40016004. Po presim një çast sa të shfaqet në ekran
10 versioni në anglisht. Për versionin në anglisht kemi
11 përkthimin e një përshkrimi të shkurtër.

12 PY. A i njihni këtu në këtë fotografi Kouchner dhe Reinhardt?

13 PË. Po. Dhe ai e quan atë binjak i tij.

14 PY. E saktë. Faleminderit.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani paraqes këto faqe për pranim
16 në prova. Faqet në fjalë janë SPOE4001, 5905, 40016004,
17 40015929.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
19 kundërshtim?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
22 Gjykatës. Këto faqe do të marrin numrin e provës materiale
23 P04497, klasifikimi aktual është publik. Faleminderit.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran
25 SPOE00403545 deri 00403566 dhe përkthimi në anglisht.

1 PY. Ky libër është shkruar nga Dr. Kouchner dhe quhet

2 "Luftëtarët e pages". A keni dijeni për të?

3 PË. Po. Në fakt, e kam lënë një kopje kohët e fundit, po më
4 duket e kam vetëm në gjuhën franceze, po nuk e kam lexuar. Jam
5 impresionuar që e keni të përkthyer.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 3 PDF të
8 origjinalit SPOE00403547. Të shohim hollësitë redaksionale ju
9 lutem.

10 PY. Tregohet këtu se është botuar në vitin 2004 në gjuhën
11 franceze, vetëm në gjuhën franceze. A e shihni këtë pjesë?

12 PË. A e shoh datën e botimit?

13 PY. Po.

14 PË. Po.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë të kalojmë në faqen 11 në
16 PDF në të dy gjuhët, SPOE00403555. Ta zmadhojmë versionin në
17 anglisht.

18 PY. Në paragrafin e dytë në anglisht Kouchner shkruan lidhur
19 me bashkëpunimin me Gjeneral Reinhardt, ku thotë se:

20 "Gjithnjë kemi reaguar së bashku, civilët dhe ushtarakët
21 së bashku, nuk ekzistonte mundësia që t'ia kalonim fajin
22 njëri-tjetrit."

23 Dhe më pas thuhet që:

24 "Ne e paraqitëm veten si binjakët e këtij misioni, asnjë
25 vendim i rëndësishëm nuk është marrë pa arritur konsensusin e

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 19

1 të dy drejtuesve.”

2 Unë besoj që jeni dakord edhe me këtë vlerësim të z.

3 Kouchner, apo jo?

4 PË. Më duket se ju dëgjoj me vështirësi në mikrofon. Mund të
5 ngrini zërin mbase?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mbase mund t’ia ngremë volumin në
7 kufje dëshmitarit?

8 DËSHMITARI: [Përkthim] Vazhdoni, ju lutem.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

10 PY. A i dëgjuat këto pjesë që lexova?

11 PË. A mund t’i lexosh edhe një herë?

12 PY. Këtu thuhet:

13 “Ne gjithnjë kemi reaguar së bashku, civilët dhe
14 ushtarakët së bashku, nuk kishte, nuk shtrohej çështja që t’ia
15 kalonim fajin njëri-tjetrit.”

16 Dhe më pas thotë:

17 “Ne u paraqitëm si binjakët e këtij misioni, asnjë vendim
18 i rëndësishëm nuk është marrë pa konsensusin e të dy
19 drejtuesve.”

20 Pra, këtë thotë kur shpreh marrëdhëniet me Gjeneralin
21 Reinhardt dhe besoj që jeni dakord me këtë vlerësim?

22 PË. Në përgjithësi, po.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dua që t’i paraqes për pranim si
24 prova materiale. SPOE00403555 deri në 3557 dhe më pas 003555.
25 Që është faqja e titullit plus këtë faqe që përdora.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 20

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
2 kundërshtim?

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtim.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00403545
5 deri në 00403547 së bashku me faqen e tretë në PDF -- ju
6 kërkoj ndjesë, në faqen 11.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund ta lexoj numrin e provës dhe
8 një herë, i nderuar Gjykatës.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ashtu është.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do
12 t'i përsëris tre shifrat e fundit që nuk u shënuan. Ishte
13 00403555, së bashku me 00403545 deri në 47, do të ketë numrin
14 e provës materiale P4498, aktualisht është konfidenciale.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të jetë
16 publik besoj?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Unë propozova dhe faqen që
18 përfundon me shifrën 403555, që është kjo faqe.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, tha që
20 kjo është e përfshirë. Do të riklasifikohet si publik.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

22 PY. Në deklaratën tuaj në paragrafin 17, keni përmendur
23 shkurtimisht mandatin e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit
24 1244 dhe dua që ta lexojmë së bashku.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pra, a mund të vendosim 1D00078

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 21

1 në ekran.

2 PY. Kjo është rezoluta që jam i sigurtë që e njihni shumë
3 mirë.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe mund të kalojmë në faqen e
5 dytë në PDF dhe të përqendrohemi në paragrafin që është mbi
6 pikën 1.

7 PY. Në këtë paragraf thuhet që Këshilli i Sigurimit vepron
8 nën Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara, që është
9 edhe karta që i lejon veprimet e detyrës ushtarake në raste
10 kanosjes ndaj paqes, kështu është?

11 PË. Po.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen pasuese, të
13 përqendrohemi tek paragrafi 9 dhe nën paragrafët e tij.

14 PY. Kjo pjesë e përcakton mandatin e KFOR-it, kështu është?

15 PË. Po.

16 PY. Përfshirë:

17 "Çështjen që ka të bëjë me sigurinë publike dhe krijimin
18 deri në momentin që këtë detyrë ta marrë përsipër prezenca
19 civile ndërkombëtare."

20 Që është në pikat (c) dhe (d), kështu është?

21 PË. Po.

22 PY. Në fund të kësaj faqeje, në paragrafin 11, përcaktohen
23 detyrat e pranisë civile, kështu është?

24 PË. Po.

25 PY. Dakord. Faleminderit. Dua t'ju pyes tani lidhur me

1 njohuritë që keni pasur ju për UÇK-në. E keni përmendur këtu
2 në deklaratën tuaj.

3 PË. Njohurinë e?

4 PY. UÇK-së.

5 A keni dijeni se kur është shfaqur për herë të parë
6 publikisht UÇK-ja?

7 PË. Jo.

8 PY. Dhe unë nuk besoj që nuk keni dijeni as edhe me
9 rregulloret e UÇK-së, apo jo?

10 PË. Jo.

11 PY. A keni dijeni mbi përmbajtjen e ndonjë urdhri të UÇK-së?

12 PË. Nuk besoj.

13 PY. Faleminderit. A keni dijeni lidhur me rolet e Azem Sylës
14 dhe Sokol Bashotës?

15 PË. Jo.

16 PY. A keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë shkëmbim të
17 burgosurish që ndodhi në janar të vitit 1999?

18 PË. Jo, nuk kam dijeni.

19 PY. Faleminderit.

20 PË. Më lejoni të shtoj se në atë kohë nuk kam qenë i
21 përfshirë në këtë, kam punuar në Universitetin e Mbrojtjes
22 Kombëtare, kam qenë duke punuar në një projekt që kishte të
23 bënte me një libër që do të shfrytëzohej për prakticienët e së
24 ardhmes, nuk isha i përqendruar në ngjarjet në Kosovë. Nuk i
25 kam ndjekur në të njëjtën mënyrë siç i kisha ndjekur më parë

1 kur kam punuar në Këshillin e Sigurisë Ndërkombëtare.

2 Kështu që, jo, është përgjigja, nuk kam pasur dijeni.

3 PY. Faleminderit. Në seancën përgatitore ju thatë që nuk jeni
4 në dijeni se për çfarë është shkurtesa PU?

5 PË. Kam hamendësuar që kishte të bënte me një njësit
6 paraushtarak, po jo, nuk e di.

7 PY. Faleminderit. Në deklaratën tuaj e keni përshkruar Hashim
8 Thaçin si jo ushtar, jo ushtarak dhe po kështu dhe
9 marrëdhëniet me UÇK-në si shumë të vështira. Dua t'ju pyes, do
10 ju bëj disa pyetje lidhur me njohuritë që keni pasur për
11 Hashim Thaçin.

12 Ju keni pasur dijeni që ai kishte kryesuar delegacionin
13 shqiptar në Rambuje, kështu është?

14 PË. Nga historia e di se në përfundim të Rambujesë ishte
15 caktuar të ishte kryeministri i Qeverisë së Përkohshme. Unë,
16 siç e thashë, isha i përfshirë në një projekt tjetër në
17 universitet kështu që nuk e di se në çfarë cilësie ishte ftuar
18 apo cili është roli që ka luajtur gjatë diskutimeve të
19 brendshme të mbajtura në Rambuje.

20 PY. Faleminderit. Po kështu ju kishit dijeni që ai kishte
21 nënshkruar marrëveshjen në fjalë?

22 PË. Po.

23 PY. A keni pasur dijeni se kush kanë qenë themeluesit e UÇK-
24 së?

25 PË. Jo.

1 PY. A keni patur njohuri lidhur me rolin e LPK-së për

2 krijimin e UÇK-së?

3 PË. Nuk mund të them se kam dijeni, jo.

4 PY. Faleminderit. A keni pasur dijeni se kë ka caktuar LPK-ja

5 si përgjegjës për të krijuar dhe ndërtuar UÇK-në?

6 PË. Jo.

7 PY. A keni pasur dijeni që UÇK-ja kishte nisur një sulm të

8 sinkronizuar duke shfrytëzuar granatahedhësit sulm kundër disa

9 stacioneve policore serbe në shtator të vitit 1997?

10 PË. Po përpiqem të kujtoj se ku kam qenë në atë kohë. Mund të

11 kem pasur dijeni.

12 PY. Do të përpiqem t'ju rifreskoj kujtesën për të parë nëse

13 do t'ju kujtohet.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të vendosim në ekran

15 SPOE00131751 deri 00131857 dhe përkthimin në anglisht që ka

16 numrin rendor SPOE00131824 deri SPOE00131857-ET.

17 PY. Ndërkohë që presim të na shfaqen në ekran, a keni dijeni

18 se kush i ka sjellë në Kosovë këto granatahedhëse vetëm një

19 muaj përpara këtyre sulmeve të koordinuara?

20 PË. Jo.

21 PY. Faleminderit.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 9 në PDF në

23 anglisht, që është faqja 82 e PDF në variantin në shqip.

24 Përqendrohuni në pyetjen e fundit në këtë faqe që ndodhet në

25 fund të saj.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 25

1 PY. Këtu pyetet, dhe kjo është një intervistë me Rexhep
2 Selimin e botuar në vitin 2003. Aty e kanë pyetur lidhur me
3 logjistikën dhe ushqimet për ushtarët e UÇK-së. Dhe ai thotë,
4 në fund të kësaj faqeje, në tre rreshtat e fundit:

5 "Pas tre të parave, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli sollën
6 mortaja të tjera dore në Jabllanicë në gusht të vitit 1997."

7 Të kalojmë në faqen tjetër:

8 "... pra, sa i përket këtyre mortajave të dorës, kishim
9 11 të tilla. Tre erdhën me forma të tjera dhe më pas kemi
10 patur 14 për t'i përgatitur për 14 veprime në 11 shtator 1997.
11 Deri në atë ditë nuk kishim shfrytëzuar asnjë prej tyre
12 pavarësisht se ndonëse kishim nevojë t'i përdornim me qëllim
13 që Serbia të mos merrte masa sepse në atë kohë llogarisnim që
14 kjo është një armë e madhe dhe dëshironim ta zinim Serbinë në
15 befasi, siç edhe e zëmë duke organizuar një aksion shumë të
16 fuqishëm dhe të sinkronizuar në shtator 1997. Patëm 14 mortaja
17 dhe bëmë 14 aksione. Po të kishim patur 20 do të bënim 20
18 aksione."

19 A të kujtohet kjo ngjarje?

20 PË. Jo.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, unë dua që
22 t'i paraqes për pranim këto dy faqe që kanë shifrën
23 SPOE00131832 dhe SPOE00131833.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Keni ndonjë
25 kundërshtim?

1 Z. TULLY: [Përkthim] Po, ne kemi kundërshtim. Të hënën
2 Prokuroria dërgoi një email ku ka thënë në mënyrë të pasaktë
3 se këto ishin autorizuar nga Trupi Gjykses këto materiale që
4 do të paraqiste. Z. Roberts iu përgjigj këtij emaili në të
5 njëjtën ditë.

6 Duke i kujtuar Trupit Gjykses që ka përfunduar periudha
7 kur ZPS-ja mund të paraqiste provat e saj, kanë patur muaj dhe
8 ditë të tëra dhe kjo është një përpjekje për ta rihapur atë
9 proces dhe për të paraqitur këto dokumente. Dokumente për të
10 cilat dëshmitari nuk ka thënë asgjë, që thotë që nuk ka
11 njohuri për këtë incident dhe nuk shton asgjë. Faleminderit.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund -- unë jam dakord.
13 Dëshmitari nuk ka dhënë asnjë koment.

14 Z. DIXON: [Përkthim] Po kështu edhe ne jemi dakord. Kjo
15 është një periudhë e vitit 1997. Nuk ka të bëjë asgjë me
16 thelbin e dëshmisë së tij dhe ne ngremë edhe çështjen e
17 referencës lidhur me këtë aspekt.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Arsyeja se përse e kemi dërguar
19 këtë email mes palëve është se gjatë përgatitjes së këtij
20 dëshmitari, vumë re se nuk kishim pranuar këto dy faqe. Kur e
21 paraqitëm këtë dokument, këtë dokument, në fakt, e kemi
22 përdorur me 4401. Dhe, në fund, paraqitëm të gjitha faqet dhe,
23 në fakt, të tërë dokumentin dhe ju, i nderuar Gjykatës, më 4
24 dhjetor morët vendimin se pjesët e intervistës të cilat i janë
25 paraqitur dëshmitarit përmbushin kriteret për pranim.

1 Ne kemi besuar në atë kohë se edhe këto fage ishin
2 pranuar në atë kohë dhe kjo ishte arsyeja përse e dërguam këtë
3 javë emailin që dërguam. Ne menduam që ishte një gabim që nuk
4 ishin pranuar. Megjithatë, po i paraqisnim tani veçmas. Dhe
5 arsyeja për pranimin, sa i përket relevancës, ka të bëjë me
6 dëshminë që po jep ky dëshmitar. Thjesht dëshmitari flet për
7 marrëdhëniet e vështira që ka pasur me UÇK-në Hashim Thaçin.
8 Këtu po flasim për 1997-n. Ai ka folur se Hashim Thaçi nuk ka
9 qenë luftarak. Ndërsa këtu tregohet pjesa se si ai i ka
10 dërguar armë UÇK-së.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund të përgjigjem?

12 Dëshmitari në dëshminë e tij kryesore ka folur vetëm për
13 periudhën kur ka arritur në Kosovë, që nga korriku i 1999 dhe
14 kjo nuk ka asgjë të bëjë me z. Thaçi dhe marrëdhëniet e tij me
15 UÇK-në. Dëshmitari nuk ka thënë që ka patur ndonjë bazë për
16 njohuritë e tija lidhur me marrëdhëniet e z. Thaçi me UÇK-në
17 përpara mbërritjes së tij.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Me gjithë respektin që kam, i
19 nderuar Gjykatës, z. Misetiç po jep dëshmi këtu, kjo nuk ishte
20 pjesë e dëshmisë së tij, por unë kam detyrë për të eksploruar
21 të gjitha gjërat që ka thënë në deklaratën e tij dëshmitari.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë dua të shtoj, kjo ka të bëjë
23 me faktin që vendimi i mëhershëm i Trupit Gjykses ishte i
24 qartë që bëhej fjalë për pranimin e një fageje të vetme dhe
25 prandaj të katër ekipet e Mbrojtjes e kanë kundërshtuar një

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 28

1 gjë të tillë.

2 E dyta, unë nuk po e interpretoj gabim atë që ka thënë
3 dëshmitari. Dëshmitari e ka bërë të qartë se ai nuk ka
4 komentuar mbi gjëra që nuk i ka parë vetë, ai ka thënë që nuk
5 shef asgjë, nuk ka shtuar asgjë.

6 Në qoftë se doni që Prokuroria dëshiron që kjo të ishte
7 pjesë e provave materiale duhet ta kishte paraqitur atë përmes
8 procedurës jo gojore apo ndonjë mënyre tjetër.

9 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKSES SMITH: [Përkthim] Këto dy faqe
11 do të pranohen. Janë relevante. Kanë të bëjnë me njohuritë e
12 tij lidhur me z. Thaçi dhe rolin e tij dhe kjo çështje është
13 ngritur gjatë pyetjeve që ka bërë Pala e Mbrojtjes. Do ta
14 pranojmë.

15 Ju lutem, vendosini një numër prove.

16 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mund të kem një sqarim?
17 Këto dy faqe t'ia shtojmë dokumentit të pranuar më herët që
18 është P01883 apo t'i japim numër të ri prove?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ne do të preferonim që t'i
20 shtoheshin asaj prove materiale.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKSES SMITH: [Përkthim] Atëherë
22 shtojani provës materiale 1883.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Faqet
24 SPOE00131832 dhe 833 do t'i shtohen provës materiale P01883,
25 klasifikimi publik.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 29

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, a mund të më jepni ca
2 kohë gjatë pushimit apo kështu, ne duam të bëjmë një
3 kundërshtim të cilin nuk dua ta -- zyrtar këtë nuk dua ta bëj
4 në praninë e dëshmitarit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

6 PY. Ju kërkoj ndjesë për këtë ndërprerje. Tani i kthehem
7 njohurive që ke pasur ti lidhur me z. Hashim Thaçi. Ju keni
8 pasur dijeni lidhur mbi sulmin mbi shtëpinë e Jasharit?

9 PË. Po.

10 PY. A keni pasur dijeni që kjo ka çuar në një fluks të madh
11 njerëzish që kanë shkuar në Kosovë për t'iu bashkuar UÇK-së?

12 PË. Nuk i kam ndjekur nga afër këto zhvillime. Në atë kohë në
13 Këshillin e Sigurimit unë kam qenë i përqendruar në zbatimin e
14 Marrëveshjes së Dayton, pra, përgjigja e shkurtër është po,
15 kam patur dijeni por jo në hollësi, hollësitë kanë qenë të
16 pakta.

17 PY. A keni pasur dijeni lidhur me ushtarakë profesionistë të
18 cilët i janë bashkuar UÇK-së në pranverë dhe verë të 1998-s?

19 PË. Jo.

20 PY. Pra, nuk keni patur dijeni nëse ata do të duhej të
21 autorizoheshin nga UÇK-ja përpara se të anëtarësoheshin?

22 PË. Jo, nuk e di.

23 PY. Faleminderit. A keni dëgjuar për marrjen nën kontroll të
24 minierës së Bellagevcit në Bardh të Madh nga UÇK-ja?

25 PË. Jo.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 30

1 PY. A keni dëgjuar ndonjëherë nëse në atë vend ka qenë, në
2 Bellagevc, pra, në Bardh të Madh ka qenë Hashim Thaçi në kohën
3 kur ka qenë ky vend në duart apo nën kontrollin e UÇK-së?

4 PË. Jo.

5 PY. Do t'ju tregoj një video të shkurtër përpara se të marrim
6 pushimin.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të vendosim në ekran P01273 me
8 transkriptin në anglisht. Të lozim vetëm videon se s'kemi
9 nevojë për transkriptin. Deri në 00:34 sekonda.

10 [Luhet videoincizimi]

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

12 PY. Personi i cili ka filmuar këtë i ka identifikuar këta
13 ushtarakë me emrat Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe ndodhur kjo në numrin e
15 transkriptit 16650 të datë 4 qershor 2024.

16 PY. Besoj që nuk e ke parë këtë video, apo jo?

17 PË. Jo, nuk e kam parë.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë kohë e mirë për të
19 marrë pushimin.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, do
21 të japim dhjetë minuta pushim.

22 DËSHMITARI: Faleminderit.

23 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pushim për
25 dhjetë minuta.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 31

1 --- Seanca ndërpritet në orën 09.58

2 --- Seanca rifillon në orën 10.04

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
4 sillni dëshmitarin në sallë.

5 [Dëshmitari vijon dëshminë]

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
7 Do të vijojmë me pyetjet nga Zyra e Prokurorit të
8 Specializuar.

9 Znj. Iodice, fjala është për ju.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

11 PY. Kam disa pyetje të tjera lidhur me njohuritë e
12 përgjithshme që keni ju. A keni dëgjuar ndonjëherë për marrjen
13 e qytezës së Rahovecit prej UÇK-së?

14 PË. Edhe mund të kem dëgjuar, por nuk mund t'ju jap hollësi
15 lidhur me këtë.

16 PY. Në rregull. Keni dëgjuar ndonjëherë për betejën e
17 Llapushnikut?

18 PË. Nuk më kujtohet. Nuk besoj.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, mund të vendosim në
21 ekran materialin P02841 dhe transkriptin përkatës që përfundon
22 me ET në fund.

23 Ju lutem, të shohim videon.

24 [Luhet videoincizimi]

25 [Përkthim] "... me mijëra janë mbledhur në qytetin e

1 Rahovecit për të përshëndetur Hashim Thaçin. Drejtuesi politik
2 i UÇK-së dhe aktualisht shqiptari më i njohur në Kosovë,
3 Thaçi, shkoi në qytet me 300 luftëtarë -- ku ishin 300
4 luftëtarë me uniforma të UÇK-së, edhe u përkujtuan luftimet
5 nga ushtarët e UÇK-së, dhe ky ishte një rikthim triumfant.

6 "Thaçi iu drejtua turmave dhe foli dhe tha: 'Të nderuar
7 qytetarë të Rahovecit, forcat progresive të botës, ju
8 faleminderit që keni ndihmuar dhe vazhdimisht keni ndihmuar
9 për sistemet e reja të demokracisë. Të përkujtojmë sot të
10 gjithë luftëtarët që kanë rënë në luftë. Ky është një qytet i
11 ndarë mes shqiptarëve dhe serbëve, dhe ne -- sigurisht që nuk
12 do të shërohen kaq lehtë plagët'. Thaçi kërkoi që të kishte
13 tolerancë mes grupeve të ndryshme etnike, por turma nuk ishte
14 ende e gatshme ta dëgjonte këtë thirrje."

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

16 PY. Kjo ka ndodhur në korrik të 1999-s, ju sapo kishit
17 mbërritur. Dhe kështu është mirëpritur z. Hashim Thaçi në
18 Rahovec në një përkujtimore të UÇK-së. Keni pasur dijeni për
19 këtë?

20 PË. E di që njëhej si drejtues politik. Ne -- ju thoni më 17
21 ka ndodhur kjo? Kjo ka qenë dy ditë pasi kishim mbërritur ne.

22 PY. Po, më 17.

23 PË. Nuk më kujtohet mirë.

24 PY. Nuk ka problem.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shohim në ekran materialin

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 33

1 SPOE00397775 deri në 00397846.

2 PY. Dhe ky është sërish libri jua që do të shohim në ekran.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, shkojmë në faqen PDF me
4 numër 36, me numër SPOE00397810. Shkojmë në fund të faqes me
5 numër 100. Kalojmë në faqen tjetër, pasi të përfundojmë këtë
6 paragrafin që të fillojmë të lexojmë.

7 PY. Ju keni shkruar:

8 "Gjatë shtypjes dhjetëvjeçare të Millosheviqit sa i takon
9 komunitetit shqiptar, LDK-ja kishte ruajtur një aparat paralel
10 çuditërisht të sofistikuar ku drejtonte shkollat, spitalet dhe
11 ofronte shërbimet publike bazë për komunitetin shqiptar.
12 Sidoqoftë, në fillim të viteve 1990, disa nacionalistë
13 shqiptarë dhe drejtues studentorë, filluan ta shihnin LDK-në
14 si pjesë të regjimit serb, dhe Rugovën si instrumentin e tij.
15 Shumë prej këtyre drejtuesve të studentëve të inatosur
16 (përfshirë Hashim Thaçin në moshë të re), më në fund u bënë
17 personazhet kryesore të UÇK-së. Për ta, fakti që Rugova ishte
18 takuar me Millosheviqin para luftës, konfirmonte rolin e tij
19 si bashkëpunëtor."

20 Këto kanë qenë fjalët tua në vitin 2005, apo jo?

21 PË. Që të jem i saktë, kur kam thënë "janë bërë personazhe
22 kryesore në UÇK", pa përshkruar rolet e tyre.

23 PY. Po, në rregull. Nuk ka problem.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të pranohet kjo faqe?

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 34

1 kundërshtime?

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

4 Materiali me numër SPOE00397810 pranohet.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali do të marrë
6 numrin e provës, pra, P04496.2, dhe klasifikimi është publik.
7 Faleminderit.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

9 PY. Në deklaratën që i keni dhënë Mbrojtjes, keni konfirmuar
10 se herën e parë që ju dhe z. Kouchner keni parë z. Thaçi
11 bashkë në të njëjtën hapësirë me drejtuesit rajonalë,
12 komandantët rajonalë, ka qenë në seancën e fundit të takimit
13 të KPI-së në mes të shtatorit 1999, apo jo?

14 PË. Po.

15 PY. Faleminderit. A keni pasur dijeni për paradën e UÇK-së që
16 është organizuar në Prishtinë më 18 shtator 1999?

17 PË. Nuk më kujtohet qartë.

18 PY. Në rregull. Do t'ju tregoj një video sepse mbase ju
19 ndihmon me kujtesën.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, shohim në ekran
21 materialin 129402-08 [Sipas përkthimit], dhe transkriptin që
22 përfundon me TR-GT-ET.

23 Të shohim videon nga 03:55 deri në 04:27. Transkriptin e
24 kemi në ekran.

25 [Luhet videoincizimi]

1 [Përkthim] "... këtë e quanim paradë të fitores, por ende
2 nuk e kanë arritur qëllimin kryesor që është pavarësia. 24 orë
3 përpara demilitarizimit, gati 2000 ushtarë të UÇK-së nga i
4 gjithë vendi bënë paradë sot në stadiumin e futbollit në
5 Prishtinë, ku u brohoritën nga 40 mijë Kosovarë. Ka qenë hera
6 e fundit që paraqiteshin me uniformë, që dilnin me uniformë,
7 sepse nga mesnata e të hënës UÇK-ja nuk do të ekzistojë më dhe
8 do të transformohet në Trupat e Kosovës Civile".

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, kthehemi pak, ju lutem,
10 shikojmë edhe një herë 04:27.

11 PY. Në këtë video, në këtë pjesë e shihni Hashim Thaçi?

12 PË. Po, më duket si z. Thaçi, më duket sikur përbri tij është
13 z. Çeku, Gjeneral Çeku.

14 PY. A mund të na e përshkruani çfarë ka veshur Hashim Thaçi
15 që ta kuptojmë që e keni të qartë se për cilin po flisni?

16 PË. Ka vesh një kostum ngjyrë të zi.

17 PY. Është personi mes dy personave me uniformë.

18 PË. Po, është personi në mes të dy personave që kanë
19 uniformë.

20 PY. Në rregull.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të vazhdojmë të shohim videon
22 deri në 04:52 dhe të ndalojmë aty.

23 [Luhet videoincizimi]

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

25 PY. Po ju keni marrë pjesë në këtë ceremoni, ju kujtohet?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 36

1 PË. Jo, nuk kemi marrë pjesë.

2 PY. A ju kujtohet që ka pasur një paradë të tillë, a ju
3 ndihmon kjo me kujtesën?

4 PË. Nuk më kujtohet konkretisht, por shumë e mundshme është
5 të ketë ndodhur, sidomos meqë po afronte afati përfundimtar.

6 PY. Faleminderit.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e kësaj videoje
8 si provë gjyqësore.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
10 kundërshtime?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] I njëjti kundërshtim për të cilin
12 do të jap parashtime pak më vonë, por pra praninë e
13 dëshmitarit. Nuk mendoj që dëshmitari ka dhënë ndonjë kontekst
14 lidhur me këtë video.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dëshmitari foli për rolin e
16 Hashim Thaçit në UÇK, dhe kjo lidhet me vijimësinë e rolit që
17 ka pasur Hashim Thaçi në UÇK.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
19 129412-08, 03:55 deri në 04:27 dhe më pas 04:52, do të
20 pranohet.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatës.
22 Kjo pjesë do të marrë numrin e provës P04499, dhe klasifikimi
23 aktual është konfidencial.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Videoja mund të jetë publike,
25 desha të thoja.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 37

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]

2 Riklasifikojeni.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull. Mund të kalojmë në
4 seancë private për dokumentin e radhës, për shkak të kushteve
5 që na ka vendosur ofruesi i materialit?

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
7 seancë private.

8 [Seancë private]

9 [Seancë private teksti i fshirë]

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 38

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 39

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 40

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 41

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24 [Seancë e hapur]

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 42

1 Faleminderit.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

3 PY. Z. Covey, në deklaratën tuaj në paragrafin 59 dhe 65,
4 përmendni marrëdhënien midis Hashim Thaçit dhe Agim Çekut. Dhe
5 gjatë seancës përgatitore, ju keni thënë që nuk ishit i sigurt
6 se si keni mësuar, marrë vesh, për emërimin e z. Çeku.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kjo gjendet në provën 1D391,
8 paragrafi 10(e).

9 PY. A ju kujtohet të keni parë ndonjëherë dekretin për
10 emërimin e Agim Çekut?

11 PË. Më lejoni ta bëj një koment të përgjithshëm. Nuk jam i
12 sigurt që pajtohem me arsyet apo bazën për këtë mënyrë të
13 paraqitjes së pyetjeve.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull. A mund ta ribëni
16 pyetjen?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

18 PY. A e keni parë dekretin e emërimit të Agim Çekut?

19 PË. Nuk besoj.

20 PY. Pra, nuk e dini se kush e ka nxjerrë atë dekret?

21 PË. Nuk besoj ta kem ditur.

22 PY. A keni dëgjuar, apo dini, nëse Agim Çeku ka deklaruar
23 ndonjëherë se qeveria, se vendimet e Qeverisë së Përkohshme
24 duhej të trajtoheshin si urdhra?

25 PË. Nuk jam në dijeni të një deklarate të tillë. Por përsëri,

1 po e them që -- por nuk jam rehat, ndihem jo mirë me mënyrën
2 se si, bazën mbi të cilën po ndërtohen pyetjet që po më bëhen.
3 Prokurori duket sikur po përpiqet të vërtetojë si fakt gjëra
4 që në një mënyrë mbështesin gjykimet, vlerësimet që unë kam
5 shprehur në nj41
6 ë deklaratë në libër. Mendoj që ky është keqkuptim i rolit të
7 diplomatit dhe se si ne arrijmë në vlerësime që japim, pra si
8 diplomat. Ndoshta mund të diskutojmë këtë në një ambient
9 tjetër, apo në rrethana të tjera.

10 PY. Po të kisha mundësi do ta bëja tani, por ju bëj thjesht
11 pyetje dhe pres përgjigje të vërteta nga ju për pyetjet e mia,
12 dhe sa i përket supozimeve mbi të cilat bazohen këto pyetje,
13 mos u shqetësoni për këtë. Unë thjesht po ju bëj pyetje.

14 PË. E ruaj shumë besueshmërinë time, pra besueshmëria është
15 shumë e rëndësishme për mua.

16 PY. Saktë. Në të njëjtën pjesë të deklaratës suaj, që keni
17 diskutuar në paragrafin 61, marrëveshjen e shtatorit 1999. Dhe
18 kjo është paragrafi 6 -- më falni, është paragrafi 61. Dhe ju
19 keni deklaruar se nga mesi i shtatorit, Jackson dhe Çeku
20 arritën që të sillnin komandantët rajonalë në prag të
21 nënshkrimit, të marrëveshjes, pra, dhe Clark shkoi me avion
22 atje për të ndihmuar për t'i bindur ata. Dhe kjo është
23 diskutuar me juve dje në faqen 21 dhe 22 të transkriptit.

24 A është e saktë se KFOR-i i ka bërë, i ka mbajtur këto
25 bisedime?

1 PË. Po.

2 PY. Dhe konkretisht ka qenë Gjenerali Jackson?

3 PË. Gjenerali Jackson ka qenë kryesuesi, po.

4 PY. A e dini nëse Hashim Thaçi ka patur ndonjë rol në këto
5 bisedime?

6 PË. Siç e kam thënë dje, më duket, në seancën ku kam marrë
7 pjesë, nuk e kam parë Hashim Thaçin. Mua më është thënë se ai
8 në një rast apo në raste të tjera, kishte kërkuar takim tjetër
9 të ndarë pra, me Gjeneralin Jackson, drejtpërdrejt. Por jo në
10 këtë lloj ambienti, pra kur ishin seanca plenare. Por nuk jam
11 në dijeni të hollësive të këtyre takimeve, dhe natyrisht aq më
12 pak dhe të përmbajtjes së tyre.

13 PY. Në rregull. Do të përqendrohem tani në ditët e fundit
14 përpara -- të shtatorit, pra -- përpara nënshkrimit të
15 marrëveshjes, pra po flasim për datën 18, 19 shtator këto dy
16 ditë.

17 A ju kujtohet që në një moment të caktuar, ditën e fundit
18 gjatë bisedimeve, bisedimet ngecën?

19 PË. Po. Ne ishim të njoftuar se Gjenerali Jackson dhe ekipi i
20 tij kuptuan, ndjenë që komandantët e zonave nuk ishin gati të
21 angazhoheshin. Nuk donin të angazhoheshin.

22 PY. Dhe me sa kuptoj, ju nuk keni qenë aty me Gjeneralin
23 Jackson gjatë atyre orëve?

24 PË. Jo, por ju rikujtoj se ne kemi qenë të përfshirë vetëm
25 për, le të themi, për qëllime të informimit, sepse në fund të

1 fundit, rezultati përfundimtar i gjithë kësaj do të ishte, i
2 gjithë kësaj pune, do të ishte të krijohej një entitet që do
3 të ishte nën autoritetin e UNMIK-ut. Por, për të arritur deri
4 në këtë pikë, kjo punë bëhej tërësisht nga KFOR-i.

5 PY. Në rregull. Dua të shohim tani mënyrën, atë që i kujtohet
6 Gjeneralit Jackson lidhur me këto ngjarje që sapo përmendëm.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoj për këtë të shfaqet në
8 ekran dokumenti me ERN SPOE00212586 deri në 00212692. Këto
9 janë pjesë të nxjerra nga një libër i shkruar nga Gjenerali
10 Jackson. Kalojmë në faqen PDF 93, që është SPOE00212678.

11 Përqendrohuni, ju lutem, në paragrafin e fundit, aty ku fillon
12 "Kur erdhi ora njëmbëdhjetë ..."

13 PY. Do të lexoj disa pjesë. Dhe do bëja dhe disa përmbledhje
14 sepse është një pjesë e madhe. Këtu lexon:

15 "Kur erdhi ora njëmbëdhjetë, bisedimet u bënë shumë të
16 tendosura. Deri tani kishim shkëmbyer ide, por tani kishte
17 ardhur koha për të marrë një vendim. Çeku po kalonte një
18 moment shumë të vështirë. Në mendje të tij kishte 'Duhet të
19 luaj me këtë lojë, pra, për të ardhmen afatgjatë të Kosovës,
20 duhet ta bëj këtë', por zemra e tij shkonte, ndjenjat në një
21 drejtim tjetër. Dhe unë i thoja atij, 'Mos i lër emocionet që
22 të kaplojnë', 'Duhet të respektojmë rezolutën 1244', 'Bota po
23 na sheh, po presin', duke përsëritur këto pika, pra, në mënyrë
24 të vazhdueshme."

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër. Këtu --

1 pak më poshtë. Po, aty ku fillon me "Të nesërmen ..."

2 PY. Këtu shton ai, duke thënë --

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të shkojmë pak më lart. Po, këtu.

4 Në fillim të faqes së parë këtu,

5 PY. Këtu përmend se në ditën 89:

6 "... Thaçi u bë i keq. 'Askush nuk luan me UÇK-në, nuk
7 bën lojëra me UÇK-në', më bërtiti ai. 'Në goftë se mendoni që
8 mund të na jepni urdhra neve, atëherë e keni gabim, dhe do të
9 pendoheni për këtë.'"

10 Pastaj një paragraf më poshtë, "Të nesërmen, 19 shtator,
11 e diel ...", ai tha:

12 "Shtypi po spekulonte se diskutimet ishin prishur".

13 Në mbrëmje, "Thaçi dërgoi një mesazh që unë duhet të
14 shkoja në qytet dhe të takohesha me të. Reagimi ishte 'Hiqe
15 qafe atë, nuk na intereson fare', kjo ishte reagimi i
16 tërësishëm i të gjithëve tek Uzina."

17 Pastaj në fund Thaçi u mor vesh që ishte në Grand Hotel
18 dhe po hante aty. Pastaj u përpoq të bënte të njëjtën lojë.
19 Mori të njëjtën përgjigje. Pastaj Jackson shkruan, me kalimin
20 e natës u bë e qartë ata nuk ishin fare afër që të arrinin
21 marrëveshjen. Dhe në orën 6.00, ai doli dhe dha një konferencë
22 për shtyp duke kujtuar, duke i kujtuar UÇK-së se marrëveshja
23 kishte skaduar dhe se zyrtarisht nuk ekzistonte më si
24 organizatë.

25 Pra, sipas Gjeneralit Jackson, i cili ka qenë kryesuesi i

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 47

1 bisedimeve, ka qenë Hashim Thaçi, personi që ka bërë, që ka
2 ngecur bisedimet, që ka bllokuar bisedimet. Është kështu?

3 PË. Kërkoj ndjesë, sipas Gjeneralit Jackson -- a mund ta
4 thoni përsëri, ta përsërisni?

5 PY. Pra, sipas Gjeneralit Jackson, në pjesën që sapo lexova
6 ai përshkruan se prishja e bisedimeve, përshkruan prishjen e
7 bisedimeve, dhe përmend që ka qenë Thaçi ai që bëri që
8 bisedimet të ngecin. A pajtoheni me këtë?

9 PË. Unë nuk e kam lexuar librin e Gjeneralit Jackson, kjo
10 është e re për mua. Ky paragraf, kjo pjesë është e re. Për mua
11 ka qenë e qartë, kishte shumë forca që merrnin pjesë në këtë
12 dhe një prej këtyre ishte z. Thaçi, qartësisht.

13 PY. Faleminderit.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Paraqes këto dy faqe për pranim
15 në prova, janë SPOE00212678 -- tre faqe në fakt, deri në
16 00212680. Mund ta shoh ERN-në? Në fund të kësaj, pra. Kërkoj
17 ndjesë, në fakt është faqja e dytë, 79.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, vetëm 78
19 dhe 79?

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00212678
24 deri në 212680, pranohen.

25 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të marrin numrin e

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 48

1 provës materiale P04501, klasifikimi është konfidencial.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

3 PY. Dje, ju biseduat, folët për gjendjen e sigurisë kur keni
4 arritur ju, dhe thatë se nuk ju kishin informuar për përplasje
5 apo fërkime. Dhe kjo gjendet në faqen 34 të transkriptit
6 paraprak.

7 PË. Nuk kishte armiqësi.

8 PY. Jo.

9 PË. Nuk na i kishin informuar për veprime luftarake.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kërkoj të kalojmë, të
12 shfaqim në ekran, P02533, dhe ta shohim këtë. Të kalojmë në
13 faqen e dytë.

14 PY. Nuk do t'jua përshkruaj për arsye të konfidencialitetit,
15 por, ju lutem, shikojeni dhe që të kuptoni se çfarë është.
16 Mund të vërejmë se data është 12 gusht 1999.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tek pika 3, pak më
18 poshtë.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e kuptoj kush e ka bërë këtë
20 dokument, i kujt është, nga e ka origjinën.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kam nevojë të kaloj në seancë
22 private për të dhënë këtë informacion.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
24 seancë private.

25 [Seancë private]

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 49

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 50

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4 [Seancë e hapur]

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

7 PY. Tani, do t'ju tregoj edhe një dokument dhe pastaj do të
8 bëjmë pushimin.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoj të shfaqim në ekran
10 dokumentin P04128. Ky dokument është një raport i OSBE-së për
11 periudhën 14-18 [Sipas përkthimit] shtator 1999. Kalojmë në
12 faqen vijuese.

13 PY. Në qoftë se përqendrohemi, ju lutem, tek "Kufizimi i
14 lirisë së lëvizjes", paragrafi i parë thuhet, në këtë paragraf
15 raportohen bllokimi në Rahovec, raporton se si persona të
16 UÇK-së me uniformë apo me rroba civile janë vërejtur, vëzhguar
17 duke bërë në pika, duke vepruar në pika kontrolli. A ju
18 freskon kujtesën kjo lidhur me ngjarjet në atë kohë?

19 PË. A mund të më thoni, tregoni, saktë paragrafin që po
20 lexoni?

21 PY. Pra, në qoftë se shikoni paragrafin me titullin "Kufizimi
22 i lirisë së lëvizjes", dhe paragrafi i parë thotë:

23 "Ekipet e të drejtave të njeriut në Prizren raportuan për
24 një bllokadë, që bllokada në Rahovec vazhdon."

25 Pastaj thotë:

1 "UÇK, personat e UÇK-së, me uniformë dhe me rroba civile
2 janë parë duke, që kontrollonin pikat e kontrollit,
3 postblloqet."

4 PË. Dhe pyetja juaq është, a e njoh këtë raport konkret?

5 PY. Pyetja ishte, a ju freskon kujtesën për ngjarjen, a e
6 freskon kujtesën për disa prej ngjarjeve pra, në atë kohë.

7 PË. Pra, që kanë ndodhur ngjarje të tilla.

8 PY. Po, që UÇK-ja kontrollonte postblloqe në dhe jashtë
9 Rahovecit.

10 PË. Jam në dijeni që janë bërë raporte, pretendime janë
11 ngritur, janë ngritur pretendime për aktivitet të këtij lloji.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, shoh që jemi
14 afër orës 11.00 dhe pushimit që do bëjmë. Kam një temë tjetër
15 që është më e gjatë, që dua ta trajtoj tani. Mund të filloj
16 ose tani, ose në qoftë se ju e vlerësoni të përshtatshme,
17 bëjmë pushimin.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni,
19 keni akoma dhjetë minuta.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

21 PY. Tani, dua të flasim për krimet që ju keni vërejtur,
22 vëzhguar gjatë kohës që keni qenë në Kosovë, dhe ju përmendët
23 këtë, keni përmendur këtë në pjesë të ndryshme të deklaratës
24 tuaj, ku ju deklaroni se krimet ishin rezultat i mungesës së
25 ligjit, pranisë së ligjit, sundimit të ligjit, dhe hakmarrjes.

1 E keni lexuar aktakuzën në këtë çështje?

2 PË. Nuk e kam lexuar.

3 PY. Pra, ju nuk e dini për -- cilat krime janë pjesë e
4 akuzave këtu, në këtë çështje gjyqësore?

5 PË. E saktë, por besoj që jam këtu për të folur për
6 përgjegjësinë për ato krime.

7 PY. Saktë. Kështu është. Desha t'ju -- të di nëse njohuritë,
8 cila, çfarë njohurish kishit ju, çfarë njohurish keni, pra, në
9 këtë kohë. Pra, tani dua që të përqendrohemi te krimet kundër
10 bashkëpunëtorëve, apo kolaboratorëve. Dhe gjatë seancës
11 përgatitore me Mbrojtjen, juve ju është treguar një pjesë e
12 librit tuaj lidhur me këtë, dhe ju është dhënë mundësia që të
13 bëni komente.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për këtë do të kërkoj të shfaqim
15 në ekran dokumentin me ERN SPOE00397775, ta rishfaqim pra, në
16 ekran. Kalojmë në faqen PDF 36, që është SPOE00397810. Kërkoj
17 ndjesë, e kuptoj tani që kjo faqe është pranuar në prova.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në fakt, është e
19 vërtetë. Është pranuar me numrin e provës materiale P04496.2.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të përqendrohemi tek paragrafi i
21 parë, nën titullin "Konteksti politik". Pra këto dy paragrafë.

22 PY. Këtu fillojmë paragrafin e dytë. Ju keni shkruar:

23 "Kur trupat e NATO-s filluan të arrinin në fillim të
24 qershorit 1999, rreth njëqind civilë vriteshin çdo javë,
25 kryesisht serbë. UÇK-ja gjuante serbët që ishin të përfshirë

1 në luftë, por gjithashtu dhe kolaboratorët në mesin e
2 komuniteteve etnike të tjera, veçanërisht romët dhe turqit,
3 por edhe shqiptarë etnikë që konsideroheshin si thjesht tepër
4 bashkëpunues me ish-pushtuesin dhe shtypësin serb.
5 Ekstremistët e UÇK-së ishin të vendosur që të gjuanin dhe të
6 kërkonin dhe të dërgonin jashtë Kosovës, pra, të dëbonin
7 serbët, duke përdorur dhunën dhe terrorin kur ishte e
8 nevojshme.”

9 Dhe, gjatë seancës përgatitore, ju është treguar
10 pikërisht ky, kjo pjesë dhe ju deklaruat se fjalia e parë
11 duhet të lexohet në kontekstin e fjalisë në vijim që i
12 referohet ekstremistëve të UÇK-së, e saktë?

13 PË. E saktë.

14 PY. Faleminderit. Por, ju e dini se në atë kohë krimet, disa
15 prej krimeve, në 1998-n dhe 1999-n, duket të jenë rezultat i
16 përpjekjeve të organizuara nga UÇK-ja, a është kështu?

17 PË. Kjo ishte përshtypja pothuajse e përgjithshme e të
18 gjithëve.

19 PY. Faleminderit. A ju kujtohet që keni lexuar raporte lidhur
20 me këtë në atë kohë?

21 PË. Ne besoj i kemi parë gjëra të tilla të përmendura në
22 dokumente, në raporte të ndryshme, raporte të ndryshme, pra,
23 apo pretendime për aktivitete të tilla si këto, po.

24 PY. Tani do t'ju tregoj një shembull, dhe mund të më thoni në
25 qoftë se jeni në gjendje të jepni komente mbi të, apo jo.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për këtë do kërkoj të shfaqim në
2 ekran SPOE00397688 deri në 00397704.

3 PY. Ky është "Raport i Departamentit të Shtetit për Serbinë
4 dhe Malin e Zi lidhur me praktikat e të drejtave të njeriut në
5 1998", dhe është i përgatitur në janar [Sipas përkthimit]
6 1999.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kërkoj të kalojmë në
8 faqen 2 në PDF, që është 397689, paragrafi i tretë.

9 PY. Këtu thuhet, elementë të UÇK-së:

10 "... kanë kryer vrasje, kanë qenë përgjegjës për
11 zhdukjet, kanë rrëmbyer dhe mbajtur në ndalim policë serbë, si
12 dhe civilë serbë dhe shqiptarë (ata që dyshoheshin se ishin
13 besnikë ndaj qeverisë së Serbisë) dhe në disa raste të
14 izoluara, ata kanë 'gjykuar' të dyshuarit pa proces ligjor të
15 duhur. Ka gjithashtu raporte të besueshme për raste torturash
16 nga UÇK-ja".

17 A janë këto lloj raportimesh për të cilat ju keni patur
18 dijeni?

19 PË. Unë do të thoja që këtë dokument konkret nuk e kam parë
20 kurrë. Praktikë e përshkruara në këtë paragraf ishin dhe po e
21 vë në thonjëza, "diçka që e dinin të gjithë". Por nuk kam qenë
22 i përfshirë në procesin e dokumentimit të rasteve konkrete,
23 individuale.

24 PY. Natyrisht.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja

1 të tregoja dhe dy pjesë nga këtu, dhe pastaj do bëjmë
2 pushimin, pra në qoftë se mund të kalojmë te faqja 5 PDF,
3 faqja që përfundon me 397692, paragrafi i parafundit.
4 PY. Pjesa e dytë e këtij paragrafi, në këtë pjesë përmendet
5 se:

6 "Në tetor UÇK-ja ndaloi 13 politikanë shqiptarë,
7 përfshirë anëtarë të parlamentit në hije shqiptar, në Qirez,
8 për dy ditë". Pra, gjatë dy ditëve.

9 Pastaj raportohet se si ata i kanë, raportohet t'i kenë
10 torturuar këta të ndaluar.

11 A është ky lloj raportimi për të cilin ju kishit dijeni?

12 PË. Siç e thashë, ky lloj raportimi ishte i përhapur. Por e
13 përsëris, jam i shqetësuar nëse kjo ka ndonjë lidhje me
14 përfundimet që unë kam shprehur në deklaratë.

15 PY. Nuk mendoj që është diçka për të cilën duhet të
16 shqetësoheni, vetëm jepni përgjigje të vërteta dhe të sakta.

17 PË. Siç e thashë, si diplomat, diplomati ka vetëm
18 integritetin dhe kredibilitetin për të ofruar, dhe më duket
19 sikur kjo kundërshtohet në një bazë të cilën nuk e kuptoj.

20 PY. Do t'ju tregoj edhe një pjesë tjetër, në qoftë se mund të
21 kalojmë në faqen 8 PDF. Paragrafi i fundit.

22 PY. Paragrafi i fundit, lexon se, përshkruan se si janë vrarë
23 kolaboracionistët, se si disa shqiptarë etnikë të punësuar nga
24 ndërmarrjet shtetërore janë kërcënuar. Pra, është edhe kjo
25 diçka që ishte e njohur për të gjithë?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 56

1 PË. Përsëri, po e them nuk mund të them që jam, kam njohuri
2 për këtë dokument në veçanti, por këto lloj gjërash ishin,
3 thuheshin, këto gjëra që janë përshkruar këtu ishin të
4 zakonshme, të ditura.

5 PY. Faleminderit.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do paraqes
7 këtë dokument për t'u pranuar si provë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
9 kundërshtim?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00397688
12 deri në 397704, faqet 397689, 397692, dhe faqja e fundit të
13 cilës iu referuat është faqja 8. Ju nuk dhatë numrin ERN.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj ndjesë, numri ERN është
15 SPOE00397695. Dhe tërësia e faqeve është, pra, 397688 deri në
16 397704.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
18 [Përkthim] Pranohet.

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar
20 Gjykatës. Në qoftë se mund të kërkoj një sqarim. Nëse do
21 paraqiten tre apo katër faqe. Pra, a paraqitet faqja e parë,
22 që përfundon me 688? Sepse kjo u tha që u tregu në fillim, dhe
23 pastaj u treguan të tjera.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Paraqes për pranimin e provave
25 dokumentin në tërësi.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti në
2 tërësi, siç është shënuar me numër ERN.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Atëherë,
4 SPOE00397688 deri në 00397704 do të marrë numrin e provës
5 materiale P04502, dhe është i klasifikuar konfidencial.
6 Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Covey, do
8 bëjmë një pushim gjysmë-orësh tani.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem, mos
11 bisedoni me askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë tuaj,
12 siç jua kam përmendur dhe më herët.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Natyrisht.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Shihemi rreth
15 orës 11.35.

16 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
20 ndërpritet deri në 11.35.

21 --- Pauza fillon në orën 11.05

22 --- Seanca rifillon në orën 11.35

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare,
24 mund të sillni dëshmitarin në sallë.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 58

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Covey, do
2 të vazhdojmë me pyetjet e ZPS-së.

3 Znj. Iodice, ju e keni fjalën.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. A mund të kalojmë
6 në seancë private për serinë e pyetjeve në vazhdim?

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
8 seancë private ju lutem, z. Sekretar i Gjykatës.

9 [Seancë private]

10 [Seancë private teksti i fshirë]

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 59

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 60

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 61

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18 [Seancë e hapur]

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,

20 kemi kaluar në seancë të hapur dhe një herë.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar, dua të bëj një

22 kundërshtim tjetër. Unë kundërshtova javën e shkuar faktin që

23 ZPS-ja po ju paraqiste argumente përpara këtij dëshmitar diçka

24 që i është kërkuar 30 herë palës Mbrojtëse. Dëshmitari ka

25 thënë disa herë që kjo gjë duhet t'i paraqitet atij me qëllim

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 62

1 mund të komentojë dhe Prokuroria duhet t'ia tregojë se përse
2 po i bën këto pyetje dëshmitarit.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bazuar mbi
4 këto çështje tregojini, Prokurore, ju duhet t'i tregon se
5 përse po i bëni këto pyetje, t'i tregoni dëshmitarit se përse
6 po i bën këto pyetje.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, e kuptoj.

8 Jemi në seancë të hapur.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, ju duhet
10 t'i tregoni dëshmitarit pse po i bëni këto pyetje.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

12 PY. Z. Covey, sa herë që filloj një tematikë të re, unë ju
13 paraqes këtë dhe në varësi të asaj që kemi thënë më parë. Dhe
14 arsyeja pse po e bëj këtë pyetje është se ju keni thënë që
15 keni pasur dijeni lidhur me raporte nga persona të cilët kanë
16 pretenduar -- nga persona të cilët pretendohej se ishin
17 pjesëtarë të UÇK-së. Dhe kjo është arsyeja që e kam bërë unë
18 këtë pyetje.

19 Unë shpresoj që kjo e sqaron këtë çështje.

20 PË. Jo, nuk e sqaron fare, për shkak se dëshmia ime dhe
21 kryesisht deklarata ime ka të bëjë me vlerësimet tona lidhur
22 me rolin që ka luajtur z. Thaçi, rol të hamendësuar apo real,
23 lidhur me këto incidente. Pra, deklarata ime tregon kryesisht
24 gjykimin tonë lidhur me autoritetin që ka pasur ai për
25 individë të cilët është provuar apo jo që kanë kryer këto

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 63

1 krime.

2 Sipas mendimit tim, asnjë prej këtyre aktiviteteve nuk
3 ndërlihet në mënyrë të drejtpërdrejtë me z. Thaçi, apo asnjë
4 prej tyre nuk, si të thuash, kundërshton mënyrën se përse ne
5 kemi arritur në gjykimin që kemi arritur. Pra, unë nuk mendoj
6 se ju e keni sqaruar këtë çështje duke përsëritur raporte
7 lidhur me këto incidente gjatë gjithë kohës.

8 PY. Siç e thashë, sa herë që do të kërkoj të komentosh lidhur
9 me një dokument, unë do ta ndërlihet atë me pjesë përkatëse të
10 deklaratës suaj apo të provave të cilat unë po përpigem që të
11 kërkoj koment. Kjo nuk ka të bëjë në përgjithësi me deklaratën
12 tuaj. Po ka të bëjë thjesht me disa pohime të veçanta në këtë
13 deklaratën tuaj me qëllim që t'ju rifreskoj memorien.

14 PË. Ju po i nxirrni çështjet jashtë kontekstit, gjithë
15 deklaratën time jashtë kontekstit.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, ju
17 keni të drejtë që të dëgjoni arsyetimin e pyetjeve që ajo bën,
18 nuk po ju kërkojmë që të jeni dakord apo të mos jeni dakord me
19 këtë çështje.

20 Ajo po bën pyetje dhe, në fakt, ju po i përgjigjeni në
21 mënyrën më të mirë. Prandaj duam që të vazhdojmë në këtë
22 mënyrë.

23 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
24 Besoj se do ta trajtojmë këtë më vonë.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani dua të kalojmë tek pjesa e

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 64

1 dëshmisë tënde ku keni diskutuar mandatin e UNMIK-ut dhe të
2 KFOR-it për të luftuar krimet. Në deklaratën tuaj në
3 paragrafin 36 thatë që KFOR-i nuk ka pasur as trajnim as
4 mandat për të ushtruar funksione policore dhe thatë në disa
5 vende ishte ndaluar në mënyrë -- shprehimisht një gjë e tillë
6 dhe përmendët Shtetet e Bashkuara.

7 Dje, i thatë Trupit Gjykues se përse KFOR-i, si e gjeti
8 KFOR-i një mënyrë për ta zgjidhur këtë çështje. A të kujtohet?
9 PË. Gjetëm një zgjidhje tepër të kufizuar.

10 PY. Dakord.

11 PË. Ne folëm në përgjithësi për mandatin dhe dua t'ju tregoj
12 disa pjesë të librit tuaj në të cilin ju keni shpjeguar me
13 fjalët tuaja se cili ka qenë ky mandat apo mënyrën se si e
14 keni zbatuar ju këtë mandat, si e keni shpjeguar me fjalët
15 tuaja.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të vendosim SPOE00397775
17 në ekran. Dhe në faqen 25 PDF që është 00397799. Të
18 përqendrohemi në fund të faqes 78 të librit, faqja e parë në
19 fund.

20 PY. Paragrafi i fundit ku thuhet, "Dy vite pas këtij
21 ndryshimi të politikës ..." Dhe po ju lexoj disa pjesë:

22 "Dy vite pas këtij ndryshimi të politikës me hyrjen në
23 Kosovë të komunitetit ndërkombëtar shumica e komandantëve
24 ushtarakë dhe zyrtarëve civilë e kanë kuptuar rolin e tyre
25 sipas Rezolutës së Këshillit të Sigurimit 1244, misioni do ta

1 ushtronte pushtetin në mënyrë të ekuilibruar me ata të cilët
2 bashkëpunonin ...”

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

6 PY. “... misioni do të tregohet i ekuilibruar me të gjithë
7 ata me të cilët bashkëpunonin në procesin e zbatimit të pages
8 dhe do të kundërshtonte në mënyrë aktive ata të cilët e
9 pengonin atë. Koncepti u shndërrua në një parim udhërrëfyes
10 për planifikimin dhe për realizimin e detyrave ditore.
11 Zyrtarët e UNMIK-ut dhe komandantët kishin nevojë thjesht të
12 pyesnin, kjo gjendje e çon përpara apo e pengon procesin e
13 pages? Në qoftë se ishte e fundit atëherë dhe qëndrimi ishte i
14 pranuar, ishte qëndrimi që duhej marrë, duheshin marrë
15 veprime.”

16 Këto janë fjalët tua apo jo?

17 PË. Po.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dy paragrafë më poshtë ku thuhet,
19 “Ishte me fat se ...”

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Është paragrafi që është menjëherë
21 pas atij që sapo lexuat.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

23 PY. Thuhet këtu dhe këtu po flisnim për gjeneralin, qasjen e
24 Gjeneral Jackson dhe thoni që pothuajse të gjithë ushtarakët
25 britanikë të nivelit të kapitenit a më lartë kishin shërbyer

1 në Irlandën e Veriut dhe e kuptonin udhëzuesin, e kuptonin që
2 përpara udhëzuesit dhe NATO-s nevoja ishte që 'të mbështesim
3 ata që mbështesin procesin e pages.'"

4 Në paragrafin që fillon "Në Kosovë ..." ku thuhet:

5 "Në Kosovë, si për kontrast, Këshilli i Sigurimit i
6 kërkoi PSSP-së që të kishte autoritet ekzekutiv sipas
7 Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Mandati
8 krijoi, i dha misionit legjitimitetin e përgjithshëm dhe i
9 krijoi autoritet për të realizuar përgjegjësinë e tij dhe për
10 ta transformuar konfliktin e Kosovës. Dhe Rezoluta 1244 ishte
11 pikërisht gardiani kryesor që i bënte të mundur që aktivitetet
12 politike dhe policore të ishin të atilla që të krijoheshin
13 rrethanat për ata të cilët e pengonin procesin e pages me
14 qëllim që të realizohej paqja.

15 "E dyta, ky rol gardiani kishte nevojë për një strategji
16 të fuqishme politike si tregohet në Kapitullin V dhe kërkonte
17 angazhimin aktiv të të gjitha palëve në konflikt. Kjo kishte
18 të bënte me inkurajimin e atyre që t'i shikonin, t'i
19 rishikonin interesat e tyre me qëllim që të çohesh më tej
20 procesi i pages. Udhëheqësit e fraksioneve me influencë të
21 cilët ishin në gjendje që të merrnin rreziqe për ta mbështetur
22 procesin e pages do t'i duhej të mbrohej. Gardianët e këtij
23 procesi duhej ta bënë që kjo të ishte pjesë e sjelljes së
24 tyre që në fillim dhe t'i kërkonin udhëheqësve të këtyre
25 fraksioneve që t'i realizonin këto pritshmëri nga ana e tyre.

1 Askush --

2 "Dhe, në fund, çdo proces paqeje kërkon mbështetjen
3 politike. Në Kosovë ne mësuam që ta ushtronim këtë veprimtari
4 përmes udhëheqësve të fraksioneve duke i inkurajuar që ata të
5 mbështesin misionin në mënyrë të hapur dhe të mos merreshin me
6 aktivitete penguese, të cilat kishin si synim që të pengonin
7 procesin e paqes."

8 Ky ishte mendimi i juaj në vitin 2005, apo jo?

9 PË. Po.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë në faqen 29 që ka
11 numrin e provës ERN SPOE00397803, të përqendrohemi në faqen 87
12 të këtij libri. Në faqen tjetër, ju lutem, ku thuhet, "Në
13 Kosovë ..."

14 PY. Në atë paragraf, pjesa e dytë e këtij paragrafi në të
15 cilën ju thoni se si është zbatuar në terren, ju thatë:

16 "Njësitë e KFOR-it, kryesisht britanike, kanë shfrytëzuar
17 një numër të patrullave të lëvizshme, pikat e kontrollit,
18 kontrollin e turmave dhe reagimin e shpejtë për të blerë kohë
19 me qëllim që të fillonte procesi politik i Kombeve të
20 Bashkuara dhe të dislokohej forca policore. Policia e UNMIK-ut
21 dhe planifikuesit e kanë planifikuar sekuencën e dislokimit e
22 cila do të bënte të mundur lidhjen midis aktiviteteve
23 ushtarake dhe policore dhe transferimin e përgjegjësive për
24 policinë me t'u rritur kapacitetet e BE-së. KFOR-i e ka
25 ndryshuar këtë proces të mbështetjes për të mbështetur atë të

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 68

1 policisë. Dhe kjo ishte -- edhe këto ishin aktivitetet të
2 cilat krijuan kushtet për operacione të përbashkëta ndërkohë
3 që vazhdonte zbatimi i tij."

4 Pra, këto janë fjalët tua që lidhur me zbatimin në terren
5 apo jo?

6 PË. Po.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dua të nderuar Gjykatës, që këto
8 dy faqe të pranohen si prova materiale.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
10 kundërshtim?

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Për të treguar se cili është
12 arsyetimi, nuk di me cilën pjesë të deklaratës ndërlidhen
13 këto.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] E kam bërë të qartë që në fillim
15 të pyetjeve, i nderuar Gjykatës.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] A mund t'i kërkojmë dëshmitarit që
17 të japë mundësinë që të diskutojë një gjë të tillë?

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do ta bëj këtë në fund të këtyre
19 pyetjeve.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Unë do të preferoja që ta bënte,
21 të merrej vendimi lidhur me këtë përpara se të pranohej apo
22 jo, me qëllim që ne duhet ta rezervojmë këtë qëndrimin tonë në
23 varësi të këtyre pyetjeve.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, dakord.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

1 PY. A keni patur dijeni që kontingjentet e KFOR-it kanë
2 parashtuar dhe procedurat për të zbatuar funksione policore?

3 PË. KFOR-i nuk ka patur funksione policore. Ishin të ndaluar
4 ta bënin këtë. Dhe si nga doktrina e NATO-s edhe si pjesë e
5 legjislacionit të shteteve përkatëse.

6 PY. Qëndrimi im është që KFOR-i ka bërë të njëjtën gjë, ka
7 bërë pikërisht këtë gjë dhe duhet t'i tregoj dokumentin që
8 provon një gjë të tillë.

9 PË. Do të duhet të thoja këtë që KFOR-i lejoi që të siguronte
10 një zonë të caktuar për mbrojtjen e personelit ndërkombëtar me
11 qëllim të ruhej rendi publik. Ndërkohë që mandatet që
12 ushtrojnë forcat policore si, për shembull, arrestimi, hetimi
13 dhe veprime të tjera të ruajtjes së rendit dhe ligjit ishin të
14 ndaluara shprehimisht. Ata kanë patur atë fuqinë, si të
15 thuash, e ndalimit që është një funksion i ruajtjes së ligjit.

16 PY. Të shohim se çfarë keni për të thënë, ne e kemi parë
17 mandatin deri -- dhe ishit dakord kur thatë që në paragrafin 9
18 që ekzistonte mundësia e KFOR-it që ruante, t'i luante këto
19 mandate derisa të arrihej momenti --

20 PË. Ju kërkoj ndjesë. Duhet të jemi më të qartë atëherë, për
21 shkak se ka një ndryshim shumë të madh dhe ne jemi kujtuar
22 dita-ditës që KFOR-i nuk mund të funksiononte si forcë
23 policore. Ata kanë pasur mundësinë që në momentin e kërcënimit
24 të mund të ndalohej dikush. Po pastaj dilte problemi se çfarë
25 do të ndodhte me personat e ndaluar dhe kjo çështje nuk u

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 70

1 zgjidh asnjëherë.

2 Jua kam thënë edhe më parë, që KFOR-i, në qoftë se kam
3 thënë që KFOR-i po luante funksione policore, kjo ka qenë
4 gabim.

5 PY. Po përpiqem të sqaroj disa pjesë të deklaratës suaj, të
6 shohim një shembull të asaj që ata kanë bërë.

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Kur thuhet që libri kontradikton
8 atë që ka thënë, meqë ai është autori i librit, është mirë që
9 t'ia tregojmë atë pjesë të librit dëshmitarit në mënyrë që ta
10 sqarojë ai.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase ke të
12 drejtë, por ta lejojmë Prokuroren të vazhdojë me pyetjet.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, sepse po hiqet ky dokument dhe
14 do të nxjerri një dokument tjetër. Mbase unë e kam gabim, dhe
15 ju kërkoj ndjesë, por e mira është që ta sqarojmë. Dhe po e
16 hiqni librin prandaj u çova në këmbë tani sepse dua të
17 trajtohet për librin. Nëse do ta nxirrni librin më vonë sërish
18 atëherë nuk ka asnjë problem.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
20 përdorni sërish librin?

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, jo.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra,
23 përfunduat me librin sa i takon këtij personi?

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, jo. Për këtë faqe kam
25 përfunduar me këtë faqe po do i kthehem sërish librit.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 71

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
2 Vazhdoni me pyetjet tuaja.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vendosim, ju lutem, në ekran --

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kërkove për
5 pranim këto dy faqe?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, i kërkova më herët po s'keni
7 marrë vendim.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E
9 kundërshtoni?

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Po pra, i kundërshtojmë. Nuk e
11 kuptojmë çfarë lidhje kanë këto faqe me atë që tha dëshmitari.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po tha që do
13 t'i bënte disa pyetje librit. Këto janë kundërpynetjet.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Mbase unë s'po e kuptoj procedurën
15 tani. Mesa kuptova unë, Prokurorja do të shohë një faqe
16 tjetër, por nëse Prokurorja do ta ballafaqojë dëshmitarin
17 sërish me atë që ka dhe ti thotë që kjo që thua ti,
18 kontradikohet nga libri, atëherë unë s'kam kundërshtime. Por
19 më duket sikur nuk do ta përdori më këtë faqe.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Më duket se kam qenë shumë e
21 qartë në pyetjet e mia, lidhet me aftësitë e UNMIK-ut dhe
22 mandatin e KFOR-it. I tregova pjesën përkatëse.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë për
24 çfarë po e kërkoni të pranohet kjo?

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Sepse ai këtu shpjegon se,

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 72

1 domethënë, kjo lidhet me atë çka ka thënë dëshmitari në
2 deklaratën e tij ku ka thënë se KFOR-it i ndalohej të
3 ushtronte detyrat policore. Besoj se kjo pjesë u sqarua me
4 dëshmitarin kur i thamë çfarë ke dashur të thuash, kur ai tha
5 që jo nuk kam thënë që s'kam pasur fare funksione policore. Ne
6 kemi atë që ka thënë ai në deklaratë. Unë nuk do t'i tregoj
7 dokumente të tjera lidhur me këtë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
9 Dy dokumentet do t'i pranojmë. Dokumenti me numër SPOE0039775
10 deri 397799, 397803. Këto janë dokumentet që keni përmendur.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Më lejoni, ju lutem,
13 t'ju jap numrin përkatës. Dy faqet e librit do të marrin
14 numrin e provës P04496.3. Sikurse dhe me faqet e tjera që kanë
15 qenë publike, a do të jenë dhe këto publike?

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
18 Riklasifikojeni.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

20 PY. Tani duhet t'ju tregoj një dokument për të parë a
21 përputhet me mënyrën si i keni kuptuar ju detyrat e KFOR-it.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të vendosim në ekran
23 materialin SITF00228388 deri në SITF00228391-ET dhe
24 gjermanishtja është me numër SITF00228077 deri në 00228466. Në
25 gjermanisht, që është dhe origjinalja, të shkojmë në PDF tek

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 73

1 faqja me numër 142 që ka numrin SITF00228388.

2 PY. Z. Covey, ju lutem shikojeni këtë raport. Është direktivë
3 operative nga KFOR-i gjerman. Data është 22 qershor 1999, pra,
4 përpara se të mbërrinit ju. Këtu thuhet --

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem shkojmë pak më poshtë në
6 tekst. Paragrafi poshtë pikës "Detyrat".

7 PY. Ku thuhet: "Kontingjenti i KFOR-it gjerman ..."

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem zvogëloheni pak që ta
9 shikojmë tekstin të plotë.

10 PY. Pra, thuhet:

11 "Kontingjenti i KFOR-it gjerman ka për detyrë, ndër të
12 tjera, që të ndalojë kriminelët e t'i mbajë në ndalim, me
13 përjashtim të anëtarëve të kontingjenteve ndërkombëtare, pra,
14 për të siguruar rendin publik, pra, në kuadër të rendit publik
15 për të parandaluar krimet e mëtutjeshme dhe nëse është e
16 nevojshme të ndihmojë ndjekjen penale të kryesve të këtyre
17 veprave."

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në fagen tjetër.

19 PY. "Për arrestimin e personave" thuhet:

20 "Trupat e KFOR-it gjerman do të arrestojnë persona që
21 dyshohet se kanë kryer vepra të rënda penale, një krim apo një
22 vepër penale të një natyre të rëndë dhe të cilët janë kapur në
23 flagrancë ose ishin duke e kryer këtë vepër penale. Ata mund
24 të ndalohen pa urdhër gjykate derisa të caktohet një gjykatë
25 nga prania e sigurisë civile."

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 74

1 Këtu rendi edhe vepra penale për të cilat bëhet fjalë ku
2 është rrëmbimi, vrasja edhe të tjera.

3 Pra, ka qenë pjesë e detyrave të KFOR-it asokohe apo jo?

4 PË. Unë kam disa komente.

5 PY. Fillimisht përgjigjuni kësaj pyetjeje?

6 PË. Po duhet ta shtjelloj pak.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni
8 pyetjes, pastaj mund ta shtjelloni më tej.

9 DËSHMITARI: [Përkthim] Bëjeni dhe një herë pyetjen, ju
10 lutem?

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

12 PY. A ju kujtohet që kjo ka qenë pjesë e detyrave të KFOR-it?

13 PË. Nuk mendoj se është përshkrim i saktë kjo që pamë.

14 Dhe prandaj ju thashë që kam disa arsye. Së pari, ka
15 kaluar shumë kohë, dhe në fakt, dhe gjermanishten nuk e njoh
16 mirë, po nuk mendoj se përkthimi është i saktë. Këtu është
17 "*festnehmen*", domethënë, nuk do të thotë "arrestim". Po do të
18 thotë "ndalim", të ndalosh një person. Ky është një dokument i
19 përgatitur nga kontingjenti gjerman, as nga selia, as nga
20 komanda qendrore e Jackson, nga selia e NATO-s. Dhe secili
21 prej kontingjenteve ushtronte, kishte disa autonomi, disa
22 kishin më shumë se të tjerët. Francezët njiheshin, ishin me
23 famë që ishin shumë autonomë në llojin e tyre edhe amerikanët
24 po ashtu autonomë. Gjermanët nuk e kundërshtonin autoritetin
25 qendror, por askush nuk i shikonte çfarë bënin nga qendra

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 75

1 dokumentet e tyre.

2 Prandaj më duket sikur është tepruar pak këtu në
3 përshkrimet që janë bërë kur flitet për detyrimet e forcave
4 ushtarake sa u takon veprimtarive kriminale.
5 PY. Faleminderit për sqarimin.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të kërkoja që të pranohet ky
7 dokument si provë.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
9 kundërshtime?

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Vetëm këtë faqe, këto faqe do të
11 doja që të pranoheshin. Vetëm këto faqe në anglisht doja që të
12 pranoheshin që kanë numrin 228388 deri në 228391, sepse
13 versioni në gjermanisht është më i gjatë.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
15 kundërshtime?

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
18 Materiali SITF00228388 deri në 00228391 pranohet dhe në
19 anglisht dhe në gjermanisht.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti do të marrë
21 numrin provës P04503 dhe klasifikimi është konfidencial.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë publik.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
24 Riklasifikojeni si dokument publik.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Gjermanishtja është me numrin --

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 76

1 më falni, nuk e kam tani, do jua jap numrin e gjermanishtes më
2 vonë.

3 PY. Tani, dua të shohim disa shembuj konkretë të asaj që ka
4 bërë KFOR-i.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Që ta kuptoj unë, znj.
6 Iodice, këtë dëshmi, këto pyetje kanë për synim të vërtetojnë
7 se KFOR-i, në fakt, ka ndaluar persona në praktikë për vepra
8 të rënda penale?

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo, është më e gjerë. Është për
10 të kuptuar mënyrën se si e kanë ushtruar mandatin e tyre. Do
11 flas dhe për pjesën civile pak më vonë.

12 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju po vini në
13 pikëpyetje besueshmërinë e dëshmitarit apo nxirrni dëshmi për
14 të mbështetur argumentet tuaja?

15 PË. Po përpiqem të kuptoj çfarë ka thënë dëshmitari në
16 deklaratën e vet.

17 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Se më duket mua që ju po
18 përpiqeni të përcaktoni që KFOR-i ka pasur mundësinë të
19 ndalonte persona për vepra të rënda penale.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk e kam, nuk jam fokusuar tek
21 mandati i KFOR-it, jam fokusuar në mënyrën se si është
22 zbatuar.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju lutem, më falni, që
24 ndërhyra po a mund të riklasifikojmë dhe versionin në
25 gjermanisht si dokument publik?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 77

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po. Mund të riklasifikohet si
2 publik.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thjesht sa
4 për informacion gjermanishtja publike është.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po, mund të jetë publik. Nuk
6 është problem dhe versioni në gjermanisht. Megjithatë, do ta
7 verifikoj dhe një herë.

8 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
9 këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
11 [Përkthim] Vazhdoni.

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Për pyetjet e radhës do të doja
13 të kalonim në seancë private.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të kalojmë në
15 seancë private.

16 [Seancë private]

17 [Seancë private teksti i fshirë]

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 78

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë private)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 79

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20 [Seancë e hapur]

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

22 Faleminderit.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të nxjerrim sërish librin

24 në ekran, SPOE00397775? Shkojmë në faqen 38 në PDF, që është

25 SPOE00397812.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 80

1 PY. Z. Covey, në deklaratën tuaj keni thënë se:

2 "... qasja e UNMIK-ut duhet që ishte më e fortë, më
3 bindëse, domethënë, duhet të bënin shumë punë, jo thjesht
4 fjalë."

5 Kështu?

6 PË. Po.

7 PY. Ju keni përshkruar qasjen dhe dinamikën mes UNMIK-ut dhe
8 KFOR-it dhe UÇK-së me hollësi në librin tuaj. Do t'ju lexoj
9 disa pjesë të librit tuaj.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Fillojmë në faqen 105, ju lutem,
11 ana tjetër ku thuhet "Shtrëngimi".

12 PY. Këtu keni shkruar:

13 "Palët në një konflikt në shtete të dështuara
14 përgjithësisht janë dëmtuar edhe më keq sesa mund ta
15 imagjinojë komuniteti ndërkombëtar. Ky ishte dhe rasti në
16 Kosovë. KFOR-i nuk kishte as trupa dhe as forcën të
17 kontrollonte popullatën me forcë. Drejtuesit e UÇK-së shumë
18 lehtë mund të mblidhnin komunitetet lokale në çdo përballje me
19 KFOR-in."

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë ku thuhet
21 "Strategjia politike në zhvillim e sipër".

22 PY. Këtu thoni:

23 "Strategjia politike e pranonte realitetin e vështirë të
24 Kosovës. Rivalët në beteja ishin ende të angazhuar ndaj
25 synimeve të luftës dhe ishin gati të përdornin dhunën për t'i

1 realizuar këto objektive. Përmbushja e objektivave të UNMIK-ut
2 do të ishte një -- do të kërkonte transformim të objektivave
3 të palëve në këtë luftë. Rivalët kryesorë do të donin të
4 shihnim interesat e tyre t'u realizoheshin më mirë bashkë me
5 UNMIK-un. Paqja e Kosovës do të ishte e mundshme vetëm kur
6 rivalët të përqaфонin synimet politike në përputhje me
7 procesin e pages."

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në paragrafin tjetër.

9 PY. "Rezoluta 1244 nuk mori parasysh UÇK-në. Ndonëse
10 komandantët e UÇK-së e pranonin se NATO i kishte ndihmuar të
11 mundnin serbët, ata ndjenin se KFOR-i tani po i parandalonte
12 ta përfundonin detyrën (të përzhinin serbët). KFOR-i
13 perceptohej po ashtu si një organizatë që mbështeti përpjekjet
14 e UNMIK-ut për të shmangur një administratë të udhëhequr prej
15 UÇK-së. Ndonëse UÇK-ja nuk ka qenë veçanërisht ndonjë
16 organizatë koherente, ka ekzistuar konsensus mes drejtuesve
17 ushtarakë se ata duhet ta merrnin situatën nën kontroll.

18 "Nuk kishte opsione praktike për të përballuar UÇK-në nga
19 pikëpamja ushtarake. Të inatosur, të egër, të armatosur, ata
20 kishin kapacitetin për t'u kthyer në male, ku kishin ende stok
21 edhe kishin mbështetje nga anëtarët e klanit."

22 A janë fjalët tuaja këto?

23 PË. Vazhdoni lexoni më tej, ju lutem.

24 PY. "Ushtria e Millosheviqit dhe forcat speciale kishin
25 dështuar tërësisht në atë terren dhe nuk kishte arsye për të

1 besuar se KFOR-i do të ishte më i zoti për ta realizuar këtë."

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër.

3 Paragrafi i dytë.

4 PY. "Dhe pothuajse çdo aspekt tjetër të transformimit të
5 Kosovës, KFOR-i ka ofruar mbështetje ushtarake për strategjinë
6 politike të UNMIK-ut. Sidoqoftë në këtë fushë specifike UNMIK-
7 u ka ofruar mbështetje politike për të trajtuar kërcënimin
8 ushtarak që do të ishte i pamenaxhueshëm përndryshe, sepse nuk
9 kanë ekzistuar opsione ushtarake për të mundur UÇK-në dhe
10 ishte e rëndësishme të zhvillohej një kornizë politike mbi të
11 cilën UÇK-ja mund të përmbahej dhe përfundimisht të
12 çarmatosej. Prandaj lindi dhe ideja risi për ta transformuar
13 UÇK-në në Trupa për Mbrojtjen e Kosovës ..."

14 PË. Ua konfirmoj se këto janë fjalët e mia, po dua të shtoj
15 një koment. Risia nuk ishte transformimi, po është një
16 praktikë standarde kjo. Risia ishte formati në vetvete, pra,
17 ai formati i Trupave për Mbrojtjen e Kosovës ishte risia.

18 PY. Faleminderit.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë. Ndaloni këtu.

20 PY. Në paragrafin tjetër, në mes të paragrafit thoni:

21 "Krahu politik i UÇK-së - i përfaqësuar nga Thaçi - ishte
22 kryesisht i interesuar në mënyrën se si ta përdorte kërcënimin
23 e një UÇK-je të pamenaxhueshme për të forcuar dorën e vet
24 politike."

25 A janë këto fjalët tua?

1 PË. Po. Theksin e kam vendosur tek fjala "kërcënim". Jo,
2 mënyra sesi është zbatuar por fjala "kërcënim".

3 PY. Faleminderit.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në fund të faqes.

5 PY. Në fund, fjalia e fundit, keni thënë:

6 "Ndonëse formimi i TMK-së nuk eliminoi kapacitetin e
7 drejtuesve individualë të UÇK-së të shfrytëzonin procesin
8 politik, i dha Thaçit dhe krahut politik të UÇK-së një kornizë
9 të re politike."

10 Më pas vijoni --

11 PË. Vazhdoni lexoni, ju lutem.

12 PY. "Nuk ka qenë asnjëherë e lehtë për Thaçin të punonte me
13 komandantët në terren të UÇK-së. Tani nuk ishte më përgjegjës
14 për performancën e tyre, as nuk ishte pse të gjente vende pune
15 ai për ish-luftëtarët. Ata ishin të lirë të fokusoheshin në
16 ambiciet e tyre personale, siç bëjnë politikanët në një
17 kornizë, në kornizën që do të fillonte të krijonte UNMIK-u dhe
18 të tjerët për të marrë pushtetin në mënyrë të paqtë."

19 Më pas thoni në shtator 1999 UÇK-ja filloi të kthehej në
20 TMK dhe tre javë më pas u shpall PDK-ja, dhe drejtuesi i PDK-
21 së ishte Thaçi. Shumica e grupimeve rajonale që kishin
22 shërbyer si rrjete politike të UÇK-së u konsoliduan dhe u
23 kthyen në PDK.

24 Pra, kështu e keni konceptuar ju teorinë që diskutuam më
25 herët apo jo?

1 PË. Po.

2 PY. Ju keni dhënë një shembull konkret në faqen 30 të librit,
3 që përndryshe ka numrin SPOE00397804. Këtu përshkruani një
4 incident me Sami Lushtakun, që ka lidhje me Sami Lushtakun.
5 Është paragrafi i dytë i faqes së parë:

6 "Sami Lushtaku ka pasur pozicion drejtues në UÇK gjatë
7 konfliktit edhe më pas u njoh si lord lufte virtuale. Sami
8 Lushtaku besojse ishte personi përgjegjës jo vetëm për të
9 terrorizuar serbët por që ka vrarë edhe shqiptarët që besoj
10 se kishin bashkëpunuar me regjimin serb përpara konfliktit."

11 Më pas theksoni se si policia synonte ta prangoste
12 Lushtakun, por me shumë të ngjarë nuk do të kishte dëshmitarë
13 për të.

14 "Në disa raste të kësaj natyre, kishim ushtruar
15 autoritetin administrativ të UNMIK-ut për ndalime ekzekutive
16 për të arrestuar një person të dyshuar që konsiderohej
17 veçanërisht i rrezikshëm në mënyrë që të kryheshin hetimet pa
18 frikësuar dëshmitarët e mundshëm.

19 "Sidoqoftë, në këtë rast, ne morëm një vendim - në
20 konsultim me KFOR-in - që të mos e çonim më tej këtë punë
21 sepse fillimisht duhet të kishim një prova të forta dhe të
22 kishim një infrastrukturë të fortë civile, ushtarake dhe
23 policore në zonën ku qëndronte Lushtaku."

24 A janë këto fjalët tua?

25 PË. Po. Fjalët e mia janë. Po unë do doja ta shtjelloja më

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 85

1 tej këtë.

2 PY. Do t'ju bëj dhe disa pyetje të tjera.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po përpara se të vazhdoj me
4 pyetjet do të kërkoja që të pranohej faqja me numër
5 SPOE00397804 dhe 00397812.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
7 kundërshtime?

8 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali
10 SPOE00397812 dhe 7813 si dhe 00397804 pranohen.

11 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materialet do të marrin
12 numrin e provës P04496.4. Dhe ju lutem më thoni çfarë
13 klasifikimi duhet të kenë?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jenë publike.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
16 Riklasifikojini dokumentet si dokumente publike.

17 Jemi ende në seancë private, znj. Iodice.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Kalojmë në
19 seancë publike.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kalojmë në
21 seancë publike atëherë.

22 [Trupi Gjykses dhe Sekretari i Gjykatës
23 këshillohen]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni,
25 kishit të drejtë. Jemi në seancë publike në fakt.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

2 PY. Ju keni diskutuar këtë pjesë të librit gjatë seancës
3 përgatitore me Mbrojtjen dhe keni deklaruar se Lushtaku ishte
4 person i rëndësishëm "dhe arrestimi i tij do të kishte krijuar
5 rrëmuje me të cilën pastaj do të duhej të merrej KFOR-i", a
6 është e saktë?

7 PË. Sami Lushtaku ishte, njihej si komandant i zonës në
8 Drenicë dhe kishte reputacionin e një rrugaçi. Sa doni që t'ju
9 jap, dëshironi t'ju jap shumë detaje për këtë?

10 PY. Vetëm dua të di që ajo që keni deklaruar në seancën
11 përgatitore është e saktë apo jo? Arrestimi i tij a do të
12 kishte krijuar trazira të mëdha me të cilat duhet të ishte
13 marrë KFOR-i pastaj, dhe kjo është arsyeja për të cilën keni
14 vendosur të mos e arrestoni atë?

15 PË. Vendimi për të arrestuar atë do të merrej kur të kishte
16 prova të mjaftueshme për të përgatitur akuza dhe për ta
17 zgjidhur çështjen gjyqësore më shpejt, sa më shpejt. Pra, nuk
18 do të ishte e saktë të thuhej se vendimi ishte të mos
19 arrestohej ai. Vendimi ishte që përpara se të arrestoni
20 siguron që i keni të gjitha provat apo elementët në duar.
21 Sepse prokurori jonë, prokurori i mirë profesionist që ishte
22 amerikan, mendonte se ai funksiononte më shumë si Prokurori
23 RICO-s në shtetet ku mund n-- jë figurë udhëheqëse e njohur
24 mund të ndalohej me qëllim që të gjendeshin pastaj dëshmitarët
25 për të ngritur akuzat. Këtu nuk jemi në Nju Jork. Ky ishte një

1 kontekst i paskonfliktit në shtëpinë e dikujt të cilët
2 njiheshin se mund të përdornin mjete, të gjitha mjetet për të
3 ruajtur ndikimin e tyre në komunitet, bashkë me mbështetjen
4 vendore. Pra, ai ishte shumë popullor. Kishte shumë mbështetje
5 në zonën e tij. Dhe ne e dinim këtë.

6 PY. Faleminderit.

7 PË. Dhe rrugaçët janë të njohur dhe kanë mbështetje. Pra,
8 vendimi ishte: Mund ta ndaloni atë në qoftë se i keni
9 elementët ose prova të mjaftueshme për ta zgjidhur këtë sa më
10 shpejt.

11 PY. Faleminderit. Ky incident që është përshkruar dhe nga
12 doktor --

13 PË. Dua të shtoj se, për nevojat e procesverbalit, nuk thuhet
14 këtu, se ne e kemi bërë këtë në konsultim apo duke u
15 konsultuar me KFOR-in. Unë e kam bërë këtë, e kam marrë këtë
16 vendim në pjesë të madhe në orën 11:00 të mbrëmjes apo në
17 mesnatë, natën kur bashkë me prokurorin dhe zëvendësin e
18 policisë. Nuk kam përfshirë Kouchner sepse nuk do doja që të
19 ishte i përgjegjshëm për këtë dhe ne me kujdes kemi informuar
20 KFOR-in për këtë pas kësaj. Pra, në mendjen time është kjo,
21 por ky është arsyetimi që është prapa kësaj.

22 PY. Faleminderit. Dr. Kouchner e ka përshkruar këtë incident
23 në librin e tij.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të shfaqim në ekran ERN

25 SPOE00403545 dhe përkthimin përkatës në anglisht. A mund të

1 kalojmë në faqen 13 në PDF në të dy versionet, që është me
2 numër SPOE00403557. Në krye të faqes së dytë të paragrafit 251
3 të librit, pra, faqja 251. Ta zmadhojmë pak më shumë?
4 Faleminderit.

5 PY. Këtu Dr. Kouchner shkruan:

6 "Në një rast tjetër, komandant Sami Lushtaku, 'hero' i
7 luftës, keqtrajtoi një doktor në një terren futbolli. A duhet
8 të burgosej? Nuk mendova që duhej të bëhej një gjë e tillë.
9 Një vit pas zgjedhjeve që ishin mbajtur me sukses unë
10 fajësohesha akoma për këtë. Cili ishte vendimi më i mirë,
11 zgjedhje demokratike apo një arrestim heroik i Lushtakut për
12 çështje të rëndomta?

13 "Lushtaku u arrestua më vonë.

14 "Këto histori, këto ngjarje të cilat në një mënyrë në
15 formën e tyre ishin të gjitha dështime, ngelën me neve, na
16 ngelën neve. Duke treguar një kuptim bazik, të thjeshtë të
17 politikës, me arritjen e pjesshme në misionin që mendohej i
18 pamundur nga të njëjtët gazetarë, sipas mendimit të tyre,
19 justifikoheshin këto shkelje të vogla të rregullave tona
20 ndërkombëtare. Sa i përket ndryshimit të mentalitetit të
21 kosovarëve, kjo ishte çështje tjetër dhe ishte çështje
22 brezash."

23 A është e saktë të themi që vendimi për të vonuar, për të
24 shtyrë arrestimin e tij ishte një zgjidhje pragmatike në
25 rrethanat në atë kohë?

1 PË. Pragmatike praktike. Admiroj formulimin që ka përdorur
2 Bernardi këtu sepse ai ishte i mbrojtur nga vendimi duke ditur
3 që mund të ishte kontrovers. Por pyetja juaj është a është ky
4 përshkrim i saktë?

5 PY. Pyetja ime është nëse vendimi që ju morët për të shtyrë
6 arrestimin e tij ishte për çështje pragmatike duke patur
7 parasysh rrethanat në atëkohë?

8 PË. Ishte zgjidhje praktike. Nuk e kuptoj se si është kjo
9 ndryshe nga ajo që thashë më herët.

10 Ka ndonjë problem me fjalën "pragmatik"?

11 PY. Jo, s'ka asgjë. Është kuptimi i dytë -- nuk ka kuptim të
12 dytë në pyetjet e mia, pra, ato janë siç janë.

13 PË. Në rregull.

14 PY. Të jeni i sigurtë për këtë.

15 PË. Faleminderit.

16 PY. A është e saktë të themi që të dy, ju dhe Dr. Kouchner,
17 ishit të shqetësuar se arrestimi i Lushtakut mund të
18 destabilizonte krahinën?

19 PË. Unë mora përgjegjësinë për këtë. Ne diskutuam të nesërmen
20 këtë çështje, diskutuam këtë në orën 5.00 me Gjeneralin
21 Jackson dhe ai ishte pajtohej tërësisht me neve, por unë kisha
22 synimin që të merrja përgjegjësinë për këtë gjë në rast se
23 gjërat përkeqësoheshin, ngatërroheshin.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. I nderuar Gjykatës,
25 paraqes këto pjesë të librit të Covey dhe librit të z.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 90

1 Kouchner.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryetar kërkoj ndjesë, por kam
3 pyetur edhe kolegët e mi, ne nuk e kuptojmë ku duhet të dalë
4 Prokuroria me këto pyetje që janë bërë, dhe dëshmitari nuk
5 është konfrontuar apo ballafaquar nëse ai ka vepruar në mënyrë
6 praktike, pra, përsëri kërkojmë që Prokuroria të paraqesë
7 qëndrimin e saj të qartë dëshmitarit në mënyrë që ai të jetë
8 në gjendje të japë, të komentojë mbi pikat konkrete që po i
9 paraqiten atij si qëndrim i Prokurorisë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

12 PY. Z. Covey, ajo që ju kam pyetur unë deri tani, pra,
13 zgjidhja praktike është a pajtoheni ju se në atë kohë duhet të
14 merrnit një vendim pragmatik i cili do të thoshte që drejtësia
15 mund të vinte në rend të dytë sepse paqja ishte më e
16 rëndësishme?

17 PË. Ka dy çështje këtu që janë së bashku. Njëra është
18 përgjegjësia e paqeruajtësve për të ndaluar praktikën.

19 Drejtësia vjen pastaj. Por nuk supozohet se drejtësia vjen
20 gjithmonë pastaj. Duhet fillimisht, është detyra juaj që të
21 ndalohet praktika.

22 E dyta, dhe mendoj që e kemi shpjeguar dhe tjetërkund të
23 dy, UNMIK-u dhe KFOR-i, kishin autoritet jashtëzakonisht të
24 madh. Ata dukej që ishin shumë të fuqishëm. Por, në fakt,
25 aftësia e tyre për të zbatuar këtë autoritet ishte shumë e

1 kufizuar. Ne përdornim një metaforë të makinave të sportit në
2 akull. Pra, ishin të kujdesshëm në zbatimin, në ushtrimin e
3 autoritetit në mënyrën se si e bënim këtë që të mos
4 kundërshtohet dhe të mos mposhtet, pra, të mos hidhet poshtë
5 si autoritet.

6 Pra, ky është një rast në të cilin duket që ne i kemi
7 dalë përpara punës sa i takon aftësisë sonë për të menaxhuar
8 situatën. Pra, në këtë kuptim situatë praktike, vendim
9 pragmatik.

10 Theksoj se ashtu siç e kuptoj unë, është se Sami Lushtaku
11 është arrestuar përsëri -- jo, kërkoj ndjesë. Jo përsëri. Ai
12 është arrestuar herën e parë pas shërbimit tonë në Kosovë dhe
13 është dënuar dhe mund të ketë pasur dhe ngjarje të dytë të
14 mëpasshme. Pra, ai ka patur një të kaluar problematike me
15 ligjin të gjatë dhe kërkoj ndjesë për këtë vendim.

16 PY. Në rregull. Nuk është ajo që doja të thoja. Gjithsesi e
17 pranoj.

18 PË. Në rregull.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, paraqes
21 faqet e librit të Z. Covey, do të doja të paraqesë faqet
22 SPOE00397804 dhe -- më falni, kërkoj ndjesë. Është libri i
23 Kouchner faqja SPOE00403557.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
25 kundërshtim?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 92

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Ritheksoj kundërshtimin tim.

2 Prokurorja nuk e ka paraqitur analizën e tyre të ngjarjeve dhe
3 qëndrimin i tyre që përpiqen të vërtetojnë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mendoj që ajo
5 e bëri këtë gjë dhe ai u shpreh se e kuptoj shumë mirë këtë.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Në rregull. Atëherë do të merrem
7 me këtë çështje kur të më vijë radha për të bërë pyetje si
8 reagim ndaj pyetjeve të Prokurorisë por mendoj se këtë gjë do
9 ta kishte bërë dikush tjetër dhe, pra, që t'i paraqiteshin
10 qëndrimet dhe argumentet e Prokurorisë dëshmitarit.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk besoj,
12 por besoj që ju po e imagjinoni këtë gjë. Megjithatë, atëherë
13 00403545 është -- kërkoj ndjesë është e gabuar. Libri i Dr.
14 Kouchner është 00403557 dhe pranohet.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] E kemi pranuar një kopje
16 më parë të këtyre faqeve nga ky libër dhe do kërkoja qartësim
17 nëse faqja që duhet t'i shtohet provës materiale të pranuar
18 tashmë më P04498.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe mund të jetë
20 publike.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].
22 [Përkthim] 00397804 është pranuar më parë.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo. faqet e tjera të librit janë
24 pranuar. Kjo është faqe shtesë kjo që po kërkoj unë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Cila faqe?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 93

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po kërkoj që të pranohet

2 SPOE00403557.

3 Ato janë pranuar më parë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

5 [Përkthim] Kemi pranuar librin e Kouchner tani, është i
6 pranuar.

7 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të tërin, librin në tërësi? Unë
8 paraqita për pranim --

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, ajo që ju
10 kërkuat, pra, 0403557 dhe thashë që është pranuar.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

13 Ka diçka tjetër, keni diçka tjetër?

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
16 vazhdoni atëherë.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Z. Covey, do të kaloj tek një
18 temë që është ndërlidhur me këtë të cilën e trajtuat dje, kur
19 juve iu tregua një pjesë e raportit që quhet "Treguar siç
20 është parë". Ju e keni diskutuar këtë në faqen 43 të
21 transkriptit të djeshëm, parafjala e Bernard Kouchner.

22 Dhe konfirmuat në seancën përgatitore me Mbrojtjen se ajo
23 që është shkruar në parafjalën përputhet me atë që ju kujtohet
24 juve lidhur me gjendjen në Kosovë në verë dhe vjeshtë të 1999-
25 s. A është e saktë?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 94

1 PË. Po.

2 PY. Faleminderit. A ju kujtohet se drafti i parë i parafjalës
3 është përgatitur nga këshilltari i lartë për të drejta të
4 njeriut William Bill O'Neill?

5 PË. Nuk e di kush e ka përgatitur atë.

6 PY. Në rregull. Dua t'ju tregoj draftin përfundimtar dhe atë
7 fillestar .

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj të shfaqet në ekran
9 SITF00001529 deri në 00001871. Ky është raporti në tërësi me
10 titull "Treguar siç është parë". Faqet që nuk janë pjesë e
11 provave materiale të pranuar më parë me pjesët e raportit në
12 fjalë. A mund të kalojmë tek faqja PDF 3 që është me numër
13 SITF00001531.

14 PY. Parafjala fillon me deklaratën:

15 "Ky raport është lexim interesant."

16 E shikoni këtë?

17 PË. Po.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në fagen PDF 7 që mbaron
19 me ERN 1535.

20 PY. Dhe këtu mund të shikoni paragrafi fillon:

21 "Rruga më e mirë përpara është për Kosovën ..."

22 Kjo fillon kështu dhe mban datën 6 dhjetor 1999.

23 PË. E shoh.

24 PY. Do t'ju kërkoj të keni durim sepse do lexoj disa pjesë të
25 këtij raporti.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shfaqim në ekran krahas njëri-
2 tjetrit 068429. A mund të kalojmë?

3 PY. Ky është drafti i parafjalës dhe në krye shohim datën 25
4 nëntor.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pra, a mund të kalojmë tani, të
6 kthehemi tek faqja 3 e PDF-së, dokumenti i parë, raporti i
7 madh. Po kjo është. Dhe kalojmë në faqen 2, 0684.

8 PY. Tani paragrafi që është i rrethuar, i shënuar me vijë të
9 kuqe fillon me fjalinë "Në shumë raste ..." Po. Mund të
10 shikoni në këtë paragraf, ta lexoni ju lutem.

11 PË. Po, e shoh

12 PY. Tani në qoftë se shohim paragrafin e versionit publik.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Pak më poshtë në faqe. Raporti i
14 madh. Shohim në fund të faqes.

15 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] A mund të më thoni kush
16 është "raporti i madh", ma thoni konkretisht më saktë?

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është raporti i madh, pra,
18 "Treguar siç është parë" dhe zbrisni poshtë në fund të faqes.
19 Këtu është.

20 PY. Këto janë dy paragrafë të njëjtë. Dhe mund të shihni këtu
21 se janë praktikisht të njëjtë, identikë. Pra, njëri përfundon
22 me që "tregohet tolerancë dhe respekt për të gjithë".

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen vijuese, pra, të
24 raportit të madh 0153.

25 PY. Dhe këtu shihet që paragrafi përfundon me fjalinë

1 paraprake të asaj që është draft, ku lexon:

2 "Koha ka ik, ka kaluar koha, ka shumë kohë që ka ikur
3 koha ku udhëheqësit politikë, fetarë, kulturorë në Kosovë të
4 marrin përgjegjësinë që kërkohet nga udhëheqës, duhet ta
5 kishin marrë me kohë këtë përgjegjësi, përgjegjësi që
6 udhëheqësit e vërtetë e marrin dhe të këmbëngulin që për
7 komunitetet që ata udhëheqin, të tregojnë tolerancë dhe
8 respekt për të gjithë."

9 Kjo fjali është hequr nga versioni përfundimtar i
10 raportit. E shikoni këtë?

11 PË. Koha për komunitetet e Kosovës? Është mundur të shihet
12 paragrafi që përfundon me "kryesin"?

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kthehemi në faqen
14 paraprake.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] Në gjysëm. Po. Fjalja e fundit
16 është ndryshuar. Nuk jam i sigurtë për kuptimin e kësaj sepse
17 e dobëson atë në fakt. Në fakt, nuk përputhet me atë që
18 udhëheqësit duhet të bëjnë diçka tjetër përvese në përgjithësi
19 të këmbëngulin.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Po ju kërkoj që të dëgjoni thjesht pyetjet e mia.

22 PË. Në rregull.

23 PY. Dhe nuk keni nevojë të spekuloni lidhur me kuptimin që ka
24 kjo. Unë thjesht po ju pyes të konfirmoni që fjalja e fundit
25 është hequr.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 97

1 PË. Kundërshtoj fjalën "spekulim". Përpiqem të mos spekuloj.

2 PY. Në rregull.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani mund të kalojmë te të dy

4 dokumentet faqe për faqe, faqen 6 në PDF të secilit prej

5 raporteve. Këtu kalojmë në faqen 6, në faqen 6 PDF të secilit

6 prej dokumenteve.

7 PY. Pra, deri në momentin ku fillon fjalia, në pjesën ku

8 fillon fjalia "Kosova nuk do të ndryshohet brenda ditës",

9 dokumentet të dyja janë identike, janë të njëjtë. Pastaj pas

10 paragrafit që përfundon me "këto pengesa duhet të tejkalohen".

11 Fillon me në vijim kemi "këto dokumente janë identike ..." Dhe

12 pastaj pas paragrafit që përfundon me "pengesat duhet të

13 tejkalohen" dhe shihen dy paragrafë që janë shtuar aty. E

14 shikoni?

15 PË. Po.

16 PY. Dhe në këta pesë paragrafë është -- përmenden dekadat e

17 shtypjes që i kanë paraprirë luftës në Kosovë dhe 40 vjetëve,

18 referencë, pra dhe 40 vjetëve komunizëm që i paraprinë kësaj

19 kohe. A ju kujtohet nëse ju apo dikush tjetër në zyrën tuaj i

20 ka shtuar këto paragrafë?

21 PË. Nuk kam qenë i përfshirë në përpilimin e tij.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kërkoj të shfaqim në

23 ekran ERN 052690. Ky është një libër "Page e papërfunduar" nga

24 William O'Neill.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen PDF 57. Kjo

1 është ERN 052747. Në paragrafin e dytë shkruan -- pak më
2 poshtë. Pra, titulli është "Shkeljet e të Drejtave të Njeriut:
3 Karakteristikat dhe përgjigjet".

4 PY. Në paragrafin e dytë, këtu tani në faqen vijuese ka
5 shkruar:

6 "Nga fundi i shtatorit 1999, udhëheqësit kryesorë për të
7 drejtat e njeriut në OSBE, UNHCR, u bashkuan me mua në
8 përfundimin, u pajtuan me mua se shumë -- se bëhej fjalë për
9 shumë më shumë sesa thjesht sulme hakmarrjeje, dhunë e
10 shkaktuar nga vuajtja e padrejtë të kaluarës apo krime të
11 rëndomta. Kjo ishte qartësisht një fushatë e organizuar, e
12 paramenduar, e strukturuar, e pajisur dhe e drejtuar për të
13 sulmuar serbët dhe romët dhe pakicat e tjera thjesht sepse për
14 shkak të përkatësisë së tyre etnike. Nuk ka prova apo tregues
15 të pjesëmarrjes paraprake në persekutimin e tyre, e
16 shqiptarëve, dhe kjo nuk është e nevojshme, pra, thjesht
17 përkatësia e grupit etnik të shënjestruar ishte e mjaftueshme.
18 Turqit dhe myslimanët e sllavonisë ishin gjithashtu të
19 rrezikuar në një shkallë që ku kërcënimi ishte ndryshe, pra,
20 varionte."

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të kalojmë tani në faqen
22 tjetër 59 në PDF dhe në krye të faqes përshkruhet udhëheqja e
23 lartë e UNMIK-ut, qëndrimi i udhëheqjes së lartë.

24 PËRKTHYESI: Kërkojmë që Prokurori të flasë më ngadalë për
25 nevoja të përkthimit.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj falje.

2 PY. Këtu lexon:

3 "Udhëheqja e lartë e UNMIK-ut përfshirë PSSP-në, shprehu
4 dënimin e ashpër në veri në ambiente private lidhur me dhunën
5 që po zhvillohej, e cila ishte dokumentuar në raportin e OSBE-
6 së. Dënimet publike ishin të mirëseardhura por zakonisht me
7 cilësime të ndryshme. Udhëheqja e UNMIK-ut nuk do të përmendte
8 shkeljet aktuale pa iu referuar, pa përmendur të kaluarën,
9 kryesisht të kaluarën, përpjekjen e kohëve të fundit për
10 pastrim etnik nga autoritetet serbe dhe dhjetë vitet e
11 aparteidit që i kishin paraprirë kësaj. Deklaratat për shtyp
12 të UNMIK-ut dhe deklaratat zyrtare zakonisht përfshinin
13 referenca të Irlandës së Veriut dhe Afrikës së Jugut dhe
14 vështirësisë së pajtimit pas këtyre konflikteve."

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kërkoj të kalojmë në
16 faqen 50 të librit.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk do të diskutojmë, bisedojmë
18 për përmbajtjen e këtij paragrafi?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do ta bëjmë këtë pas pak. Po kjo
20 është pjesa që lidhet me atë që dua t'ju tregoj. ERN 052749.
21 Dhe mund të përqendroheni aty.

22 PY. Një përmbledhje e rasteve më flagrante më të njohura të
23 gjetura në raportin e OSBE-së të nxjerrë në dhjetor 1999 dhe
24 rastet e tjera në vijim kanë treguar njëkohësisht natyrën e
25 planifikuar dhe të organizuar të dhunës dhe përfshirjen e

1 personelit të UÇK-së (ushtarak, policia ushtarake e UÇK-së).

2 Në rastin e pjesës veriore të Kosovës së kontrolluar nga
3 serbët, OSBE-ja analizoi rolin dhe përgjegjësinë e grupeve
4 tejet të organizuara të policisë serbe dhe paraushtarakëve.”

5 A pajtoheni që ajo që është shkruar në këtë libër, lidhur
6 me natyrën sistematike të krimeve që ju keni vërejtur,
7 vëzhguar deri në shtator të 1999?

8 PË. Ajo me të cilën nuk pajtohem është mendimi i shprehur në
9 fund të paragrafit që ju sapo treguat.

10 PY. Por duke u përqendruar tek ajo që --

11 PË. Në qoftë se mund të ktheheni tek ajo pjesë?

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kthehemi tek faqja 59.

13 PY. Së pari, a pajtoheni që udhëheqja e lartë e UNMIK-ut,
14 përfshirë PSSP-në, shprehën neverinë e tyre në ambiente
15 private lidhur me dhunën që po ndodhte?

16 PË. Po.

17 PY. Në rregull. Dhe pajtoheni se zyra e PSSP-së vendosi të
18 mos përmendte shkeljet aktuale pa i krahasuar ato me shkeljet
19 e të kaluarës?

20 PË. Kjo është e evidentuar nga përmbajtja e kësaj në këtë
21 parafjalë, parafjala që ne po kërkonim.

22 PY. Po.

23 PË. Ajo përshkruan në mënyrë të saktë se si është bërë
24 paragrafi.

25 PY. Po. Mendoj që këto ishin të gjitha pyetjet e mia.

1 PË. Por dua të jap një koment nëse mundem?

2 PY. Po.

3 PË. Dhe kjo fjalia e fundit thotë:

4 "Ky është një koment që na kujton vazhdimisht që duhet
5 'të kuptojmë kontekstin' dhe 'të kuptojmë atë që ata kanë
6 përjetuar', kjo është interpretuar nga radikalët shqiptarë ...
7 si një dritë në mos jeshile e verdhë për të vazhduar me
8 fushatën e tyre të dhunës ..."

9 Në fakt dhe e them këtë me pak nxehje, sepse është
10 normale, janë negociata normale ku lëshon pe në njërën anë dhe
11 fiton diçka tjetër në anën tjetër në një kontekst burokratik
12 të pranuar. Por këtu ka një lloj, në një farë forme, një qërim
13 hesapesh. Njësia për të drejtat e njeriut e OSBE-së besonte
14 fuqimisht se ne duhet të shkonim menjëherë në gjyqe dhe në
15 drejtësi, ndërkohë misioni i jonë ishte që të pajtonim, të
16 krijonim pajtim dhe të ecnim përpara me shoqërinë drejt një
17 qëllimi social kompleks të ndërlikuar dhe të vështirë. Dhe
18 specialistët e OSBE-së nuk kishin durim, donin të mos merrnin
19 parasysh këto konsiderata, këto vlerësime që bënim. Kjo ishte
20 natyra e ndërlikuar e misionit.

21 Dhe, pra, kështu ishte mënyra sesi paraqiteshin pak
22 radikalët ku jepej një dritë e verdhë, pra, në një farë
23 mënyre.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

25 Z. Covey, është ora për pushimin e drekës. Do të marrim një

1 orë e gjysëm pushim, siç kemi bërë edhe dje. Shihemi në orën
2 2.30.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

5 Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së
6 gjyqit. E di që ju kam thënë.

7 DËSHMITARI: [Mikrofon i çaktivizuar].

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kam thënë
9 këtë disa herë.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk prish punë që të përsëritet.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
12 Faleminderit.

13 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
15 ndërpritet deri në 2.30.

16 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.02

17 --- Seanca rifillon në orën 14.30

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
19 dëshmitarin në sallë.

20 Znj. Iodice, a mund të na tregoni dhe sa kohë ju ka
21 mbetur?

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Unë kam shfrytëzuar pak më shumë
23 se tre orë, dhe besoj se do të më duhen e gjithë koha që kisha
24 parashikuar, domethënë, edhe dy orë të tjera.

25 [Dëshmitari vijon dëshminë]

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jeni gati?

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Po.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
4 vazhdojmë me pyetjet e Prokurorisë. Ju lutem jepini gjithë
5 vëmendjen.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, a mund të
7 paraqes dokumentet që përdora në fund të seancës pararendëse?
8 Dhe këto janë faqet SITF00001531, 1532, 1533 dhe 1535 nga ERN
9 SITF00001529, që ishte pjesë e raportit "Treguar siç është
10 parë", dhe më pas edhe draft-hyrjen që është treguar që ka
11 numrin 068429 deri në 068434, dhe faqet e librit që lexova,
12 faqet 052690, 052694, 052746, 052749, dhe nga 052690 deri në
13 052841. I keni të gjitha.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të duhet
15 këtë ta paraqisni me shkrim, kishte shumë shifra këtu.

16 A keni ndonjë kundërshtim? Do të doni të prisni derisa
17 t'i shihni listën?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Do presim, i nderuar Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

21 PY. Z. Covey, dua tani të kaloni te një pjesë tjetër e
22 deklaratës suaj, të cilën, në të cilën keni diskutuar
23 bashkëpunimin e UNMIK-ut me Hashim Thaçin. Në paragrafin 44 të
24 deklaratës suaj, keni përshkruar se si Qeveria Provizore e
25 drejtuar nga Thaçi "ka ekzistuar të paktën në teori",

1 pavarësisht se nuk luante ndonjë rol në nivel lokal.

2 Në shënimin tuaj përgatitor thatë se "ishte më shumë një
3 ëndërr se sa realiteti".

4 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për cilin paragraf e kishit
5 fjalën, znj. Iodice?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Paragrafi 10(1).

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, në shënimin e parë.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ishte pjesë nga shënimi i parë.

9 Dua t'ju tregoj një dokument nga shtatori i 1999-s, që
10 është prova materiale P04127. A mund ta vendosim në ekran?
11 PY. Ky është një raport javor nga një administrator rajonal
12 që i është dërguar zëvendës PSSP-së, pra administratën civile,
13 ka datën e 20 shtatorit 1999. Së pari, a të kujtohet nëse
14 zëvendës PSSP-ja, pra administratën civile, raportonte në
15 mënyrë të, ju raportonte juve dhe Dr. Kouchner në mënyrë të
16 rregullt?

17 PË. Po, ai merrte pjesë në takimet tona të mëngjesit çdo
18 ditë.

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen 2 të
21 PDF-së. Në pikën (4).

22 PY. Ku në -- me titullin "Lufta për pushtet", raportohet se
23 si:

24 "Gjendja e bllokuar e marrëdhënieve midis këshillit të
25 përkohshëm të bashkiak të emëruar nga UNMIK-u dhe këshillit të

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 105

1 Qeverisë Provizore vazhdonte".

2 Dhe më pas thoshte që:

3 "... e kemi anuluar sesionin e 18 shtatorit për të
4 'eksploruar' emërimin institucional të këshillit. Forcat të
5 cilat janë të lidhura me udhëheqësit e qeverisë, udhëheqësit
6 lokal; të qeverisjes lokale, Kadri Kryeziu dhe Masar Shala
7 vazhduan që ta kundërshtojnë autoritetin e Kombeve të
8 Bashkuara."

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund tani ta zvogëlojmë pak
10 shkronjat, faqen?

11 PY. Dhe pastaj është një listë e veprimeve të ndërmarra nga
12 kryetari i bashkisë së Qeverisë Provizore, përfshirë dhe
13 vendimet e paligjshme që Kryeziu ka lëshuar më datën 13
14 shtator për shkatërrimin e tre ndërtesave, kërcënimet, një
15 prej të cilëve kishte të bënte me dy të rinj të cilët kishin
16 shkuar te këshilli, kishin shkuar, kishin takuar një anëtar --

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nga cili
18 paragraf po lexoni?

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është në shkronjën (b),
20 "Kërcënimet".

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

23 PY. "... shkuan në vendin e punës ku e dinin që edhe fëmijët
24 e tij shkonin në shkollë."

25 Në të tretin, ku bëhet fjalë për:

1 "Ndryshimet me forcë të personelit", ku thuhet që
2 "Kryeziu kishte zëvendësuar drejtorin e furrës së bukës ... me
3 një veteran..."

4 "(d)", ku bëhet fjalë për "Dëbimet me forcë të cilat janë
5 -- urdhri për të cilat është dërguar shqiptarëve në Prizren
6 dhe në Suharekë të cilët nuk ishin anëtarë të UÇK-së".

7 Dhe e fundit ishte --

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe pastaj të kalojmë në faqen
9 tjetër.

10 PY. Te "Komenti" thuhet:

11 "Së pari, këtu bëhet fjalë për personat të cilët ndjekin
12 linjë të ashpër dhe janë të lidhur --

13 PË. Ju kërkoj ndjesë, por e kemi humbur.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
15 tregoni për cilin paragrafin e keni fjalën.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë, të kthehemi në faqen
17 pararendëse. Në fund të asaj, dhe tani po lexoj pjesën e
18 komentit, rreshtin e fundit, ku i thuhet:

19 "Së pari, personat e linjës së ashpër të shoqëruar me
20 Qeverinë Provizore kanë filluar që të veprojnë me guxim
21 gjithnjë më të madh ..."

22 Kalojmë tani në faqen tjetër, në krye të saj, ku thuhet:

23 "... në mbështetjen e dukshme të -- me mbështetjen e
24 deklaratave për shtyp të Hashim Thaçit të bëra nga selia e
25 OKB-së në Nju-Jork."

1 Dy rreshta më poshtë, ku fillon, "nga ana tjetër pak
2 njerëz në Prizren janë të gatshëm që të kundërshtojnë
3 përpjekjet e tyre për ta ngushtuar komunitetin politik me
4 represionin" --

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë.

6 PY. "... me represion dhe terror kundër
7 'ish-bashkëpunëtorëve' (të cilët janë akuzuar pasi nuk është
8 provuar), pra bashkëpunëtorëve të regjimit jugosllav. Shumë
9 liberalë na tregojnë lidhur me frikën që kanë që të etiketohen
10 si tradhtarë dhe pasoja të tjera të pakëndshme që mund të
11 vuajnë."

12 A ju kujtohet në atë kohë nëse ju keni marrë informacion
13 lidhur me këto lloj zhvillimesh në këto komuna?

14 PË. Besoj se kemi marrë një numër raportesh të ngjashme me
15 këtë. Nuk më kujtohet në mënyrë të veçantë kjo që paraqitet në
16 këtë dokument. Megjithatë, mbetej shqetësim, përsëri nuk mund
17 të flas dot për përmbajtjen e tyre.

18 PY. Po, dakord, por të tregoj dhe një dokument tjetër.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në mund të vendosnim P04131.

20 DËSHMITARI: [Përkthim] Nuk e kuptoj referencën në atë
21 dokument ndaj deklaratave të bëra nga Hashim Thaçi nga selia e
22 OKB-së në Nju-Jork. Më duket sikur s'ka logjikë.

23 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

24 PY. Unë pas pak do t'jua tregoj atë deklaratë. Kjo ka datën e
25 tetorit 1999, dhe është raport nga administratori i Gjilanit

1 për administratën civile të zëvendës PSSP-së.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të zbresim pak më
3 poshtë. Të kalojmë në faqen e dytë. Edhe pak më poshtë.

4 PY. Dhe këtu flitet për përgatitjen e dokumentacioneve të
5 paautorizuara, siç mund të shihet aty ku është edhe lënda.
6 Lista paraqit një numër materialesh të cilat komuna e Vitisë
7 kishte përgatitur. Aty është statuti i përkohshëm, aty ka
8 dekrete, ka dekrete për mbrojtjen e pasurisë shtetërore dhe
9 private, certifikata për pronësinë e përkohshme. Dhe po të
10 shihni pikën e katërt, aty thuhet:

11 "Ky dokument bazohet në 'dekretin për organizimin e
12 qeverisë lokale', lëshuar më 31 korrik 1999, nga Hashim Thaçi.
13 Statuti është i posaçëm për komunën e Vitisë."

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen tjetër, ju
15 lutem, në PDF-në 3, faqen 3 të PDF-së, në krye.

16 PY. Dhe aty shënohet që:

17 "Bashkëlidhur me këtë statut është një vendim i cili
18 demonstroi mungesën e njohjes së -- mungesën totale të njohjes
19 së autoritetit të UNMIK-ut sipas Rezolutës 1244, dhe të
20 drejtën e vetos që është vënë në duart e Presidentit, që është
21 në duart e Presidentit."

22 Tani do t'ju tregoj disa prej dokumenteve që janë të
23 paraqitura, të renditura këtu.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të kalojmë tani në faqen 20 të
25 PDF-së. Ta zvogëlojmë pak.

1 PY. Kjo është një dekret i lëshuar nga Qeveria Provizore, e
2 përkohshme.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në faqen pasuese, dhe e
4 zvogëlojmë, dhe në faqen tjetër. Edhe kalojmë edhe në faqen
5 tjetër. Zbresim më poshtë.

6 PY. Dhe aty poshtë do të shihni që, dhe ka aty bllokun e
7 nënshkrimeve ku thuhet "Presidenti Hashim Thaçi" dhe data që
8 është 31 korrik 1999. A pajtoheni me mua se ky është një
9 shembull i autoriteteve të Qeverisë së Përkohshme e cila
10 zbaton rregulloret e lëshuara nga Hashim Thaçi?

11 PË. Cila ishte pyetja?

12 PY. A jeni dakord që kjo është një shembull?

13 PË. Unë nuk e kam parë këtë letër. E shoh që ka një datë që
14 është dy javë mbas mbërritjes sonë, që është në fillim të
15 mandatit të përpjekjeve tona. Në atë ne nuk kishim dialog fare
16 me z. Thaçi.

17 PY. Po kjo do të shkonte në kundërshtim me mandatin e
18 UNMIK-ut, apo jo?

19 PË. Po.

20 PY. Faleminderit. Në deklaratën tuaj përmendët në mënyrë të
21 posaçme që kur mbërritët në Kosovë z. Thaçi në bashkëpunim me
22 UNMIK-un, duke e larguar, si të thuash, vëmendjen e tij nga
23 Qeveria së Përkohshme.

24 PË. Kjo ndodhi gjatë një kohe të caktuar, përgjatë një
25 periudhe kohore.

1 PY. Faleminderit.

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të vendosim tani provën
3 materiale në ekran P01977?

4 PY. Është një telegram i cili ka inicialet tuaja dhe e ka
5 titullin "Bisedimet me Thaçin". Ka datën 7 gusht.

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në faqen
7 pasuese.

8 PY. Këtu janë shënime të takimit që PSSP-ja ka patur me
9 Thaçin.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në fund të faqes, në pikën 4
11 është "administrata civile".

12 PY. Po e lexoj sepse është e vështirë për ta lexuar. Në
13 "Administratën civile" thuhet:

14 "Thaçi tha se organizatat e komunave që kishin ndërtuar
15 funksiononin siç duhet dhe UNMIK-u duhet t'i njohë, t'i
16 pranojë. Zëvendës PSSP-ja tha se UNMIK-u donte që forcat
17 policore lokale dhe strukturat lokale të Kosovës, donte që të
18 ishin, të bashkëpunonin ngushtë me punën e tyre ekzekutive.
19 Por donte ta bënte të qartë që UNMIK-u ishte organi
20 përgjegjës".

21 Në fund thuhet:

22 "Thaçi la të kuptohej që nuk ishte e nevojshme që të
23 imponohej një strukturë ndërkombëtare mbi strukturat
24 funksionale vendore apo lokale".

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të kalojmë në faqen pasuese.

1 Të përqendrohemi në pikën 6, "Pasuritë".

2 PY. Këtu thuhet që Thaçi ka thënë që:

3 "... ishte gabim që UNMIK-u të merrte nën kontroll të
4 gjitha pronat publike. Do të ishte mirë sikur këto prona të
5 menaxhoheshin nga 'forcat përfaqësuese të Kosovës' me UNMIK-un
6 duke luajtur një rol mbikëqyrës."

7 Dhe ju u përgjigjët që:

8 "... kjo do të ishte e vështirë, të paktën për sa i
9 përket faktit që nuk ka marrëveshje mes partive të ndryshme
10 shqiptare lidhur me mënyrën e bashkëpunimit."

11 Dhe po të përqendrohemi tani te "Komenti", aty të
12 përqendrohemi te komenti. Aty pas pjesës së redaktuar, thuhet
13 që:

14 "... Thaçi po përpiqet ende që të konsolidojë bazën e tij
15 të pushtetit dhe rolin ekzekutiv të UÇK-së në terren. Në këtë
16 drejtim, është e rëndësishme që UNMIK-u të dislokohet në
17 terren sa më shpejt që të jetë e mundur ..."

18 Pra, ky ishte vlerësimi i veprimeve të Thaçit nga ana e
19 UNMIK-ut.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju mund të
21 duhet -- duhet ta riformuloni pyetjen.

22 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

23 PY. Ky është vlerësimi i veprimeve të Thaçit nga ana e UNMIK-
24 ut në atë kohë, kështu është?

25 PË. Vlerësimi im në atë kohë ishte se pikërisht këtë do të

1 thoshte ai. Kjo ishte, ishin fillesat e procesit që kishim
2 nisur. Kjo ishte një shkëmbim mendimesh. UNMIK-u i mbante
3 parasysh gjatë gjithë kohës që nuk mund të arrihet asgjë kur
4 s'ke personelin e duhur dhe aparati ynë, apo burimet, nuk
5 ishin aty për t'u dislokuar. Kështu që ne ishim duke blerë
6 kohë, si të thuash, me qëllim që të mund të anashkalonim ato
7 fantazi të Qeverisë së Përkohshme.

8 Pra, ne nuk ishim të çuditur fare. Si mund të mos e
9 thoshe këtë gjë?

10 PY. Faleminderit, por vlerësimi juaj që ishte duke
11 konsoliduar bazën e tij për pushtet, apo jo?

12 PË. Po, por nuk dhe të përqendrohesha tek kjo frazeologjia.
13 Ai po na provonte neve, siç po e provonim ne atë. Është pjesë
14 e marrjes në provë. Është një proces, ky është vetëm një
15 vlerësim në kuadër të një procesi që evoluonte. UNMIK-u ishte
16 i vendosur që do të ishte drejtues, por nuk do ta bënte këtë
17 me detyrim. Ne kishim nevojë që me anë të burimeve t'i bindnim
18 njerëzit në afat të shkurtër dhe afat të gjatë, që ishte më
19 mirë për të të bashkëpunonin. Pra, unë nuk do të
20 përqendrohesha shumë në gjuhën ekzakte të përdorur në këtë
21 koment.

22 PY. Faleminderit. Tani, deklaratës për shtyp që përmendëm më
23 herët. Së pari, aty -- ju kujtohet deklarata që ka dhënë në
24 shtator të vitit 1999 tek -- në OKB, Hashim Thaçi?

25 PË. Jo, nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet qartë.

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund të vendosim P04198?

2 PY. Ky është shënimet e një konference për shtyp që ka dhënë
3 z. Thaçi tek Kombet e Bashkuara në Nju-Jork më 17 shtator
4 1999.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në faqen 1 të PDF-së. Të shkojmë
6 në paragrafin e dytë. Në paragrafin e tretë ku thuhet që
7 "Shumë prej atyre fenomeneve negative ..."

8 PY. Siç e shihni këtu, ai thotë që shumë fenomene negative
9 ishin shkaktuar nga fakti që faktori indigjen Kosovar nuk
10 ishte marrë parasysh nga prania ndërkombëtare, në mënyrë të
11 posaçme nga UNMIK-u dhe nga Bernard Kouchner, dhe ata nuk
12 ishin lejuar që të jepnin kontributin e tyre për zgjedhjen e
13 shumë problemeve të cilat përballej Kosova.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani kalojmë në faqen 3 të
15 PDF-së.

16 PY. Në atë konferencë atë e kanë pyetur lidhur me problemet
17 që ka përjetuar me PSSP-në.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ta zvogëlojmë pak faqen. Pak më
19 poshtë. Duhet të jemi në faqen 3 të PDF-së, jo 2. Paragrafi i
20 fundit që shihet.

21 PY. Ku z. Thaçi e pyetën nëse po përgatitej dhe kërkonte që
22 z. Kouchner të shkarkohej, ai tha që, "Nuk kishte ardhur këtu
23 për të kërkuar shkarkimin e z. Kouchner, qëndrimet negative që
24 ka ndërmarrë z. Kouchner mund të përmirësoheshin". Ai tha që:

25 "Populli i Kosovës kërkonte bashkëpunim, nuk kërkonte

1 mbret.”

2 A të kujtohet tani kjo konferencë shtypi?

3 PË. Jo, nuk më kujtohet në mënyrë të posaçme. Por tani që e
4 lexoj, është pikërisht ajo që pritej të thoshte, ai në këtë
5 fazë të një procesi që ishte në zhvillim e sipër. Mos harrojmë
6 që është tre ditë përpara përfundimit të marrëveshjes lidhur
7 me TMK-në. Tensionet ishin të larta.

8 PY. Në paragrafin 71 të deklaratës suaj, keni përshkruar në
9 hollësi bashkëpunimin e Thaçit me UNMIK-un dhe keni shpjeguar
10 se si i keni përfshirë në procesin politik dhe i keni, dhe se
11 si ka luajtur në mënyrë të, ka luajtur rol përgjegjës në SPAP.

12 PË. I cili, proces i cili u krijua pak më vonë.

13 PY. Dakord.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani të përqendrohemi tek
15 materiali me numër SPOE40015904.

16 PY. Jua tregova këtë libër pak më parë sot, që është ditari i
17 Gjeneralit Reinhardt.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe tani do të dëshiroja të
19 shkonim në faqen 29 në anglisht të PDF-ja, dhe 108 në
20 variantin origjinal, që ka SPOE40016011. Është data 15 nëntor.
21 Në të dyja gjuhët të kalojmë në faqen pasuese.

22 PY. Gjenerali Reinhardt këtu tregon se gjatë diskutimeve në
23 darkë --

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të zmadhojmë pjesën që
25 ndodhet në të majtë të ekranit në anglishte. Faleminderit.

1 PY. Paragrafin ku e ka emrin Bernard Kouchner, ku thuhet:

2 "Bernard Kouchner na ka informuar gjithashtu që Hashim
3 Thaçi i ka 'deklaruar luftë' atij dhe UNMIK-ut sot. Ai thotë
4 që Thaçi i tha atij që ishte i lodhur nga paefektshmëria e
5 UNMIK-ut. Ai kërcënoi që kishte mbështetjen e kryeqyteteve
6 shumë të rëndësishme, kryesisht të Uashingtonit, dhe se do ta
7 bojkotonte UNMIK-un dhe KFOR-in nga ky moment e tutje derisa
8 ata të zbatonin dëshirat e tij".

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në gjysmën tjetër të
10 kësaj faqeje, në krye pra të kësaj faqeje, në anglishte. Më
11 lart, më lart.

12 PY. Dhe thuhet që, shënon që:

13 "Më duhet të flas menjëherë me Thaçin, pasi nuk ka kuptim
14 asgjë prej kësaj dhe nuk jam i gatshëm që ta vazhdoj
15 bashkëpunimin me të mbi këtë bazë."

16 PË. Kush është "unë" në këtë rast? Është Reinhardt?

17 PY. Po, është treguar në vetën e parë, është ditari i tij.

18 Dhe pastaj kemi edhe shënimet e datës 16 nëntor ku thuhet
19 që:

20 "Thaçi po e bojkoton takimin e sotëm të komitetit.

21 Refuzimi për bashkëpunim tregon përbuzje për institucionin dhe
22 anëtarët e tjerë të komitetit të përkohshëm. Ai sillet si një
23 fëmijë i cili mërzhitet kur nuk i japin pikërisht atë lodrën e
24 tij, dhe lodra që dëshiron është presidenca e Kosovës dhe
25 udhëheqja e vetme politike nën ombrellën e administratës së

1 Kouchner."

2 Pra, Reinhardt e ka të drejtë, apo jo, kur bëhet fjalë që
3 Thaçi donte presidencën dhe udhëheqjen e vetme nën ombrellën e
4 UNMIK-ut.

5 PË. Me gjithë admirimin që kam për Gjeneralin Reinhardt, e ka
6 ekzagjeruar atë çështje. Pika që është, pika që po ngrihet
7 këtu është që nuk do të ishte, një si të thuash, një ndihmë,
8 përpjekje për të qenë drejtuesi i një procesi diplomatik
9 social apo politik. Ne kemi patur ditë të mira e ditë të
10 këqija. Por kjo do të thoja që kishte një taktikë. Thaçi u
11 kthye në këshillin provizor jo shumë më pas dhe ndodhi, nuk
12 ishte hera e parë që u largua nga ky takim, dhe në fakt nuk
13 ishte as anëtari i parë apo i fundit që u largua nga një rast
14 apo një tjetër kur nuk -- kur ishin të frustruar.

15 Unë them që karakterizimi i tij i një fëmije që mërzhitet
16 në fakt e ilustron seriozitetin e tij, pjesëmarrjes së tij në
17 këtë këshill provizor. Këtë e bënte për t'u përkujtuar të
18 gjithë pasuesve të tij se sa serioz ishin në punën e tyre, apo
19 kur kërkonin që të nxirrnin përfitime nga bashkëpunimi me
20 UNMIK-un. Këta nuk ishin fare të çuditshme si zhvillime, dhe
21 nuk kanë zgjatur për një kohë të gjatë.

22 PY. Atëherë të shohim se si është kthyer, si është sjellë
23 Thaçi kur u kthye përsëri të merrte pjesë në punën e këshillit
24 provizor.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë shohim materialin,

1 shkojmë tek origjinali, në PDF është faqja 130, në anglisht
2 është faqja 35. Është një shënim i datës 8 dhjetor 1999,
3 shkojmë në faqen tjetër ju lutem, në të dyja gjuhët. Ju lutem
4 zmadhojeni pjesën e parë të anglishtes. Faleminderit.

5 PY. Këtu thuhet:

6 "Ky raund argumentesh të civilizuara është ndjekur nga
7 një takim çuditërisht i habitshëm i Këshillit Tranzitor të
8 Kosovës, gjatë të cilit Thaçi kthehet në një aktor. Është hera
9 e parë që prej 27 tetorit 1999, që ai shfaqet në komitet. Ai
10 nuk heq madje as pallton që ka veshur, por fillon një sulm
11 agresiv, një bisedë agresive apo sulm agresiv kundër UNMIK-ut
12 dhe KFOR-it. Inati i tij përshkallëzohet me çdo fjali që
13 thotë, dhe i akuzon si në vijim ..."

14 Në fund të faqes thotë:

15 "Ai nuk lejon asnjëri që ta ndërpresë, është i zemëruar
16 dhe në fund të kësaj bisede, debati, ofron që ta rifillojmë
17 bashkëpunimin ekskluzivisht sipas kushteve të tij. Me fjalë të
18 tjera, nën presidencën e tij". Shkojmë në faqen tjetër, "Nëse
19 nuk përmbushet kjo kërkesë ai thotë se do të refuzojë
20 bashkëpunimin në të ardhmen. Pas kësaj deklarate del. Del me
21 furi nga dhoma si *prima donna* në një komedi. Është për të
22 qeshur, në fakt, në mos për të qarë. Thaçi nuk na jep as
23 mundësinë më të vogël të diskutojmë akuzat që ngriti".

24 Vijon më tej.

25 A keni ju dijeni që Gjenerali Reinhardt i ka shënuar këto

1 në shënimet e asaj kohe, këtë ngjarje?

2 PË. Jo, nuk e di që ka mbajtur ditar, jo.

3 PY. Keni ndonjë arsye t'i kontestoni këto, që janë thënë këto
4 shënime të asaj kohe?

5 PË. Jo nuk kam ndonjë arsye të kontestoj që i ka shënuar këto
6 por sigurisht kam interpretim ndryshe nga ai i tij. Të paktën
7 disa nga parashikimet e nxituara që ka bërë ai, apo
8 konkluzionet e nxituara. Por ishte Bernardi, në fakt, që duhet
9 të trajtonte pasionet individuale të secilit person aty, dhe
10 ai ishte vëzhguesi kryesor aty.

11 PY. Faleminderit. Bernard Kouchner, më falni reagimi i
12 Bernard Kouchner është në paragrafin tjetër.

13 "... Kouchner shpjegon që është i vendosur këtë javë të
14 paraqesë versionin përfundimtar të Këshillit të Përkohshëm
15 administrativ ..."

16 Dhe më pas:

17 "Thaçi duhet të ishte i pari. Pas performancës së sotme,
18 me shumë të ngjarë do të vijojnë pa të."

19 PË. Nuk funksiononte kështu, jo.

20 PY. Më pas vijon:

21 "Kjo ishte mënyra e vetme si mund ta trajtoja rastin e
22 Thaçit, sepse këmbëngulte që duhet të ishte patjetër numri
23 një. Edhe ai vonoi bashkëpunimin politik për javë të tëra."

24 Shkojmë më poshtë në tekst.

25 "E mbështes vendimin e Bernardit për të marrë një qëndrim

1 pak më të rreptë, përndryshe nuk do ta kemi asnjëherë
2 administratën e UNMIK-ut në terren. Unë shpresoj që Bernard
3 Kouchner të mos tolerojë, me shpresën që të ketë bashkëpunimin
4 e Thaçit."

5 Keni pasur dijeni lidhur me këtë? A e keni diskutuar
6 ndonjëherë me Gjeneralin Reinhardt?

7 PË. Po duhet t'i kemi -- si rregull ne i diskutonim të gjitha
8 këto. Ne kishim takime në orën 5.00 të rregullta, domethënë,
9 dhe sigurisht që diskutonim këtë. Takimet që kishte filluar
10 Gjenerali Mike. Kështu që qartazi dhe këto gjëra
11 diskutoheshin.

12 PY. Faleminderit.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen 136 në versionin
14 origjinal, dhe në 40, faqja 40 në anglisht. Me ERN
15 SPOE40016039. Ky shënim është i datës 12 dhjetor 1999. Shkojmë
16 në faqen tjetër në të dyja gjuhët, ju lutem. Dhe të fokusohemi
17 te ky paragraf.

18 PY. Këtu përshkruhet se si:

19 "Hashim Thaçi ka thirrur Bernard Kouchner -- i ka kërkuar
20 Bernard Kouchner dhe një herë t'i shpjegojë ato se ai ishte
21 sërish jashtë. Ky person është totalisht i pabesueshëm. Ky
22 është një person me të cilin nuk është më e mundur të punohet,
23 por ama nuk mund ta shpërfillim. Ai e di këtë dhe po luan
24 kartat. Kouchner tanimë po konsideron të ndryshojë qasjen
25 organizative edhe një herë në mënyrë që të ketë edhe Thaçin

1 përkrah. Unë e këshillova të mos e bënte këtë fuqimisht, pasi
2 në këtë mënyrë Thaçi do ta përshkallëzojë trysninë politike
3 ndaj tij. Unë mendoj që kjo sjellja kaq e butë e Bernard
4 Kouchner që kërkon gjatë gjithë kohës kompromis është një
5 gabim shumë i madh.”

6 Vijon më pas në test dhe thotë:

7 “Thaçi ka bllokuar gjithçka për një kohë shumë të gjatë
8 tashmë.”

9 Pra, ju kujtohet ju që Reinhardt i ka thënë Kouchner që
10 të mos ndryshonte qasje?

11 PË. Jo, besoj se e ka ekzagjeruar frustrimin e Kouchner.

12 Është e habitshme në fakt -- por jo, nuk më habit shumë në
13 fakt, kur thotë ai që Bernardi ishte i butë. Unë madje e kam
14 përshkruar, edhe unë e kam përshkruar qasjen e Bernard, por
15 ama ndryshe. Bernardi, kur ishte e mundur, nuk ishte agresiv
16 dhe thoshte patjetër jo. Ai bllokonte një opsion, por ama të
17 ofronte opsione të tjera, që funksiononin në mënyrë që të
18 përmbusheshin objektivat e UNMIK-ut. Po flasim shumë
19 teorikisht për paqen përgjithësisht, por dua t’ju kujtoj të
20 gjithëve se ne ishim tërësisht në dijeni që ky ishte një
21 proces thuajse tërësisht psikologjik. Me theksin si tek
22 psikologjia, si tek procesi. Nuk ishte diçka që ishte e
23 përkohshme. Edhe ka procedura. Fillon një procedurë dhe
24 mbaron, por nuk funksionin gjithmonë logjika, jo gjithçka
25 bëhet me logjikë.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 121

1 Kështu që unë nuk kam i habitur që Reinhardt ndihej i
2 frustruar në këtë pikë, sepse edhe ne ishim të frustruar. Ne
3 kishim punuar shumë, ishte bërë shumë punë, dhe tani po
4 komunikoni me një person shumë të ri, shumë, shumë të ri në
5 moshë, i cili po përpigëj të shfrytëzonte mundësinë që
6 mendonte se ishte mundësia më e mirë për të. Unë nuk habitem,
7 nuk më habit fakti që ai është sjellë kështu fillimisht.

8 Unë po përfundoj këtu, por nëse doni më shumë detaje, me
9 shumë kënaqësi do t'jua jepja.

10 PY. Faleminderit.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj
12 pranimin e faqeve që sapo përdora, sapo i paraqita
13 dëshmitarit, SPOE40016011, 16012, SPOE4016033 dhe 034, dhe
14 16039 dhe 16040.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
16 kundërshtime?

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk ka kundërshtime.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të
19 pranohen materialet që sapo cituam, ju lutem, jepni numrin
20 përkatës.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Pjesë të të njëjtit
22 libër që janë përdorur dhe janë pranuar kanë marrë numrin e
23 provës P04497. Kam nevojë për një sqarim, duhet të bashkëngjit
24 këto materialet tek prova që është pranuar tashmë, te
25 materialet që janë pranuar tashmë, apo doni provë më vete?

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 122

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çfarë

2 mendoni?

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do preferoja t'i bashkëngjiteshin
4 provës P04497.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë, në
6 këtë rast, materiali do të marrë numrin, do të bashkëngjitet
7 me provën 04497.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] A mund ta bëjmë pushimin prej
10 dhjetë minutash tani?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Në rregull.

13 PY. Në deklaratën tuaj keni folur dhe për Hashim Thaçin, dhe
14 se si kishte bërë thirrje për tolerancë dhe mbështeste një
15 Kosovë shumë partiake, demokratike. A ju kujtohet se në
16 vjeshtën e 1999-s krimet e kryera nga UÇK-ja dhe anëtarë të
17 TMK-së u bënë një problem shumë i madh për ju?

18 PË. Ishin shqetësimi kryesor i UNMIK-ut, sepse deshën që t'i
19 jepnin fund dhunës.

20 PY. Siç thoni në Shënimin Përgatitor numër 1, 1D00391,
21 paragrafi 10(t), ju thoni: Zyrat e OKB-së ju udhëzuan të
22 kontaktonit si Çekun dhe Thaçin, apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Faleminderit. A ju kujtohet se arsyeja që ju dha selia e
25 OKB-së ishte pikërisht që UNMIK-u të trajtonte këto krime?

1 PË. Ka një histori, ka një kontekst tjetër për këtë.

2 PY. A ju kujtohet këtë, a ju kujtohet udhëzimi?

3 PË. Po.

4 PY. A ju kujtohet që ju është kërkuar të kryeni një hetim të
5 plotë?

6 PË. Çfarë të kryenim?

7 PY. Një hetim të plotë.

8 PË. Po.

9 PY. Në Shënimin Përgatitor 2, në faqen DHT12105, ju thatë se
10 ju ishit në dijeni se kishte akuza se, pretendime se UÇK-ja
11 ishte përfshirë në veprimtari kriminale, apo jo?

12 PË. Çfarë?

13 PY. Gjatë --

14 PË. Ju lutem, përsëriteni pyetjen.

15 PY. A ju kujtohet që keni thënë se e dinit se ekzistonin
16 pretendime se UÇK-ja ka qenë e përfshirë në veprimtari
17 kriminale?

18 PË. Po, sigurisht që isha në dijeni të këtyre pretendimeve.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të shohim tani
20 materialin SPOE002127212 [Sipas përkthimit] deri në 00212737.
21 Duhet të shkojmë në faqen 5 të materialit PDF.

22 PY. Keni parë këtë dokument dhe më përpara, por ky është
23 versioni që na është autorizuar për t'u përdorur në Gjykatë.
24 Prandaj, do të doja që të na jepnit disa detaje.

25 A ju kujtohet që kjo është përgatitur për të, në zbatim

1 të kërkesës së OKB-së?

2 PË. Po, nga personeli për t'iu përgjigjur udhëzimeve, po, po.

3 PY. Dhe thotë është hapi i SRG-së, dhe këtu përmenden disa
4 incidente specifike që kanë lidhje me anëtarë të UÇK-së dhe të
5 TMK-së.

6 PË. Mund të ma rifreskoni kujtesën?

7 PY. Po.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Atëherë shkojmë në faqen 7 të
9 PDF-së, fillimisht. Këto janë shënimet që janë përgatitur për
10 një takim mes SRSG-së dhe Thaçit, pra këto ishin gjërat që do
11 t'i thoshte SRSG-ja Thaçit, nëse do të bëhej ky takim.

12 PY. Siç mund ta shihni, në rreshtin e pestë thuhet:

13 "Veprimtaritë kriminale të anëtarëve të ish-UÇK-së dhe
14 përkrahësve tuaj kërcënojnë mbështetjen ndërkombëtare.

15 "Ka pretendime se janë ekzekutuar shqiptarë nga parti të
16 tjera politike, që janë kryer nga persona të lidhur me UÇK-në,
17 dhe kërcënime të shumta ndaj shqiptarëve dhe sulme ndaj
18 serbëve."

19 Më poshtë thuhet:

20 "Besohet gjerësisht se mungesa e udhëheqjes së fortë
21 lidhur me këtë aspekt, tregon se ish-udhëheqja e UÇK-së i
22 toleron, madje dhe i miraton, aktet e hakmarrjes dhe të
23 frikësimit."

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani shkojmë në faqen 9 në PDF.

25 PY. Këto janë incidentet e renditura, e radhitura, përfshirë

1 këtui siç mund ta shihni, që pesë ish-anëtarë të UÇK-së kanë
2 kërcënuar të dëbojnë familje nga një shkollë, pastaj katër
3 ish-UÇK kërcënojnë një shqiptar, pastaj sulme ndaj një
4 personi, një individi, dhe kështu me radhë.

5 A ju kujtohet nëse Kouchner i ka kryer ndonjëherë këto
6 udhëzime?

7 PË. Jo, nuk -- është i gabuar formulimi juaj. Nuk kishte si
8 t'i bënte ai këto, se këto ishin hartuar nga personeli. Këto
9 nuk ishin të dobishme. Nuk ishte një strategji e dobishme e
10 UNMIK-ut këto shënime, fillimisht këto hapa domethënë.
11 Fillimisht këtu është hipotetike sikur Kouchner i është
12 drejtuar Thaçit sikur të ishte Thaçi personi përgjegjës për
13 TMK-në. Kjo nuk përputhej me strategjinë e përgjithshme që
14 zbatonim ne. Unë kam punuar shumë për këto pika, dhe
15 përfundimisht vendosëm të hartonim një dokument tjetër për
16 Çekun, më të drejtpërdrejtë, dhe pikat e tjera për Thaçin, që
17 kishin për synim të ishin në pajtim me rolin politik.
18 Veçanërisht ne nuk donim të sugjeronim në asnjë formë që
19 z. Thaçi të kishte ndonjë lloj përgjegjësie për TMK-në.

20 PY. Faleminderit.

21 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kërkoj pranimin e kësaj pjese si
22 provë gjyqësore, që bëhet fjalë deri SPOE00212725, 212729.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
24 kundërshtime?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtime.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 126

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Materiali,
2 atëherë, SPOE00212725 deri në -- 729, thatë?

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë publik.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, për kë
5 numër po flisni? Po thoni 2729?

6 ZNJ. IODICE: [Përkthim] 725-729.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Materiali që përfundon me 725-729, pranohet.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali ka
10 klasifikimin konfidencial, edhe do të marrë numrin e provës
11 P0901 [Sipas përkthimit].

12 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

13 PY. A ju kujtohet që keni krijuar një task forcë për krimet e
14 TMK-së?

15 PË. Përsëriteni, ju lutem.

16 PY. A ju kujtohet që krijuat një task forcë, apostafat për të
17 parë çfarë krimesh ishin kryer nga anëtarët e UÇK-së edhe
18 TMK-së?

19 PË. Task forcë brenda UNMIK-ut po thoni?

20 PY. Po.

21 PË. Nuk më kujtohet qartë kjo gjë.

22 PY. Do ju tregoj një dokument që t'ju rifreskoj kujtesën.

23 PË. E vlerësoj këtë gjë.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ju lutem, të vendosim në ekran
25 materialin P04133.

1 PY. Kjo është memo *interoffice*, brenda zyrave të UNMIK-ut,
2 lënda është "Veprimtaritë dhe informacioni i marrë nga task
3 forca gjatë tri javëve të fundit". Data është 6 nëntor 1999.

4 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë më poshtë. Pak më lart.

5 PY. Këtu thuhet se kanë marrë 7500 emra të ish-anëtarëve dhe
6 anëtarëve aktualë të UÇK-së --

7 PË. Çfarë date ka dokumenti?

8 PY. 6 nëntor 1999. Pra, thuhet se kanë marrë emra te
9 ish-anëtarëve dhe anëtarëve aktualë të UÇK-së dhe të TMK-së:
10 "... si rezultat i këtyre hetimeve janë kryer lidhjet se,
11 është përcaktuar se janë kryer veprimtari të paligjshme nga
12 TMK-ja dhe anëtarë të lartë të TMK-së."

13 Jepen dhe disa shembuj konkretë këtu, përfshirë
14 rrëmbimet, sulmet, kërcënimet ndaj shqiptarëve dhe serbëve.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Shkojmë në faqen 4 tani në PDF.

16 PY. Kjo është lista e disa shembujve, pra, të krimeve që po
17 hetojnë. A ju ndihmon kjo me kujtesën, ju rifreskon kujtesën
18 që ka ekzistuar një task forcë e tillë?

19 PË. Në fakt, jo. Dyshoj, ose po spekuloj. Po spekuloj, më
20 saktë. Ma merr mendja që kjo ka qenë një task forcë pranë
21 Shtyllës II, mbase në departamentin e policisë, jo një task
22 forcë brenda zyrave qendrore të UNMIK-ut. Kështu që jo,
23 konkretisht nuk më kujtohet kjo.

24 Tani, incidentet që janë raportuar këtu, janë pak më vonë
25 në proces. Megjithatë, mund të flasim kur të vijë momenti i

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 128

1 duhur për procesin e fillimit të trajtimit të gjithë personave
2 që pretendonin se kishin qenë në UÇK, edhe -- megjithatë nuk e
3 di a iu përgjigja pyetjes suaj.

4 PY. Po.

5 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani është momenti i përshtatshëm
6 për pushimin.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Në fakt e kaluam shumë shpejt atë
8 pjesën, pra, atë materialin dhe hapat që diskutuam për
9 Gjeneralin Çeku.

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Nuk është problem, sepse janë
11 pranuar si prova, dhe Gjykatësit i kanë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do të bëjmë
13 dhjetë minuta pushim, Dëshmitar, dhe për sot kanë ngelur dhe
14 50 minuta. Pas pushimit do të kemi 50 minuta për të përfunduar
15 ditën.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Bëjmë pushim
18 deri në orën 15.40.

19 --- Pauza fillon në orën 15.27

20 --- Seanca rifillon në orën 15.40

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
22 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

23 [Dëshmitari vijon dëshminë]

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
25 z. Covey, do vijojmë me pyetjet nga Zyra e Prokurorisë së

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 129

1 Specializuar.

2 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar

4 Gjykatës.

5 PY. Z. Covey, në deklaratën tuaj dhe ashtu si e keni thënë
6 dhe dje në Gjykatë keni biseduar për faktin që udhëheqësit që
7 bënin thirrje për tolerancë vinin veten në rrezik. Gjatë
8 seancës përgatitore ju e keni diskutuar këtë temë dhe ju keni
9 thënë, deklaruar pra, që ju nuk kishit njohuri të
10 drejtpërdrejtë të sulmeve ndaj Hashim Thaçit për shkak të
11 thirrjeve të tij për tolerancë. A është kjo e saktë?

12 PË. Nuk kam njohuri për sulmin të drejtpërdrejtë ndaj tij për
13 shkak -- apo që lidhen me deklaratat e tij, por mendoj që kur
14 e kam përmendur këtë e kam thënë në një kontekst më të gjerë,
15 pra, se deklarata të tilla jo vetëm në rastin e Kosovës por në
16 proceset e paqëbërjes në përgjithësi i vinin njerëzit shumë në
17 rrezik nga pikëpamja politike, por edhe personale e fizike.

18 PY. Faleminderit. Më ka ngelur pak kohë dhe do të kërkoj që
19 të përqendroheshit pak më shumë në përgjigjet tuaja.

20 Gjithashtu, dje në faqen 37, biseduat, përmendët armiqësinë e
21 Thaçit ndaj Rugovës. A ju kujtohet që pas takimit të parë që
22 PSSP-ja bëri, pra, që arriti të bënte të organizonte midis
23 Rugovës dhe Thaçit, Dr. Kouchner ju tha juve që Thaçi ishte i
24 ashpër, bilës i egër, në sulmet e tij verbale, me fjalë ndaj
25 Rugovës?

1 PË. Në atë takim, po.

2 PY. Faleminderit. Dhe gjithashtu e dini që UÇK-ja kishte vënë

3 -- shënjestronte LDK-në dhe FARK-un, apo jo, a është kështu?

4 PË. Pyetja juaj është që UÇK-ja kishte shënjestuar FARK-un?

5 PY. Edhe LDK-në.

6 PË. Kam më pak njohuri për sa i takon shënjestrimin të LDK-

7 së, por po, jam në dijeni në faktit se kishte raporte se ata

8 shënjestronin FARK-un.

9 PY. Faleminderit. PSSP-ja ka shkuar gjithashtu lidhur me këtë
10 pikë.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoja të shfaqet në ekran
12 tani SPOE00403545 deri në 403566 dhe përkthimi përkatës në
13 anglisht.

14 Kalojmë në faqen 7 PDF në të dy gjuhët, që është
15 SPOE00403551.

16 PY. Këtu sa i përket -- në lidhje me bisedën e tij me Rugovën
17 ai shkruan --

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Përqendrohemi në pjesën --
19 gjysmën e parë të faqes, ku fillon me "Përshëndetjet ...",
20 pjesa e dytë e këtij paragrafi aty ku fillon me "Rezistuesit
21 ...", do lexoj nga aty.

22 PY. "Rezistuesit e Thaçit të cilët kishin marrë -- kishin
23 rrezikuar që të vepronin në klandestinitet dhe kishin marrë
24 armët, kishin kapur armët, kishin synim që të zinin të gjitha
25 vendet, pozicionet kyçe në vend dhe 'bashkëpunëtorët', edhe në

1 goftë se -- edhe pse në këtë rast ata ishin ata që e kishin
2 filluar dhe ndërtuar luftën paqësore të çlirimit, pra,
3 'bashkëpunëtorët' filluan të dridheshin, Lufta ishte e hapur
4 midis këtyre dy grupeve dhe do të thonte, pra, nënkuptonte
5 rrezikun për vdekje të dhunshme, rrezik i vazhdueshëm ndaj
6 vetes dhe familjes. Ishte absolutisht -- unë isha
7 jashtëzakonisht i vendosur që të shmangia një përballje apo
8 përplasje të tillë."

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani do të kalojmë në faqen
10 tjetër, duke e zvogëluar pak faqen tjetër, pra. Duhet të jemi
11 në faqen 7 PDF. Pjesa e dytë e ekranit. Përqendrohemi te
12 paragrafi i dytë.

13 PY. Këtu ai thotë.

14 "M'u desh që të bindja Thaçin, personin që përfaqësonte
15 rezistencën e armatosur."

16 Pastaj vazhdon:

17 "Brezi i tij ishte që nuk lëshonte pe, i rreptë. Ai nuk
18 kishte marrë pjesë në luftë paqësore dhe i konsideronte
19 aktivitetet e Rugovës si bashkëpunim me regjimin e
20 Millosheviqit."

21 Pastaj më vonë thotë:

22 "Hashim Thaçi doli nga lufta duke besuar që fitorja ishte
23 e tij, jo e fushatës ajrore të NATO-s. Ai përfitoi nga
24 mbështetja amerikane dhe pësoi nga mungesa e besimit që kishin
25 evropianët dhe francezët që ushqej nga mungesa e

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 132

1 ndëshkueshmërisë për krimet që i atribuoheshin UÇK-së,
2 trafiqet e ndryshme, në veçanti, trafiqet e armëve, në të
3 cilat disa pjesëtarë dhe guerilas pretendohet që ishin të
4 përfshirë.”

5 A pajtoheni me këtë përshkrim të marrëdhënies midis UÇK-
6 së dhe LDK-së?

7 PË. Po, me përshkrimin pak, pjesën poetike të përshkrimit nga
8 Bernardi. Po.

9 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do të kërkoj të paraqes këtë
10 faqe, pra, SPOE00403551 për pranim në prova.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
12 kundërshtim?

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Në qoftë se mund të shohim pak më
14 poshtë në fund të faqes, ju lutem, fillimisht. Nuk ka
15 kundërshtime. Jo.

16 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Do kërkoja që kjo faqe t'i
17 bashkohet provës kryesore në qoftë se është e mundur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00403551
19 pranohet.

20 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Kjo do t'i
21 shtohet provës materiale P04488, klasifikuar si konfidenciale
22 siç ishin edhe faqet paraprake. Kërkoj ndjesë apo kuptova që e
23 kam lexuar gabimisht numrin? Numri i provës materiale ishte
24 P04498. Faleminderit.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

1 PY. A ju kujtohet që keni shkruar diçka të ngjashme dhe në
2 librin tuaj?

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe për këtë do kërkoja të
4 shfaqim përsëri në ekran SPOE00397775. Dhe kalojmë në faqen
5 PDF 36. Përqendrohemi në fund, në anën e majtë, faqen në anën
6 e majtë, paragrafi i parafundit.

7 PY. Ju këtu keni shkruar:

8 "Në të njëjtën kohë një luftë më pak e qartë e dukshme po
9 aq e ashpër brenda Kosovës po zhvillohej midis komunitetit që
10 ishte shumicë shqiptarë, pra, mes këtij komuniteti midis UÇK-
11 së dhe mbështetësve të LDK-së së Ibrahim Rugovës."

12 Kjo është -- këto janë fjalët tua në 2005-n, saktë?

13 PË. Po.

14 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Kalojmë në të njëjtën faqe PDF.
15 Sipër, paragrafi i tretë. Paragrafi që fillon "Me kalimin e
16 kohës ...".

17 PY. Këtu keni shkruar:

18 "Me kalimin e kohës u bë gjithnjë e më shumë e qartë se
19 kjo nuk ishte thjesht një debat politik i tensionuar.
20 Ekstremistët e UÇK-së do përdornin çdo mjet të nevojshëm për
21 të zhvendosur Rugovën dhe aparatin politik të tij të LDK-së si
22 dhe për t'u njohur dhe pranuar si heronj dhe garantorë të
23 pavarësisë së ardhshme të Kosovës. Luftëtarë të UÇK-së
24 konsideronin krahun e armatosur të LDK, Forcat e Armatosura të
25 Republikës së Kosovës (FARK) pothuajse si armik aq sa dhe

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 134

1 forcat speciale tmerruese të Serbisë. Edhe gjatë luftës, UÇK-
2 ja kishte sulmuar FARK-un. Në boshllëkun që u krijua më pas,
3 fushata e pamëshirshme e UÇK-së kundër LDK-së vazhdoi.”

4 A janë këto fjalët e tuja?

5 PË. Po, duke patur parasysh që, siç është përshkruar në vende
6 të tjera, UÇK-ja ishte e shpërndarë, e llojlloshme, e ndryshme
7 si organizatë, pra, në fakt nuk ishte një organizatë. Ishte
8 lëvizje e shpërndarë e papërqendruar e përbërë nga disa
9 komandantë zonash rajonalë, por kjo përshkuan atë që po bëhej
10 siç e kemi kuptuar ne nga pjesëtarë që ishin të lidhur me
11 lëvizjen e UÇK-së.

12 PY. Faleminderit. Ju keni dhënë një shembull të kësaj dhune.

13 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe për këtë do kalojmë në faqen
14 35. Kjo është dokumenti -- numri i dokumentit është
15 SPOE00397809. Përqendrohemi te pjesa që është e shkruar në
16 italic.

17 PY. Këtu duket folur për angazhimin e Kouchner me Rugovën,
18 pjesa e dytë e paragrafit të dytë, ju keni thënë, pra, frika e
19 Rugovës. Dhe keni thënë që pesë nga truprojat e Rugovës ishin
20 ndaluar dhe torturuar nga operativë, pjesëtarë të Ushtrisë
21 Çlirimtare të Kosovës nën komandën e Daut Haradinaj. Këto janë
22 fjalë, atë që pasqyrojnë atë që keni mësuar ju, apo jo?

23 PË. Këto janë gjëra që kemi marrë vesh në shkëmbimet e
24 ndryshmet e ndryshme që kemi patur gjatë kohës me KFOR-in.

25 PY. Faleminderit.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 135

1 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Paraqes dokumentin SPOE00397809
2 për t'u pranuar si provë, sepse pjesa tjetër është e pranuar
3 tashmë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
5 kundërshtim?

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00397809
8 pranohet.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i -- këtij do t'i
10 jepet numri i provës materiale, P04496.5. Dhe është i
11 klasifikuar si publik. Si dokumentet paraprake.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
13 Riklasifikohet si publik.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] Në interes të përshkrimit të plotë
15 të asaj që thashë më parë, do të shtoja se përdorimi nga ana
16 ime i termit "luftë civile", duke e parë në retrospektivë
17 tani, është më shumë sesa do të kisha -- do thoja tani.

18 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

19 DËSHMITARI: [Përkthim] Por konflikt i hapur, po.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Ju kujtohet gjatë kohës që keni qenë në Kosovë që keni
22 pranuar, marrë raporte që UÇK-ja shënjestronte pjesëtarë të
23 LDK-së?

24 PË. Kemi marrë raporte për persona që shënjestronin njerëzit
25 e LDK-së të cilët besohej që ishin mbështetës të UÇK-së apo

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 136

1 ish-individë që kishin qenë në UÇK.

2 PY. Në rregull. A ju kujtohet që ju keni krijuar një

3 iniciativë për të monitoruar, vëzhguar veprimet që kishin -- e

4 bëra për motive politike në atë kohë?

5 PË. Jo siç e përshkruani ju. Ndoshta keni diçka për të më

6 freskuar kujtesën.

7 PË. Ju mund ta përshkruani vetë atë. A ishte kjo si task

8 forcë, pra, grup operativ?

9 PË. Kërkoj ndjesë, nuk më kujtohet qartë nëse një task forcë

10 e tillë pra, por nuk e kundërshtoj që edhe mund të ketë

11 ekzistuar.

12 PY. Në rregull. A ju kujtohet vrasja e pjesëtarëve, anëtarëve

13 të LDK-së në atë kohë, për shembull, a ju kujtohet vrasja e

14 Xhemal Mustafës?

15 PË. Në pjesën përpara zgjedhjeve, po. Dhe besoj që kam dhënë

16 një deklaratë për atë rast.

17 PY. Po, kështu është. Dhe meqenëse ju kujtohet do t'jua

18 tregoj.

19 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është dokumenti me ERN

20 SPOE00397223. Do kërkoj të shfaqet në ekran.

21 PY. Ky është një artikull nga *Washington Post* që mban datën

22 24 nëntor 2000, dhe raporton për vrasjen e anëtarit të LDK-së,

23 Xhemajl Mustafa.

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Këtu në goftë se mund të shohim

25 më poshtë në faqe, paragrafi i parafundit.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga znj. Iodice

Faqe 137

1 PY. Këtu thotë që:

2 "Diplomati i Shteteve të Bashkuara, Jock Covey,
3 përfaqësuesi i Kombeve të Bashkuara në Kosovë tha që: 'Ky
4 është një veprim i neveritshëm dhe i bërë nga frikacakët, i
5 kryer nga ekstremistët dhe frikacak, i kryer nga ekstremistë,
6 të cilët duan të dëmtojnë lëvizjen, ecurinë e Kosovës drejt
7 demokracisë."

8 A është kjo deklaratë, deklarata për të cilën e kishit
9 fjalën?

10 PË. Kjo është citim nga deklarata që ju vutë, nuk kam lexu
11 pjesën tjetër të artikullit. Jeff Smith nuk është gazetari im
12 i preferuar. Kishte tendencë të punonte me teza me mendime më
13 shumë, me teori më shumë sesa me fakte.

14 PY. Faleminderit.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, paraqes këtë
16 dokument për t'u pranuar si provë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
18 kundërshtime?

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] SPOE00397223
21 pranohet.

22 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] SPOE00397223 deri në
23 00397224 do të marrë numrin e provës materiale P04505, dhe
24 aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.

25 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Mund të jetë publik.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

2 ZNJ. IODICE: [Përkthim]

3 PY. Ju kujtohet që Hashim Thaçi e ka themeluar PDK-në, apo
4 jo?

5 PË. Po.

6 PY. Në seancën përgatitore - dhe kjo është në paragrafin 14
7 të Shënimit Përgatitor 2 - ju keni diskutuar një pjesë të
8 librit tuaj ku ju keni shkruar se Thaçi nuk kishte demonstruar
9 një angazhim të besueshëm për ndonjë -- për asgjë që mund të
10 afrohej me demokracinë. Dhe ju e keni shpjeguar që ju për këtë
11 e kishit fjalën, atë që donin të thonit, dhe është që ai
12 kishte --

13 PË. Pra, theksi është që demonstrimit, pra, provimi i saj.

14 PY. Do t'ju tregoj atë pjesë përsëri ta shohim.

15 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ky është nga libri SPOE00397775,
16 kalojmë në faqen SPOE00397813. Është dokument që është pranuar
17 me numrin e provës materiale P04496.4. Faqja tjetër.

18 Faleminderit. Zmadhojmë pjesën ku thotë, pra, "Duke
19 ndërmjetësuar gjithnjë e më shumë në konfliktin", pra.

20 PY. Këtu keni shkruar:

21 "Që nga fillimi, një element kyç i ndërmjetësimit -- i
22 përpjekjes së ndërmjetësimit të UNMIK-ut ishte sjellja e një
23 serie, një numri të gjerë të udhëheqësve, futja e tyre në
24 procesin politik që do të transformonte konfliktin. Ecuria,
25 përparimi fillestar drejt vendosjes të krimit të një këshilli

1 ku përfshiheshin të gjitha partitë ishte inkurajues. Kur
2 përfaqësuesit e shqiptarëve më të tolerantë nuk ishin në
3 gjendje të largonin -- të largonin dhe të distancoheshin nga
4 vrasjet, të largonin vrasjet, të parandalonin vrasjet e 14
5 serbëve -- serbëve fermerëve, pra, bujq, megjithatë, edhe
6 serbët më të moderuar e braktisën procesin në tërësi."

7 Dhe në paragrafin tjetër:

8 "... UNMIK-u vendosi të përqendrohej tek rivalët
9 shqiptarë".

10 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Dhe pastaj mund të shkojmë pak më
11 poshtë.

12 PY. Në muajt e parë, fraksionet, pra, grupet e shqiptarëve që
13 ishin tepër të shqetësuar me -- të preokupuar me mënjanimin e
14 njeri-tjetrit sesa me punën me UNMIK-un. Thaçi ishte shumë
15 këmbëngulës dhe kërkonte dhe bënte përpjekjet, përpiquej, po
16 kishte pak përvojë dhe nuk kishte aparat pas tij, aparatusin,
17 dhe nuk kishte treguar ndonjë angazhim të besueshëm për
18 demokracinë. LDK-ja e Rugovës kishte shumë më shumë anëtarë
19 dhe vitet e përvojës gjatë të cilave kishte siguruar shërbimet
20 themelore sociale dhe kishte zhvilluar dhe organizuar
21 zgjedhje. LDK-ja ishte nga natyre pasive, megjithatë, Rugova
22 ishte -- dhe Rugova ishte jashtë vendit, tmerrësisht i
23 frikësuar për t'u kthyer. UNMIK-u thjesht nuk mund të zgjidhte
24 cili ishte fitues.

25 "PDK-ja nuk do të pranonte që të mënjanohej. Po të

1 zgjidhje LDK-ja kjo do të çonte qartësisht në fillimin e një
2 lufte civile. Asnjëra prej shumicave të shqiptarëve ..."

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Tani mund të kalojmë në faqen
4 tjetër. Kërkoj ndjesë, në fakt, do të thërras -- do të
5 paraqesim dokumentin SPOE00397775. Dhe kalojmë në faqen
6 SPOE00397813.

7 PY. Do të lexoj këtë pjesë të fundit:

8 "UNMIK-u thjesht nuk mund të zgjidhte një fitues. PDK-ja
9 thjesht nuk do të pranonte që të mënjanohet; po të zgjidhet
10 LDK-ja, kjo do të çonte qartësisht në luftë civile.

11 "Shqipt --"

12 Tani kalojmë në faqen tjetër.

13 "As komuni -- pjesa -- shumica e shqiptarëve, dhe as
14 bashkësia ndërkombëtare nuk mund të -- thjesht të miratonte
15 PDK-në kaq jodemokratike ishte imazhi i saj."

16 A ishin këto fjalët e tuja në vitin 2005? A janë këto
17 pra, të sakta?

18 PË. Po, me -- duke vënë theksin tek fjala "imazh".

19 PY. Faleminderit.

20 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Ta dorëzoj këtë dokument, faqen e
21 fundit të këtij që i shtohet pjesës tjetër të librit për
22 pranim në prova.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
24 kundërshtim?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 141

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faqe

2 00397813.

3 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Është 397814, sepse 13 është
4 pranuar më parë.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Faleminderit. Kjo
6 pranohet me numrin e provës materiale P0496.6 [Sipas
7 përkthimit], dhe besoj që klasifikimi është publik.

8 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Po.

9 PY. Z. Covey, faleminderit për durimin tuaj. Nuk kam pyetje
10 të tjera për t'ju bërë.

11 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A doni të
13 bëni pyetje shtesë?

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Na thanë
15 që do të shfrytëzonim të tërë ditën. Unë mund ta filloj po do
16 të kërkoja leje që pastaj të ringarkojmë një numër dokumentash
17 që na duhen pak më vonë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund t'i shfrytëzojmë 20 minutat
20 që kemi në dispozicion.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit. Më kanë thënë që një
22 pjesë të dokumenteve do t'i ngarkojmë tani dhe një pjesë
23 tjetër më vonë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Pyetje vijuese nga z. Misetic:

1 Z. MISETIC: [Përkthim]

2 PY. Mirëdita, z. Covey.

3 PË. Mirëdita.

4 PY. Kam disa pyetje të tjera shtesë që rrjedhin nga pyetjet e
5 Prokurorisë dhe pastaj do të vazhdoj edhe gjatë ditës së
6 nesërme. Në faqen 39 të transkriptit të ditës së sotme thatë
7 që deshët të shtojë diçka lidhur me rolin e diplomatit, dhe se
8 si e arrijnë diplomatët përfundimin e tyre. A të kujtohet?

9 PË. Po.

10 PY. Nuk e kishe mundësinë që ta thoje këtë, prandaj po ta jap
11 këtë mundësi që ta thuash çfarë deshe të thoje tani.

12 PË. Gjykatës i takon që të mbledhë prova empirike, kështu që
13 mund të jetë çudi të kuptohet se nuk e bëjnë kështu punën
14 diplomatët dhe paqeruajtësit. Nuk i arrijnë ato përfundimet në
15 të njëjtën mënyrë. Diplomatët e dinë që në fillim që nuk kanë
16 për ta mësuar të tërë të vërtetën, ata arrijnë në përfundime,
17 strategji dhe këshillime për qeverinë e tyre mbi bazën e
18 informatave të paplota.

19 Shumica e dokumenteve që më janë paraqitur në dy ditët e
20 fundit nuk i kemi pasur -- shumicën e tyre nuk e kemi pasur në
21 dispozicion ose ato kanë qenë të disponueshme pak më vonë, ose
22 mund të kenë qenë të fshehura në një mal me letra të cilat një
23 njeri si puna ime i ka lexuar gjatë vonë në darkë dhe këtë e
24 kemi bërë gjatë kërkimit të trazirave, dhe me "trazirë" e kam
25 fjalën çështje të cilat nuk janë trajtuar nga ana e misionit.

1 Pra, edhe ato dokumente të cilat mund t'i kem hedhur një
2 sy, i kam kushtuar vëmendjen e duhur apo të njëjtën vëmendje
3 që më është dashur të kem gjatë dy ditëve të shkuara.

4 Megjithatë, puna e jonë nuk është që të bëjmë vlerësimin
5 mbi bazën e të dhënave të plota. Kur shkon me mision në një
6 vend të ri me një sistem politik të ri gjithnjë ballafaqohesh
7 me tituj, përgjegjësi dhe pretendime të stërzmadhuar të cilat
8 synojnë zmadhojnë rolin e njërit apo tjetrit dhe është detyra
9 e jonë për të identifikuar se kush në fakt e ka autoritetin.
10 Kush ushtron influencë më të madhe, pa pasur atë që shërbimet
11 e zbimit do ta quanin treguesit e synimit, si të thuash. Vetëm
12 përmes bashkëpunimit me ato që do të quheshin --

13 PËRKTHYESI: Dhe përdor fjalën gjermanisht.

14 DËSHMITARI: [Përkthim] -- përdoret -- mund të gjendet
15 mënyra për të vlerësuar atë që ndodh para jush.

16 Dhe për sa i përket -- tani i kthehem çështjes së z.
17 Thaçi. Ka thënë shumë dhe ka shumë dokumentacione për të,
18 megjithatë ne jemi ballafaquar me një numër kontradiktash,
19 është një person i cili në mënyrë automatike kishte përfunduar
20 në rolin e një qeverie të përkohshme e cila sa i përket
21 mandatit të UNMIK-ut nuk kishte më vlerë, por i cili në atë
22 kohë ka qenë shumë, shumë i ri, pa përvojë -- pa përvojë në
23 politikën reale, në politikën e sigurimit të votës nga
24 votuesit. Nuk ka patur përvojë ekzekutive dhe i cili shpesh
25 përdorte retorikë të ashpër por e cila kontraktonte me mënyrën

1 e butë të të folurit.

2 Dhe ne që në fillim kemi vlerësuar se ai po përpiqej të
3 gjente rolin e duhur. Kishte ambicie të madhe, ishte shumë e
4 qartë, ishte shumë i zgjuar, kjo ishte e qartë, por nuk kishte
5 përvojë për këto çështje dhe po përpiqej që të orientohej në
6 gjetjen e një roli për të siguruar ambicien e tij.

7 Dhe ne nuk menduam që mund ta arrinte, por që shpresonte
8 të arrinte. Pra, që në fillim gjykimi ynë ishte se ishte krejt
9 e qartë se ky person që ndodhej para nesh nuk ishte luftëtar
10 dhe nuk besoj që ka ndonjë të dhënë që të tregojë që ky njeri
11 ka gjuajtur ndonjëherë ndonjë plumb si rezultat i mërzhisë apo
12 zemërimit, por kjo nuk ka vlerë. Për ne ishte natyra e
13 personit me të cilin ballafaqohej, bëhet për me -- për ne
14 ishte me rëndësi ishte natyra e personit që ballafaqohej me ne
15 dhe përvoja e tij, sipas nesh. Bernardi dhe ne jemi neofitë,
16 si të thuash, në këtë drejtim. Ne e kemi kaluar gjysmën e
17 jetës duke u përpjekur që të vlerësonim njerëzit rreth nesh
18 dhe e kemi vlerësuar që në fillim që ky nuk ishte luftëtar dhe
19 ndoshta edhe personi i cili nuk ka gëzuar respekt të thellë
20 nga ana e njerëzve të cilët kanë luftuar, në fakt, në terren
21 dhe kanë humbur edhe shokët e tyre.

22 Dhe prandaj nuk ndjehem rehat kur më paraqitën gjithë
23 këtë numër dokumentash të cilat nuk paraqesin personin që kemi
24 gjetur ne, nuk parashikojnë procesin që kishim ndërmarrë ne,
25 që ishte një proces -- dhe që siç themi ne, analisti apo

1 juristi i tregon gjërat ashtu siç janë, ndërkohë që burrat e
2 shtetit kanë për detyrë të ndryshojnë gjërat që ekzistojnë dhe
3 këtë menduam ne se ishte detyra jonë, pa pasur nevojë që të
4 jepnim vlerësimin tonë mbi historinë apo të shkuarën si
5 histori.

6 Z. MISETIC: [Përkthim]

7 PY. Faleminderit. Atëherë, për ta zhvilluar më tej këtë
8 mendim, a mund të shkojmë edhe një herë tek libri juaj të
9 cilin e keni diskutuar me pyetjet e Prokurorisë.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Që ka numrin e provës P044694.4
11 [Sipas përkthimit]. Të kalojmë në faqen P0039893 [Sipas
12 përkthimit], në krye.

13 PY. Në krye të faqes 107 në fjalinë e parë të plotë keni
14 thënë -- thatë që:

15 "Nuk e kishte patur të lehtë që të bashkëpunonte me
16 komandantët e UÇK-së."

17 Këtë e keni shkruar në vitin 2005.

18 PË. Po.

19 PY. Na tregoni -- më falni, po e riformuloj pyetjen.
20 Sigurisht që keni pasur dijeni edhe një herë po e riformuloj.
21 Cilat është baza e këtij konkluzioni nga ana juaj? Nuk ka
22 nevojë që ta përsërisni atë që keni thënë më parë gjatë ditës
23 së sotme.

24 PË. Kjo ka ardhur si rezultat i gjitha përshtypjeve tona në
25 tërësi, marrë në tërësinë e tyre. Ka nisur me komente të bëra

1 nga pjesëtarë të UÇK-së, mungesa e respektit që kishin ndaj z.
2 Thaçi disa prej komandantëve të zonave dhe ka vazhduar me
3 vlerësimin e personalitetit të tij dhe personalitetin e tyre,
4 dhe arritëm në konkluzionin e fuqishëm, u demonstrua në mënyrë
5 të fuqishme në takimin që e kam shpjeguar këtë në atë takim, i
6 cili na konfirmoi atë që kishim besuar gjatë të gjithë kohës
7 që marrëdhëniet e tij me pjesëtarët aktivë të lëvizjes së UÇK-
8 së të cilët nuk e konsideronin atë si komandant, ishin ata
9 persona të cilët nuk do kishin kërkuar as udhëzime as do t'i
10 kishin raportuar atij për aktivitet që ndërmerrnin.

11 PY. Faleminderit. Dua t'ju bëj disa pyetje përpara se të
12 përfundojmë. Kemi rreth 10 minuta në dispozicion dhe do t'ju
13 bëj pyetje për njërin prej këtyre komandantëve. Ju kanë bërë
14 disa pyetje lidhur me të dhe ai është Sami Lushtaku.

15 Ju kanë bërë një numër pyetjesh lidhur me procesin e
16 arrestimit, apo jo, të z. Lushtaku. Pyetje ime e parë është:
17 Ti dhe z. Kouchner a i keni injoruar krimet në mënyrë të
18 qëllimshme?

19 PË. Jo.

20 PY. A nuk i keni tërhequr vërejtjen z. Thaçi lidhur me
21 reagimet e dhunshme në Kosovë?

22 PË. Jo. Diskutimet për z. Thaçi dhe z. Lushtaku janë tejet të
23 ndryshme. Ne për ta thjeshtëzuar të tërë argumentin nuk kishim
24 asnjë iluzion që mund të reformohej z. Lushtaku dhe ne, në
25 fakt, kishim pritshmëri të plota që po të tregoheshim të

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 147

1 kujdesshëm dhe t'i mendonim mirë fjalët tona z. Thaçi do të
2 bindej se interesat e tij ishin të bashkëpunonte me UNMIK-un
3 dhe për krijimin e një ambienti tolerant, të sigurtë për
4 pakicat e kështu me radhë, që ai mund të bindej pavarësisht se
5 fillim nuk ishte e qartë që ai kishte respekt për UNMIK-un.

6 PY. Z. Covey, sa i përket transkriptit, ju thatë që "duke e
7 thjeshtëzuar ne nuk kishim ..." dhe mungon një fjalë.

8 PË. Nuk kishim iluzion që mund të reformohej z. Sami Lushtaku
9 për sa i përket procesit që po ju shpjegojmë, ne nuk do të
10 merreshim me të.

11 PY. A ka patur z. Thaçi mundësi *de facto* për ta ndëshkuar një
12 njeri si Sami Lushtaku?

13 PË. Jo. Kjo do të kishte kërkuar mbështetje nga pjesa tjetër
14 e lëvizjes së UÇK-së, komandantët e tjerë të UÇK-së dhe ai nuk
15 ka patur këto lloj marrëdhëniesh apo mbështetjeje. Nuk e kam
16 bërë pyetjen kështu që dhe nuk e di kush mund ta kishte
17 ndëshkuar.

18 PY. Faleminderit.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Dua të shfrytëzojmë një dokument
20 nga dokumentet që sapo kemi nxjerrë, DHT12157 deri 12157.

21 PY. Kjo është një shkrim i 25 gishtit 1999 nga Koha Ditore ku
22 flitet për krijimin e një partie të re të cilën e diskutuam
23 dje, besoj që e diskutuam partinë e krijuar nga Bardhyl
24 Mahmuti dhe partitë e tjera të cilat dolën si rezultat i
25 shkëputjes nga ajo që ishte më parë UÇK-ja. Do të thotë:

1 "Komandanti i Gardës Kombëtare, Sylejman Selimi,
2 Sulltani, dhe komandanti i Zonës Operative të Drenicës, Sami
3 Lushtaku, vizituan selinë e partisë së Unionit Demokratik,
4 PBD, në Prishtinë të hënën me 23 gusht. Ata u pritën nga
5 udhëheqësi i PBD-së, Bardhyl Mahmuti, Pleurat Sejdiu dhe Halil
6 Selimi, si dhe anëtarë të Presidencës, sipas njoftimit për
7 shtyp të PBD-së."

8 Dhe më pas flitet se si Sylejman Selimi dhe Sami Lushtaku
9 bënë vizitë te kjo parti e re politike.

10 Dua t'ju pyes: A keni patur dijeni që ish-komandantët e
11 zonave kishin marrëdhënie me një parti politike në gusht të
12 '99-s, me një parti politike që nuk ishte partia politike e z.
13 Thaçi?

14 PË. Ka shumë mundësi që të kemi patur dijeni në një farë
15 mënyre, por ajo që ishte e qartë është që z. Thaçi nuk e
16 kishte konsoliduar plotësisht mbështetjen nga ish-anëtarët e
17 UÇK-së të cilët do të përfaqësonin apo do të përqafonin
18 demokracinë. Pra, ky ishte qëndrimi politik por nuk e kishte
19 arritur këtë qëllim, por ne --

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Duam ta paraqisim DHT12517 [Sipas
21 përkthimit].

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka ndonjë
23 kundërshtim?

24 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Jo.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] DHT12157 deri

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 149

1 në 12157 pranohet.

2 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë numrin e
3 provës 1D421 [Sipas përkthimit], aktualisht është klasifikuar
4 si publike. Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
6 riklasifikohet si publike?

7 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

8 Nëse më lejoni një çast për t'i gjetur numrin e provës
9 materiale para se të përfundoj ditën, dhe është numri i provës
10 materiale për librin e O'Neill.

11 ZNJ. IODICE: [Përkthim] Unë mund të jap numrin rendor, po
12 nuk e kam numrin e provës materiale, pasi nuk e kam paraqitur.
13 Ende më duhet ta bëj atë me email.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Ah, dakord, atëherë. Mund të na
15 jepni numrin e ERN-së se unë e kam numrin e faqes, por jo të
16 tërë.

17 ZNJ. IODICE: [Përkthim] 052590 [Sipas përkthimit] deri në
18 2591 [Sipas përkthimit].

19 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Është ky dokumenti që
20 duam të vendosim në ekran?

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po. Kalojmë në faqen 05248 [Sipas
22 përkthimit].

23 PY. Besoj se e mbani mend që autori është William O'Neill nga
24 misioni i OSBE-së.

25 PË. Më kujtohet emri.

1 PY. Vetëm po të orientoj. Ju kam treguar vetëm kreun e kësaj
2 faqeje, do ju tregoj edhe pjesën e fundit për të kërkuar
3 komentin e tyre.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem, të zbresim pak më
5 poshtë. Pak më lart, ju lutem, që të fillojmë me paragrafin
6 tjetër ku thuhet që:

7 "Disa pjesëtarë të UNMIK-ut i kanë vënë pikëpyetje lidhur
8 me faktin nëse dhuna ishte e planifikuar në fakt. Ata thanë që
9 këto ishin -- këto ishin incidente rastësore, spontane, ishin
10 një shprehje e zemërimit të njerëzve kundër ish-shtypësve të
11 tyre. Hyrja e bërë nga PSSP-ja në raportin e OSBE-së ka
12 reflektuar debatin në UNMIK lidhur me këtë çështje. Drafti
13 fillestar i Zyrës së të Drejtave të Njeriut të PSSP-së ka
14 deklaruar që 'grupet e armatosura duket se operojnë -- po
15 veprojnë në mënyrë të organizuar dhe kanë një formë hierarkie,
16 komandë dhe kontrolli'. Përfundon citimi. Paragrafi i hartuar
17 nga të tjerët në zyrën e PSSP-së pas shumë faqe bie në
18 kundërshtim me këtë pohim ku thotë që 'Krimet, në fakt, janë
19 akte të individëve'.

20 "Janë dhënë pretekste të ndryshme për nga ushtarët -- nga
21 UÇK-ja dhe udhëheqësit e tij, kryesisht nga Hashim Thaçi dhe
22 Agim Çeku kur dokumente -- kur rast pas rasti OSBE-ja, CIVPOL-
23 i dhe KFOR-i kanë dokumentuar raste që tregojnë -- ish-anëtarë
24 të UÇK-së morën pjesë në incidente serioze". Po ndaloj pak
25 shpejtësinë. "Edhe në qoftë se bëhet fjalë për UÇK-në ... dhe

1 nuk e dimë nëse është kjo gjë, mund të jenë persona të cilët i
2 kanë veshur uniformën e UÇK-së. Nuk është faji i Thaçit apo i
3 Çekut pasi ata nuk mund t'i kontrollojnë këta njerëz. Mungesa
4 e pretenduar e kontrollit mbi këta elementë të pabindur, në
5 fakt, është alibi e shpejtë për ish-luftëtarët, dhe kjo, në
6 fakt, është një farë 'mungese e përgjegjshmërisë' dhe, në
7 fakt, ngre çështje më të madhe. Në qoftë se Thaçi, Haradinaj
8 dhe Çeku dhe të tjerët nuk i kontrollojnë këta njerëz, atëherë
9 përse harxhojmë kohën për të folur me ta?"

10 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe zbresim pak më poshtë.

11 PY. "Ndërkohë që besnikëritë rajonale nuk -- rajonale dhe
12 identifikimi me klane e kanë bërë UÇK-në që të mos jetë një
13 organizëm i disiplinuar" - të kalojmë në faqen tjetër, - "si
14 të jetë aq i mirë sesa ushtria gjermane, atëherë nuk, në fakt,
15 ajo nuk ishte asnjë amalgamë e bandave të pakontrolluara që --
16 për të cilët do të duhej që tani ish-udhëheqësit të kërkonin
17 ndjesë."

18 Unë besoj se keni patur -- tani keni mundësi, z. Covey,
19 që të komentoni lidhur me këtë. A keni ndonjë mendim lidhur me
20 sugjerimin e z. O'Neill?

21 PË. Jam i lumtur që kemi patur njerëz të angazhuar dhe
22 pasionantë për t'i ndjekur çështjet e të drejtave të njeriut
23 ne në familjen UNMIK-ut, por këto lloj tensionesh, morale dhe
24 intelektuale, brenda kësaj organizate janë tipike. Të dy palët
25 i shohim këto si një binom. Në fakt, është ose individit ose

1 pjesë e konspiracionit të mëtejshme. E vërteta, në fakt, ndodh
2 që t'ju përkasë të dy elementëve. E vërteta është që ne po
3 përpiqeshim që t'i eliminojmë këto akte. Dhe synimi ynë
4 kryesor apo përqendrimi i punës sonë, ka qenë që ta
5 shpopullojmë këtë segment që mund të ishte kryesi i këtyre
6 veprimeve duke u dhënë mundësinë që energjitë t'i çonin diku
7 tjetër, si për shembull, të merrnin pjesë në TMK, në polici,
8 në industrinë private, pra, vende pune për personat të cilët
9 në atë pikë kohore nuk kanë ditur gjë tjetër përveçse të ishin
10 fermerë dhe luftëtarë, në të njëjtën kohë do të ishim
11 përpjekur për të parandaluar, për të arrestuar, për të kapur
12 të tjerët, dhe ky nuk është një proces që ka ecur lehtë.

13 PY. Po lidhur me pohimin që z. Thaçi dhe z. Çeku kanë patur
14 kontroll për këto krime?

15 PË. Z. Çeku respektohej, sigurisht, dhe në disa kohë për disa
16 çështje ka patur influencë të madhe, por mendimi im në atë
17 kohë ishte që atje kishte disa njerëz të cilët ishin njerëz me
18 të cilët nuk bëhej dot shaka, njerëz të cilët ndiqnin
19 interesat e tyre. Disa prej tyre ishin, si të thuash,
20 gangsterë të një lloj apo të një mënyre tjetër, të një mënyre
21 siç e kemi kuptuar ne dhe ishte vështirë për ta që ta ndalonin
22 atë veprimtari. Të tjerë kanë besuar në mënyrë pasionante me
23 çështjen e pavarësisë, dhe mendonin që nuk është e arritur.

24 PY. Po z. Thaçi?

25 PË. Vlerësimi ynë ishte që z. Thaçi nuk kishte kontroll.

Dëshmitari: James Covey (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje vijuese nga z. Misetic

Faqe 153

1 PY. Faleminderit. Po përfundojmë ditën, po unë po të jap
2 pyetjen e fundit. Po sa i përket nënkuptimit që ju apo z.
3 Kouchner ishit në një farë mënyre duke shfajësuar UÇK-në apo
4 udhëheqësin e saj?

5 PË. Ishte frustruese që njerëz të cilët ishin të angazhuar
6 për sistemin e drejtësisë të kuptonin që ne po tregoheshim
7 pragmatikë në një proces më të gjerësishëm. E kuptoj që po na
8 mbaron koha, por shpresoj që të mund të trajtojmë dhe disa
9 prej rasteve kur z. Thaçi ka folur në emër të asaj që ne do ta
10 shprehim si marrje e përgjegjësisë për UÇK-në.

11 PY. Do ta bëjmë këtë nesër në mëngjes.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryetar.

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e kisha
15 mikrofonin të hapur.

16 Faleminderit që ishit me ne sot. Do të shihemi nesër në
17 mëngjes. Mos flisni me askënd jashtë kësaj salle të gjyqit.

18 DËSHMITARI: Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

19 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Seanca
21 mbyllet. Shihemi nesër në orën 9.00 të mëngjesit.

22 --- Seanca mbyllet në orën 16.34

23

24

25